



STANDARDET E AUDITIMIT INTOSAI



ISSAI

• ISSAI1 DEKLARATA E LIMËS

ISSAI10	DEKLARATA E MEKSIKËS	• ISSAI100	PARIMET THEMELORE
ISSAI20	PAVARËSIA E SAI-ve	• ISSAI200	STANDARDET E PËRGJITHSHMIE
ISSAI30	KODI E ETIK	• ISSAI300	STANDARDET E FUSHËS
ISSAI40	KONTROLLI I CHËSISË	• ISSAI400	STANDARDET E RAPORTIMIT

STANDARDET E AUDITIMIT TË
INTOSAI

ISSAI



PËRMBAJTJA

ISSAI 1 - Deklarata e Limës	F. 4
Parathënie.....	F. 5
- Vështrim i përgjithshëm.....	F. 5
- Pavarësia.....	F. 7
- Marrëdhënia me Parlamentin, Qeverinë dhe Administratën.....	F. 7
- Kompetencat e SAI-ve.....	F. 8
- Metodatat e auditimit, Stafi i auditimit dhe Shkëmbimi i eksperiencave.....	F. 8
- Raportimi.....	F. 11
ISSAI 10 - Deklarata e Meksikës	F. 15
- Hyrje.....	F. 16
- Parimet.....	F. 16
ISSAI 11 - Vlerësimi i Pavarësisë së SAI-ve	F. 20
- Rezultatet e rasteve studimore.....	F. 21
- Parimet.....	F. 23
- Përfundime.....	F. 28
ISSAI 20 - Parimet e Transparencës dhe Përgjegjshmërisë	F.29
- Qëllimi dhe Objektivat.....	F. 30
- Kompetencat e përgjithshme të transparencës.....	F. 30
- Parimet.....	F. 31
ISSAI 21 - Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies dhe Praktikat më të Mira	F. 36
- Hyrje.....	F. 37

- Parimet dhe praktikat më të mira.....	F. 37
ISSAI 30 - Kodi Etik	F. 46
- Prezantimi.....	F. 47
- Integriteti.....	F. 47
- Pavarësia, Objektiviteti, Paanshmëria.....	F. 48
- Sekreti Profesional.....	F. 49
- Kompetencat.....	F. 50
ISSAI 40 - Kontrolli i Cilësisë	F. 51
- Hyrje.....	F. 52
- Qëllimi.....	F. 52
- Përmbledhje për ISCQ (sistemet e kontrollit të cilësisë).....	F. 53
- Struktura.....	F. 53
- Interpretimi i termave.....	F. 63
ISSAI 100 - Parimet kryesore në Auditimin e Shtetit	F. 65
ISSAI 200 - Standardet e Përgjithshme të Auditimit	F. 74
- Pavarësia	F. 76
- Kompetenca	F. 80
- Kujdesi i duhur.....	F. 81
- Standarde të tjera të përgjithshme për SAI-t.....	F. 82
ISSAI 300 - Standardet e Fushës së Auditimit	F. 87
- Planifikimi	F. 89
- Mbikëqyrja dhe Rishikimi	F. 91
- Studimi dhe vlerësimi i Kontrollit të Brendshëm.....	F. 92
- Përputhshmëria dhe zbatueshmëria me ligjet dhe rregulloret..	F. 93
- Evidencat e auditimit	F. 94
- Analiza e Pasqyrave Financiare	F. 95
ISSAI 400 - Standardet e Raportimit në Auditim.....	F. 96

ISSAI 1 - DEKLARATA E LIMËS

UDHËZIMET PËR RREGULLAT E AUDITIMIT

Miraturar në Kongresin e IX-të të Organizatës Ndërkombëtare të
Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), më 1977, në Lima

Parathënie

Kongresi i IX-të i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), në Lima:

- përdorimi i rregullt dhe efikas i fondeve publike, përbën një nga parakushtet thelbësore për trajtimin e duhur të financave publike dhe efektivitetit të vendimeve të autoriteteve përgjegjëse
- për të arritur këtë objektiv, është e domosdoshme që çdo vend të ketë një Institucion Suprem të Auditimit, pavarësia e të cilit të garantohet me ligj;
- këto institucione bëhen edhe më të nevojshme, pasi shteti ka zgjeruar aktivitetet e tij në sektorët social dhe ekonomikë, duke vepruar përtej kufijve të kornizës financiare tradicionale;
- objektivat specifike të auditimit, të tillë si përdorimi i duhur dhe efektiv i fondeve publike, zhvillimi i menaxhimit të shëndoshë financiar, ekzekutimi i duhur i aktiviteteve administrative dhe komunikimi i informacionit nëpërmjet publikimit të raporteve, tek autoritetet publike dhe publiku i gjerë, janë të nevojshme për stabilitetin dhe zhvillimin e shteteve në përputhje me qëllimet e Kombeve të Bashkuara;
- në kongreset e mëparshme të INTOSAI-t, kuvendet miratuan rezoluta, të cilat u aprovuan nga të gjitha vendet anëtare;

ZGJIDHJA

Të publikohet dhe shpërndahet dokumenti me titull "Deklarata e Limës për Udhëzimet mbi Rregullat e Auditimit."

I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Qëllimi i Auditimit

Auditimi është një koncept i natyrshëm në administrimin financiar publik, pasi krijon besim në menaxhimin e fondeve publike. Auditimi është komponent i domosdoshëm i një sistemi rregullator, i cili ka për qëllim të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit, ekonomisë si dhe të menaxhimit financiar. Ky sistem do të bënte të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese në raste të veçanta, rritjen e përgjegjshmërisë, marrjen e kompensimit, si dhe parandalimin e shkeljeve të tilla.

Neni 2. Para-Auditimi dhe Pas-Auditimit

1. Para-auditimi paraqet llojin e shqyrtimit të aktiviteteve administrative ose financiare; post-auditimi është auditimi pas faktit.
2. Para-auditimi efektiv është i domosdoshëm për menaxhimin e shëndoshë të fondeve publike që i janë besuar shtetit. Ai mund të kryhet nga një Institucion Suprem i Auditimit ose nga institucione të tjera të auditimit.
3. Procesi i para-auditimit është në gjendje të parandalojë dëmet para se të ndodhin, por ka disavantazhin se krijon volum të tepërt të punës dhe përgjegjësisë, sipas ligjit publik. Post-auditimi thekson përgjegjësit dhe mund të çojë në kompensimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe mund të parandalojë shkeljet e përsëritura.
4. Mundësia për të kryer para-auditime, përcaktohet nga situata ligjore dhe kushtet dhe kërkesat e secilit vend

Neni 3. Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm

1. Shërbimet e auditimit të brendshëm janë themeluar në kuadër të departamenteve të qeverisë dhe institucioneve, ndërsa shërbimet e auditimit të jashtëm nuk janë pjesë e strukturës organizative të institucioneve të audituara. Institucionet Supreme të Auditimit janë shërbime auditimi të jashtme
2. Shërbimet e auditimit të brendshëm, janë domosdoshmërisht nën varësinë e strukturës brenda së ciles ato janë themeluar. Megjithatë, ata funksionojnë dhe organizohen në mënyrë të pavarur, brenda kornizës përkatëse kushtetuese.
3. Si auditues të jashtëm, Institucionet Supreme të Auditimit, kanë për detyrë të shqyrtojnë efektivitetin e auditimit të brendshëm. Nëse auditimi i brendshëm është gjykuar efektiv, do të bëhen përpjekje, pa cenuar të drejtën e Institucionit Suprem të Auditimit, për të kryer një kontroll të përgjithshëm, për të arritur ndarjen më të përshtatshme të detyrave dhe bashkëpunimit mes Institucionit Suprem të Auditimit dhe auditimit të brendshëm.

Neni 4. Auditimi i ligjshmërisë, i rregullshmërisë dhe i performancës

1. Detyra tradicionale e Institucioneve Supreme të Auditimit është, të kontrollojnë ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e menaxhimit financiar dhe të kontabilitetit.
2. Veç këtij lloji auditimi, ka edhe një tjetër lloj auditimi po aq të rëndësishëm. Auditimi i performancës, i cili orientohet drejt shqyrtimit të performancës së ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike. Auditimi i performancës mbulon jo vetëm operacione të veçanta financiare, por një gamë të plotë të aktiviteteve të qeverisë, duke përfshirë edhe sistemin organizativ edhe atë administrativ.
3. Objektivat e Institucioneve të Larta të Auditimit janë ligjshmëria, rregullshmëria, ekonomiciteti, efikasiteti dhe efektiviteti i menaxhimit financiar, të cilët kanë rëndësi të barabartë. Megjithatë,

çdo Institucion Suprem i Auditimit, i përcakton vetë prioritetet e tij sipas rasteve.

II. Pavarësia

Neni 5. Pavarësia e Institucioneve të Larta të Auditimit

1. Institucionet Supreme të Auditimit, mund ti kryejnë me objektivitet dhe në mënyrë efektive detyrat e tyre ,vetëm nëse ata janë të pavarur dhe të mbrojtur nga ndikimet e jashtme.
2. Edhe pse institucionet shtetërore nuk mund të jetë absolutisht të pavarur, duke qenë pjesë e shtetit si tërësi, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të gëzojnë pavarësi funksionale dhe organizative në zbatimin e detyrave të tyre.
3. Krijimi i Institucioneve Supreme të Auditimit dhe shkalla e nevojshme e pavarësisë së tyre, përcaktohet nga Kushtetuta; detajet mund të përcaktohen në legjislacionin përkatës. Pavarësia nga çdo ndërhyrje dhe mandati i auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit garantohehen nga Gjykata e Lartë.

Neni 6. Pavarësia e anëtarëve dhe zyrtarëve të Institucioneve të Larta të Auditimit

1. Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit është e lidhur ngushtë me pavarësinë e anëtarëve të tij. Anëtarët janë personat që marrin vendimet dhe janë përgjegjës për to ndaj palëve të treta, të cilët janë organet kolegjiale ose drejtuesit e institucionit.
2. Pavarësia e anëtarëve, garantohehet nga Kushtetuta. Në veçanti, procedurat për largimin nga detyra përcaktohen në Kushtetutë dhe nuk mund të pengojnë pavarësinë e anëtarëve. Metoda e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve, varet nga struktura kushtetuese e çdo vendi.
3. Në karrierën e tyre profesionale, stafi i audituesve nuk duhet të ndikohet nga organizatat e audituara dhe nuk duhet të jetë i varur nga organizata të tilla.

Neni 7. Pavarësia Financiare

1. Institucioneve Supreme të Auditimit, duhet tu sigurohen mjetet financiare të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre.
2. Nëse është e nevojshme, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të kenë të drejtë të aplikojnë direkt tek organet kompetente për buxhetin kombëtar.
3. Institucionet Supreme të Auditimit mund të përdorin fondet në dispozicion ashtu si e gjykojnë të arsyeshme.

III. Marrëdhënia me Parlamentin, Qeverinë dhe Administratën

Neni 8. Marrëdhënia me Parlamentin

Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit, e parashikuar në Kushtetutë dhe me ligj, garanton një shkallë të lartë të nismës dhe autonomisë edhe në rastet kur ky institucion vepron si bashkpunëtor i Parlamentit ose kryen kontrolle nën udhëzimet e tij. Marrëdhënia mes Institucionit Suprem të Auditimit dhe Parlamentit, përcaktohet në Kushtetutë, sipas kushteve dhe kërkesave të secilit vend.

Neni 9. Marrëdhënia me Qeverinë dhe Administratën

Institucionet Supreme të Auditimit, auditojnë aktivitetet e qeverisë, administratës dhe institucioneve të tjera vartëse. Megjithatë, kjo nuk do të thotë, se qeveria është e varur nga ky institucion. Qeveria është plotësisht përgjegjëse për veprimet dhe mosveprimet e saj dhe nuk mund të justifikohet duke iu referuar konstatimeve të auditimit. Vetëm në rast se gjetje të tilla janë dorëzuar si vendime ligjërish të vlefshme dhe në fuqi dhe nga ekspertë të Institucionit Suprem të Auditimit.

IV. Kompetencat e Institucioneve të Larta të Auditimit

Neni 10. Kompetencat e shqyrtimit

1. Institucionet Supreme të Auditimit duhet të kenë qasje në të gjitha shënimet dhe dokumentet që lidhen me menaxhimin financiar dhe kanë të drejtë të kërkojnë, me gojë apo me shkrim, çdo informacion i cili konsiderohet i nevojshëm për punën e tyre.
2. Për çdo auditim, vendoset nëse është më e përshtatshme që auditimi të kryhet në subjekt, apo në Institucionin Suprem të Auditimit.
3. Sipas Ligjit, ose nga vetë Institucioni i Lartë i Auditimit (për raste individuale) caktohet një afat kohor për mbledhjen dhe paraqitjen pranë këtij institucioni të të gjithë informacionit, dokumentacionit dhe pasqyrave financiare të nevojshme.

Neni 11. Zbatimi i gjetjeve nga Institucioni Suprem i Auditimit

1. Subjekti i audituar duhet të komentojë mbi rezultatet e auditimit, brenda një periudhe kohore të vendosur me ligj, ose nga Institucioni Suprem i Auditimit, dhe duhet të paraqesë masat e marra si rezultat i gjetjeve të auditimit.
2. Për sa kohë, gjetjet nga auditimi nuk dorëzohen në formën e vendimeve ligjërish të vlefshme, Institucioni i Lartë i Auditimit, shfuqizohet nga përgjegjësia për të kërkuar marrjen e masave nga subjekti i audituar.

Neni 12. Opinionet e ekspertëve dhe e drejta për t'u konsultuar

1. Kur është e nevojshme, Institucionet Supreme të Auditimit mund të informojnë Parlamentin dhe administratën, në formën e mendimeve të ekspertëve, duke përfshirë komente mbi projektligjet dhe rregulla të tjera financiare. Autoritetet administrative duhet të bartin përgjegjësinë për pranimin ose refuzimin e mendimeve të ekspertëve; për më tepër kjo detyrë shtesë nuk duhet të parashikojë gjetjet e ardhme të Institucionit Suprem të

Auditimit dhe nuk duhet të ndërhyjë në efektivitetin e auditimit të saj.

2. Rregulloret për përshtatshmërinë dhe uniformitetin e procedurave të kontabilitetit miratohen vetëm pas marrëveshjes me Institucionin Suprem të Auditimit.

V. Metodatat e Auditimit , Stafi i auditimit, Shkëmbimi i eksperiencave

Neni 13. Metodatat e auditimit dhe procedurat

Institucionet Supreme të Auditimit, duhet të auditojnë në përputhje me programe të vetë-përcaktuara. Megjithatë, organe publike të caktuara, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për auditime.

1. Meqenëse një auditim rrallë mund të jetë gjithëpërfshirës, Institucionet Supreme të Auditimit, kanë të nevojshme të përdorin një përfaqëse kampionësh. Kampionët përzgjidhen në bazë të një modeli të caktuar dhe duhet të jenë të mjaftueshëm për të bërë të mundur gjykimin e cilësisë dhe rregullsinë e menaxhimit financiar.
2. Metodatat e auditimit duhet gjithmonë të përshtaten me progresin e shkencave dhe teknikave që lidhen me menaxhimin financiar.
3. Institucionet Supreme të Auditimit duhet të përgatitin manuale të auditimit për të ndihmuar audituesit e tyre.

Neni 14. Stafi i auditimit

1. Anëtarët dhe stafi i Institucioneve Supreme të Auditimit, duhet të kenë kualifikimet dhe integritetin moral të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre.
2. Në rekrutimin e personelit të Institucioneve të Larta të Auditimit, kërkohen njohuri të përshtatshme mbi nivelin mesatar të njohurive dhe shkathhtësisë, si dhe përvoja e duhur profesionale.
3. Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të zhvillimit teorik, praktik dhe profesional të të gjithë anëtarëve dhe stafit të auditimit, përmes Programeve të brendshme, ndërkombëtare dhe universiteteve. Zhvillimi duhet të inkurajohet me të gjitha mjetet e

mundshme financiare dhe organizative. Zhvillimi profesional duhet të kalojë kornizën tradicionale të njohurive juridike, ekonomike dhe kontabël dhe të përfshijë teknika të tjera të menaxhimit të biznesit, të tilla si përpunimi elektronik i të dhënave.

4. Për t'i siguruar një personel cilësor, pagat do të jenë në përputhje me kërkesat e veçanta të vendit të punës
5. Këto institucione mund të kërkojnë ndihmën e ekspertëve të jashtëm, në rast nevojë.

Neni 15. Shkëmbimi i eksperiencave

Shkëmbimi ndërkombëtar i ideve dhe përvojave, në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, është një mjet efektiv për të ndihmuar në përmbushjen e detyrave të këtyre institucioneve.

1. Ky propozim, është bërë i ditur gjithmonë nga kongreset apo seminarët trajnuesë të organizuar në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara dhe institucione të tjera, nga grupet rajonale të punës dhe nga botimi i një reviste profesionale.
2. Është e nevojshme të zgjerohen dhe intensifikohen këto aktivitete. Gjithashtu është i rëndësishëm, zhvillimi i një terminologjie uniforme të kontrollit bazuar në ligjin krahasues.

VI. Raportimi

Neni 16. Raportimi në Parlament dhe për publikun e gjerë

1. Sipas Kushtetutës, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të raportojnë gjetjet nga auditimet në Parlament, ose në një tjetër organ publik përgjegjës, çdo vit. Këto raporte do të publikohen, për të siguruar shpërndarje dhe diskutim të gjerë, si dhe rritjen e mundësive për zbatimin e gjetjeve në Institucionet Supreme të Auditimit.

2. Institucioni i Lartë i Auditimit ka të drejtë të raportojë edhe gjatë vitit, mbi gjetje të rëndësishme nga auditimet.
3. Në përgjithësi, raporti vjetor duhet të mbulojë të gjitha aktivitetet e Institucionit Suprem të Auditimit; vetëm në rastet kur çështjet janë të mbrojtura nga ligji, Institucioni Suprem i Auditimit duhet të shqyrtojë me kujdes.

Neni 17. Metodatat e Raportimit

1. Raportet duhet të paraqesin faktet dhe vlerësimin e tyre në mënyrë objektive, të qartë dhe me kufizimet e domosdoshme. Formulimi i raporteve duhet të jetë i saktë dhe i lehtë për t'u kuptuar.
2. Institucioni i Lartë i Auditimit, duhet të marrë parasysh edhe mendimet e subjekteve të audituar, për gjetjet e tij.

VII. Kompetencat e Auditimit të Institucioneve të Larta të Auditimit

Neni 18. Baza kushtetuese e pushtetit të auditimit; kontrolli i menaxhimit financiar publik

1. Kompetencat themelore të auditimit, përcaktohen në Kushtetutë; detajet mund të përcaktohen në legjislacion.
2. Kompetencat e auditimit të këtij institucioni, varen nga kushtet dhe kërkesat e secilit vend.
3. Të gjitha operacionet financiare publike, pavarësisht se si ato janë pasqyruar në buxhetin kombëtar, do të jenë subjekt auditimi. Me përjashtim të organeve të përjashtuar nga auditimi, nga vetë Institucioni i Auditimit.
4. Institucionet Supreme të Auditimit, nëpërmjet auditimeve të tyre, duhet të promovojnë një klasifikim të buxhetit dhe sistemeve të kontabilitetit, të përcaktuar sa më qartë dhe thjeshtë.

Neni 19. Auditimi i autoriteteve publike dhe institucioneve të tjera jashtë vendit

Si parim i përgjithshëm, Institucionet e Larta të Auditimit, kanë të drejtë të auditojnë edhe autoritetet publike dhe institucionet e tjera të themeluara jashtë vendit. Gjatë auditimit, këto institucione duhet të marrin në konsideratë edhe kufizimet e parashikuara nga e drejta ndërkombëtare apo ligjet ndërkombëtare.

Neni 20. Kontrolli tatimor

1. Institucionet Supreme të Auditimit, kanë të drejtë të auditojnë mbledhjen e taksave dhe të shqyrtojnë dosjet individuale tatimore.
2. Kontrollat tatimore janë kryesisht auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, megjithatë, në zbatim të ligjeve tatimore, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të shqyrtojnë edhe sistemin dhe efikasitetin e mbledhjes së taksave, arritjen e objektivave të të ardhurave dhe sipas rastit, të propozojnë përmirësime në organin legjislativ .

Neni 21 Kontratat publike dhe punët publike

1. Fondet e konsiderueshme të shpenzuara nga autoritetet publike në kontrata dhe punë publike, justifikojnë auditimin e fondeve të përdorura.
2. Prokurimi Publik është procedura më e përshtatshme për marrjen e ofertës më të favorshme në aspektin e çmimeve dhe të cilësisë. Institucionet e Auditimit duhet të përcaktojnë arsyet në rastet kur nuk zhvillohet procesi i tenderimit.
3. Gjatë auditimit të punëve publike, Institucionet e Auditimit duhet të nxisin zhvillimin e standardeve të përshtatshme për administrimin më të mirë të tyre.
4. Auditimet e punëve publike, mbulojnë jo vetëm rregullsinë e pagesave, por edhe efikasitetin e menaxhimit të strukturës dhe cilësinë e punës .

Neni 22 Auditimi i përpunimit të të dhënave elektronike

Fondet e konsiderueshme të shpenzuara në përpunimin e të dhënave elektronike, gjithashtu kërkojnë një auditim të kujdesshëm. Auditime të tilla do të bazohen në sistem dhe do të mbulojnë aspekte të tilla si planifikimi i kërkesave; përdorimi ekonomik i pajisjeve të përpunimit të të dhënave; përdorimi i stafit me eksperiencën e përshtatshme, parandalimi i keqpërdorimit dhe dobia e informacionit të dhënë.

Neni 23 Sipërmarrjet komerciale me pjesëmarrjen e publikut

1. Zgjerimi i veprimtarive ekonomike të qeverisë shpesh rezulton në krijimin e ndërmarrjeve sipas ligjit privat. Këto ndërmarrje do të jenë subjekt i auditimit nga ana e Institucionit Suprem të Auditimit, në qoftë se Qeveria ka pjesëmarrje të konsiderueshme në to - veçanërisht kur kjo zotëron shumicën - ose ushtron një ndikim dominues.
2. Do të jetë më e përshtatshme, që për këto sipërmarrje të zhvillohet një post-auditim, i cili do të fokusohet në çështjet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.
3. Raportimi në Parlament dhe për publikun, në lidhje me këto sipërmarrje do të bëhet në respekt të kufizimeve të nevojshme për mbrojtjen e sekreteve industriale dhe tregtare

Neni 24 Auditimi i institucioneve të subvencionuara

1. Institucionet Supreme të Auditimit kanë të drejtë të auditojnë përdorimin e subvencioneve të dhëna nga fondet publike.
2. Kur subvencioni është në vlera të mëdha, qoftë vetë ose në lidhje me të ardhurat dhe kapitalin e organizatës që subvencionon, auditimi mund të përfshijë të gjithë menaxhimin financiar të institucionit të subvencionuar.
3. Keqpërdorimi i subvencioneve kërkon shlyerjen e dëmeve

Neni 25 Auditimi i organizatave ndërkombëtare dhe shumëkombëshe

- 1.** Organizatat ndërkombëtare dhe multinacionale, shpenzimet e të cilëve mbulohen nga kontributet e vendeve anëtare, do të jetë subjekt i auditimit të jashtëm, të pavarur.
- 2.** Pavarësisht se këto auditime duhet të marrin parasysh nivelin e burimeve të përdorura dhe detyrat e këtyre organizatave, ata duhet të ndjekin parimet e auditimit ashtu si kryhen nga Institucionet Supreme të Auditimit në vendet anëtare.
- 3.** Për të siguruar pavarësinë e auditimeve, anëtarët e grupit të auditimit të jashtëm emërohen kryesisht nga Institucionet Supreme të Auditimit.

ISSAI 11 – Deklarata e Meksikës

**PAVARËSIA E INSTITUCIONEVE
SUPREME TË AUDITIMIT**

Hyrje

Nga Kongresi i 19-të i INTOSAI-it, që u mbajt në Meksiko, institucionet e auditimit suprem vendosën:

Të adoptojnë, publikojnë dhe shpërndajnë dokumentin e titulluar “Deklarata e Meksikos mbi Pavarësinë”

Të përgjithshme

Institucionet e auditimit suprem (SAI) njohin në përgjithësi tetë parime bazë, të cilat burojnë nga Deklarata e Limës dhe vendimet e marra në Kongresin e 17-të të INTOSAI-it në Seul, Kore e Jugut, si kërkesa themelore që sektori i auditimit publik të funksionojë siç duhet.

Parimi 1

Ekzistenca e një kuadri të përshtatshëm dhe efektiv kushtetues / statutor / ligjor dhe e dispozitave të aplikimit në praktikë të kësaj kornize.

Legjislacioni parashikon në detaje shkallën e pavarësisë së kërkuar nga SAI.

Parimi 2

Pavarësia e drejtuesve të SAI-t dhe e anëtarëve (të institucioneve kolegjiale të tij), duke përfshirë sigurinë e mandatit dhe imunitetin ligjor në kryerjen normale të detyrave të tyre.

Legjislacioni i zbatueshëm përcakton kushtet për emërimet, ri-emërimet, punësime, shkarkime dhe daljen në pension të drejtuesit të SAI-t dhe anëtarëve të institucioneve kolegjiale, të cilët janë

- emëruar, ri-emëruar, ose larguar nga një proces që siguron pavarësinë e tyre nga Ekzekutivi (shih ISSAI-11, Udhëzimet dhe Praktikat e Mira në Lidhje me Pavarësinë e SAI-t);
- emërimet janë me kushte të caktuara dhe mjaft të gjata në kohë, për të lejuar që ata të kryejnë mandatin e tyre pa frikën e hakmarrjes, dhe

- të imunizuar ndaj çdo ndjekje penale për ndonjë vepër, në të shkuarën ose në të tashmen, që rezulton për shkak të kryerjes normale të detyrave të tyre, në varësi të rastit.

Parimi 3

Një mandat mjaft i gjerë dhe liri e plotë, në kryerjen e funksioneve të SAI-t.

SAI-t duhet të fuqizohen për të audituar:

- përdorimin e parave publike, burimeve ose aseteve, nga një marrës ose përfitues, pavarësisht nga natyra e tij/saj ligjore;
- grumbullimin e të ardhurave që i detyrohen qeverisë ose subjekteve publike;
- ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e llogarive qeveritare ose ato të subjekteve publike;
- cilësinë e menaxhimit financiar dhe raportimit;
- ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve të qeverisë ose subjekteve publike.

Përveç rasteve kur kërkohet në mënyrë specifike për ta bërë këtë nga legjislativi, SAI nuk kontrollon politikat e qeverisë ose ato të subjekteve publike, por kufizohet në auditimin e zbatimit të politikave. Duke respektuar ligjin, SAI-t janë të lirë nga ndërhyrjet nga legjislativi ose ekzekutivi në:

- Zgjedhjen e çështjeve të auditimit;
- Planifikimin, programimin, sjelljen, raportimin dhe ndjekjen e auditimeve të tyre;
- Organizimin dhe menaxhimin e funksionit të tyre; dhe
- Zbatimin e vendimeve të tyre, ku zbatimi i sanksioneve është pjesë e mandatit të tyre.

SAI-t nuk duhet të jenë të përfshirë, në asnjë mënyrë, në drejtimin e organizmave që ata auditojnë.

SAI-t duhet të sigurojnë që personeli i tyre nuk zhvillon një marrëdhënie shumë të afërt me subjektet që ata auditojnë, në mënyrë që ata të mbeten objektiv.

SAI-t duhet të kenë liri të plotë në kryerjen e përgjegjësisë së tyre, ata duhet të

bashkëpunojnë me qeveritë apo subjektet publike që përpiqen të përmirësojnë përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike.

SAI-t duhet të përdorin standardet e auditimit, dhe një kod të etikës, bazuar në dokumentet zyrtare të INTOSAI-t, të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve, ose standarde të tjera të njohura. SAI-t duhet të dorëzojnë një raport vjetor mbi aktivitetin e legjislativit dhe organet e tjera shtetërore siç kërkohet nga kushtetuta, statutet, ose legjislacioni, të cilat duhet të vendosen në dispozicion të publikut.

Parimi 4

Qasje e pakufizuar në informacion

SAI duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për të marrë në kohë, të ketë një qasje të drejtpërdrejtë dhe të lirë në të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme, për kryerjen e duhur të përgjegjësive të tyre ligjore.

Parimi 5

E drejta dhe detyrimi për të raportuar mbi punën e tyre

SAI nuk duhet të kufizohet për të raportuar mbi rezultatet e punës së tij. Duhet të kërkohet me ligj që SAI të raportojë të paktën një herë në vit për rezultatet e punës së tij.

Parimi 6

Liria për të vendosur përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit dhe për t'i publikuar dhe shpërndarë ato.

SAI-t janë të lire të vendosin për përmbajtjen e raporteve të tyre të auditimit.

SAI-t janë të lirë për të bërë vërejtje dhe rekomandime në raportet e tyre të auditimit, duke marrë parasysh, sipas rastit, pikëpamjet e subjektit të audituar.

Legjislacioni përcakton kërkesat minimale të raportimit të auditimit të SAI-t dhe kur nevojitet, çështjet specifike që duhet të jenë subjekt i një opinionit formal auditimi ose certifikate.

SAI-t janë të lirë të vendosin për kohën e raporteve të tyre të auditimit, përveç rasteve kur janë përcaktuar me ligj kërkesa të veçanta raportimi.

SAI mund të përshtasë kërkesat specifike për hetime ose auditime të ardhura nga parlamenti ose një prej komisioneve të tij, ose nga qeveria.

SAI-t janë të lirë të publikojnë dhe shpërndajnë raportet e tyre, pasi i kanë dorëzuar zyrtarisht ato pranë autoriteteve të caktuara, siç kërkohet nga ligji.

Parimi 7

Ekzistenca e mekanizmave efektivë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të SAI-ve

SAI-t i dorëzojnë raportet e tyre sipas rastit, legjislativit, një prej komisioneve të tij, apo një audituesi nga Bordi Drejtues, për shqyrtim dhe ndjekje mbi rekomandime specifike për veprime korrigjuese.

SAI-t kanë sistemet e tyre të brendshëm për të ndjekur dhe për tu siguruar se subjektet e audituara i adresojnë saktë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre, si dhe ato të parlamentit, një prej komisioneve të tij, ose të bordit qeverisës, sipas rastit.

SAI-t dorëzojnë raportet e tyre në lidhje me zbatimin e masave të lëna prej tyre legjislativit, një prej komisioneve të tij, ose në bordin drejtues të auditimit, sipas rastit, për shqyrtim dhe veprim, edhe kur SAI-t kanë pushtetin e tyre ligjor për ndjekjen dhe sanksionet.

Parimi 8

Autonomia financiare dhe menaxheriale / administrative dhe disponueshmëria e burimeve njerëzore, materiale dhe monetare të duhura.

SAI duhet të ketë në dispozicion burimet njerëzore, materiale dhe monetare të nevojshme dhe të arsyeshme - Ekzekutivi nuk duhet të kontrollojë ose drejtojë këto burime.

SAI-t menaxhojnë buxhetin e tyre dhe e ndajnë atë në mënyrë të përshtatshme.

Legjislativi ose një nga komisionet e tij është përgjegjës për të siguruar që SAI-t të kenë burimet e duhura për të përmbushur mandatin e tyre.

SAI-t kanë të drejtën e ankimit të drejtpërdrejtë në legjislativ nëse burimet e dhëna janë të pamjaftueshme për të lejuar përmbushjen e mandatit të tyre.

ISSAI 11

VLERËSIMI I PAVARËSISË SË SAI

Rezultatet e Rasteve Studimore

Qëllimi

Rastet studimore janë përdorur për :

- të testuar zbatimin nga SAI-et, të Deklaratës së Meksikos (për pavarësinë e SAI-ve), duke marrë parasysh sistemet e ndryshme të auditimit;
- shembujt e dhënë janë në lidhje me masat që duhet të merren në situatat kur një SAI nuk është në gjendje për të përmbushur disa kushte parimore që lidhen me pavarësinë dhe
- që ndihmojnë në zhvillimin e linjave kryesore të punës së SAI-ve.

Metodologjia

Puna përgatitore në vijim është bërë për të fituar njohuri në lidhje me SAI-et e përzgjedhura për rastet studimore:

- Diskutimet u zhvilluan mes stafit të Sekretariatit të INTOSAI-it dhe Sekretarit të Përgjithshëm të rajoneve.
- Raportet e vendeve të ndryshme të përgatitura në seminarin e Vjenës për Pavarësinë e SAI –ve.
- Janë riparë Websites.
- Janë përdorur edhe metoda të tjera, si intervista dhe vizita në SAI.

Çështjet e mëposhtme janë mbajtur në konsideratë gjatë zhvillimit të studimit:

- Mos përsëritja e pyetjeve nga studimet e mëparshme për pavarësinë e SAI-ve.
- Pyetjet bazë i referohen draftit të diskutuar në Vjenë në vitin 2004.
- Përdorimi i pyetjeve të njëjta për të gjitha rastet studimore.
- Testimi i elementëve për të cilët ka pasur marrëveshje të pjesshme dhe mosmarrëveshje të plotë në diskutimet e grupit të punës në Vjenë.
- Parashikimi i hapësirës së nevojshme për komente, për rastet kur :
 - SAI ka qenë në gjendje të përmirësojë pavarësinë e tij,

- zonat ku SAI beson se janë më të rrezikuara në lidhje me funksionim e pavarësisë së tij dhe
- metodat që duhen përdorur për të zvogëluar rrisqet që lidhen me prekjen e pavarësisë së SAI-ve.

Puna përgatitore në vijim është bërë përpara fillimit të rasteve studimore :

- Përgatitja e një draft-pyetëtori
- Shpërndarja e pyetëtorit, metodologjisë dhe vendet e përzgjedhura tek të gjithë anëtarët e nënkomitetit për komentet e tyre.
- Përfundimi i pyetëtorit.
- Njoftimi i Komitetit të Standarteve profesionale për listën e vendeve të përzgjedhura për rastin studimor dhe për metodologjinë, të cilat do ti dërgohen Bordit Drejtues të INTOSAI-it për shqyrtim dhe miratim.
- Njoftimi i SAI-ve dhe Sekretariatit të tyre rajonal që janë përzgjedhur për rastin studimor.
- Dërgimi i pyetëtorit tek SAI i përzgjedhur.
- Kryerja e intervistave dhe vlerësimi i rasteve studimore.

Popullata e synuar dhe përqindja e realizimit konkret

Rastet studimore ishin përzgjedhur te tilla që të mbulonin të gjithë ose shumicën e rajoneve të INTOSAI-it. Ne studim ishin të përfaqësuar të gjithë llojet e institucioneve të Auditimit Suprem (Gjykata e llogarive, Bordi i auditimit,) që kanë nivele të ndryshme pavarësie. Përveç kësaj, janë përzgjedhur vetëm SAI-et që treguan interes real për të marrë pjesë në këtë studim.

Rastet e studimit janë zgjedhur bazuar në sugjerimet e sekretarëve të përgjithshëm të grupeve rajonale të punës të INTOSAI-it dhe u përzgjedhën vetëm SAI-et që vullnetarisht u ofruan për të marrë pjesë në studim. Nga nëntë SAI që u ofruan vullnetarisht, tetë u përgjigjën : Maroku, Filipinet, Mikronezia, Zelanda e Re, Tonga, Saint Lucia, Gana dhe Qipro- një përgjigje në masën 90 për qind e SAI-ve të synuara.

Rezultatet

Pjesëmarrësit u pyetën për të dhënë përgjigje të hollësishme katër pyetjeve të mëposhtme, bazuar në tetë parimet bazë të *Draft Deklaratës së Meksikos për Pavarësinë*:

Pyetja 1

Duke pasur parasysh parimet dhe dispozitat e zbatuara, jeni të mendimit se ju përmbushni të gjitha ose disa nga kërkesat për një SAI të pavarur dhe të shpjegoni si?

Mesatarisht, pjesëmarrësit u përgjigjen se ata në përgjithësi plotësojnë kërkesat për një SAI të pavarur (përqindjet e afishuara përmbri çdo parimi). Megjithatë, ata pranojnë se disa parime nuk janë plotësuar fare ose kërkojnë përmirësime të dukshme. Një përqindje shumë e vogël e pjesëmarrësve mendojnë se ata i përmbushin të gjitha kërkesat për një SAI të pavarur. Një përqindje tjetër, shumë e vogël e pjesëmarrësve pranojnë se pavarësia e tyre sigurohet edhe kur ata plotësojnë vetëm disa nga parimet bazë sepse besojnë në aftësitë e tyre për të vepruar të pavarur nga ekzekutivi.

Shpjegimet e mëposhtme lidhen me mendimin e pjesëmarrësve, në lidhje me përmbushjen e kërkesave të pavarësisë së SAI-t të tyre referuar parimeve bazë :

Parimi 1

Ekzistenca e një kuadri të përshtatshëm dhe efektiv kushtetues/ ligjor/ juridik dhe dispozitat konkrete të aplikuara për këtë parim (75 për qind e të anketuarve mendonin që ky parim përmbushet).

Shumica e pjesëmarrësve të rastit studimor kanë deklaruar se pavarësia e tyre është shkruar qartë në legjislacion. Kornizat ligjore ndryshojnë në varësi të akteve normative të çdo vendi. Në pothuajse të gjitha rastet, legjislacioni parashikon në detaje se sa i pavarur është SAI, mbështetur në kritere të tilla si:

- Performanca e funksioneve të tij, detyrave dhe kompetencave;
- Organizimi dhe menaxhimi i burimeve të tij; dhe
- Organizimi dhe menaxhimi i produkteve dhe raportimeve të tij

Shumica e pjesëmarrësve vunë në dukje se ekziston legjislacioni i duhur dhe efektiv. Disa prej tyre treguan se ndonjëherë Ekzekutivi pengon zbatimin me efektivitet të legjislacionit dhe dhanë arsytet e mëposhtme:

- paqëndrueshmëria politike,
- roli i qeverisë në përcaktimin e sakte të fondeve të alokuara,
- si dhe ndikimi i qeverisë në buxhetet e akorduara dhe në burime të tjera.

Fushat në të cilat rrezikohet më shumë pavarësia e SAI-ve do të trajtohen më poshtë (pyetja tre e këtij materiali).

Parimi 2

Pavarësia e krerëve të SAI-ve dhe e "anëtarëve" (në rastet e institucioneve kolegjiale), duke përfshirë sigurinë e qëndrimit në këtë detyrë dhe imunitetin ligjor gjatë kohës së ushtrimit të funksioneve të tyre (75 për qind e të anketuarve mendonin që ky parim është i realizuar në praktikë).

Shumica e pjesëmarrësve treguan se kryetarët e SAI-ve janë emëruar, ri-emëruar, ose janë shkarkuar nga parlamenti, ose nga Kryetari i Shtetit me miratimin e legjislativit. Këto terma dhe kushte janë të specifikuara në legjislacionin e zbatueshëm të çdo vendi (SAI).

Të anketuarit mendojnë që mandatet duhet të jene të kufizuar në kohë, të kenë limit në moshë (si minimal ashtu edhe maksimal). Megjithatë, 25 për qind e pjesëmarrësve theksuan se mandati për kreun e SAI-t është shumë i shkurtër dhe në këto kushte krerët e SAI-ve nuk e kanë kohën e mjaftueshme për të përmbushur detyrat e caktuara.

Së fundi, shumica e pjesëmarrësve mendojnë se ata nuk kanë mbrojtjen e duhur nga ndjekja ligjore për çdo veprim të kryer për shkak të detyrës. Vetëm një i anketuar ka treguar se gëzon një imunitet të tillë sipas legjislacionit.

Parimi 3

Një mandat të mjaftueshëm dhe liri të plotë veprimi në kryerjen e funksioneve të SAI-it (87.5 për qind e të anketuarve mendojnë që ky parim përmbushet).

Shumica apo të gjithë pjesëmarrësit e rasteve studimore mendojnë se ata kanë një mandat të mjaftueshëm dhe liri të plotë për të kryer funksionin e tyre në mënyrë efektive, efikase dhe të pavarur, duke përfshirë fuqinë për të audituar :

- përdorimin e parave publike apo asetëve;
- mbledhjen e të ardhurave të qeverisë;
- ligjshmërinë e llogarive qeveritare dhe të subjekteve;
- cilësinë e menaxhimit financiar dhe raportimit;
- ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e operacioneve të qeverisë; dhe
- zbatimin e Politikave të qeverisë (e kufizuar vetëm për zbatim)

Pesëdhjetë përqind e pjesëmarrësve pranojnë se mandatet e tyre mbulojnë vetëm efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve të qeverisë. Megjithatë, një progres po behet në shtimin e kompetencave të audituesve për auditimin e llogarive të qeverisë.

Në shumicën e rasteve, mandati i pjesëmarrësve përfshin lirinë e drejtimit dhe ndërhyrjen e legjislativit në zgjedhjen e çështjeve të auditimit dhe në planifikimin, programimin, sjelljen, raportimin dhe ndjekjen e auditimeve. Të anketuarit, në 25 për qind të rasteve janë përgjigjur se plani vjetor i punës (çështjet e auditimit) diskutohet çdo vit në Parlament përpara implementimit dhe zbatimit të tij dhe varet shumë nga disponueshmëria e burimeve të dhëna nga parlamenti dhe/ose miratimi nga ekzekutivi. Edhe pse shumica e pjesëmarrësve mendojnë se ata nuk kanë ndërhyrje nga drejtuesit dhe nga Parlamenti për mënyrën se si ata organizojnë dhe menaxhojnë punët e tyre, 50 për qind e tyre mendojnë se ata nuk kontrollojnë burimet, të cilat janë të nevojshme për të realizuar pavarësinë e plote të institucioneve të tyre.

Shumica e pjesëmarrësve mendojnë se ata nuk janë të përfshirë në menaxhimin e institucionit dhe nuk zhvillojnë një marrëdhënie të ngushtë me subjektet që auditojnë. Megjithatë, 25 për qind prej tyre mendojnë se kjo është një zonë delikate, për shkak të mungesës së burimeve dhe mungesës së ekspertizës nga ana e klientëve.

Të gjithë pjesëmarrësit u përgjigjën se ata punojnë në mënyrën e duhur, aplikojnë standartet e auditimit dhe aplikojnë kodin e etikës gjatë punës

së tyre ne subjekte dhe gjithashtu respektojnë kodin e etikës të subjekteve që auditohen prej tyre.

Parimi 4

Akses të pakufizuar në informacion (100 për qind e të anketuarve mendonin që përmbushej ky parim).

Të gjithë pjesëmarrësit vunë në dukje faktin që ata kanë akses pa pengesa, të plotë, të drejtpërdrejtë dhe në kohë tek të gjitha dokumentet për të cilat ata kanë nevojë për të përmbushur përgjegjësitë e tyre. Ata gjithashtu treguan se ata kanë kompetencat e nevojshme për të marrë këto dokumente dhe informacione nga njerëzit apo subjektet që i kanë ato.

Parimi 5

E drejta dhe detyrimi për të raportuar mbi punën (86 për qind mendonin që përmbushej ky parim).

Shumica e pjesëmarrësve treguan se ata nuk janë të kufizuar në raportimin e rezultateve të punës së tyre të auditimit. Në fakt, shumica treguan se ata janë të detyruar me ligj të raportojnë rezultatet një here në vit (te paktën). Të paktën 25 për qind e raportimeve që nuk janë të kërkuara nga ligji, duhet që të bëhen përpjekje për ti raportuar çdo vit. Megjithatë, vonesat e gjata janë të shpeshta për shkak të mungesës së burimeve dhe në një rast, për shkak të ndërhyrjeve politike.

Parimi 6

Liria për të vendosur mbi përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit dhe për të publikuar dhe shpërndarë ato (86 për qind e të anketuarve mendonin që përmbushej ky parim).

Shumica e të anketuarve treguan se ata kanë lirinë për të vendosur mbi përmbajtjen e raporteve të tyre të auditimit, edhe pse një SAI ka treguar se ai është i ndikuar ndonjëherë, në varësi të ndjeshmërisë së çështjes që auditohet. Të gjitha SAI-et kanë deklaruar se ata janë të lirë për të bërë vërejtje dhe rekomandime në raportet e tyre të auditimit.

Shumica e pjesëmarrësve tregoi se ata kanë kufizime ligjore kohore për dorëzimin e rezultateve vjetore në Parlament. Megjithatë, ata nuk kanë afate kohore për publikim e raporteve të auditimit. Pak më shumë se 10

për qind ka shtuar se për shkak të mungesës së burimeve dhe auditimeve të grumbulluara, paraqitja e raporteve të auditimit mund të jetë e vështirë për tu menaxhuar.

Së fundi, të gjithë të intervistuarit treguan se ata janë të lirë të publikojnë dhe shpërndajnë raportet e tyre, pasi ata janë paraqitur formalisht (siç kërkohet me ligj).

Parimi 7

Ekzistenca e mekanizmave efektivë në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të SAI-it (86 për qind mendojnë që e përmbushin këtë parim).

Pjesëmarrësit treguan se disa raporte të auditimit janë dorëzuar në Parlament ose në Bordin drejtues për shqyrtim dhe për ndjekje. Të gjithë pjesëmarrësit vunë në dukje gjithashtu se ata kanë një sistem të brendshëm për të ndjekur dhe për tu siguruar që vërejtjet dhe rekomandimet e tyre, si dhe ato të Parlamentit janë konsideruar si duhet nga subjektet e audituara. Interesant është fakti që një SAI vuri në dukje se në vendin e tij, subjekti i audituar duhet të ngrejë një Komitetit të Implementimit të Raportit të Auditimit për të ndjekur dhe për tu siguruar që rekomandimet e auditimit janë zbatuar.

Parimi 8

Pavarësia financiare dhe menaxheriale / administrative dhe disponueshmëria e stafit të duhur, si edhe burimet monetare dhe materiale (38 për qind mendojnë që ky parim përmbushet).

Ky parim është zona ku shumica e pjesëmarrësve e mendonin më sensibil, më delikat (parimi i pavarësisë). Vetëm 38 për qind e të anketuarve mendojnë se :

- ata kanë pavarësi financiare,
- buxheti i tyre vjetor miratohet dhe dërgohet nga parlamenti,
- ata kanë pushtet të plotë për të menaxhuar buxhetin e tyre dhe janë të lirë ta ndajnë atë si ta shikojnë të përshtatshme, dhe
- kanë të drejtën e ankimit të drejtpërdrejtë tek Legjislativi nëse burimet e ofruara janë të pamjaftueshme për të përmbushur mandatin e tyre.

Të anketuarit e tjerë treguan se, aktualisht, ky parim nuk është plotësuar dhe vunë në dukje se kjo mbetet një fushë që ka nevojë për përmirësim të madh. (Shih pyetjet 3 dhe 4 për më shumë detaje.)

Pyetja 2

Nëse nuk janë përmendur të gjitha ose disa nga kërkesat e përcaktuara në parimet dhe dispozitat e parashikuara, a keni arritur të njëjtat objektiva, por me mjete të ndryshme, duke përdorur masa të tjera mbrojtëse për të arritur pavarësinë? Nëse po, ju lutem shpjegoni se si ju i përmbushni objektivat dhe pse, sipas mendimit tuaj, këto masa janë një mjet mbrojtës i pavarësisë?

Shumë pak pjesëmarrës janë përgjigjur për këtë pyetje, sepse në qoftë se ata nuk janë në gjendje për të përmbushur kërkesat, barriera serioze i pengojnë ata për të arritur të njëjtat objektiva përmes mjeteve të ndryshme.

Disa SAI që nuk ju përgjigjen kësaj pyetje e konsiderojnë veten të cenuar në fusha të caktuara, por në gjendje ta “rrethojnë” këtë rrezik duke zbatuar masa të ndryshme mbrojtëse për të arritur pavarësinë.

Një nga të anketuarit evidentoi se ndërsa nuk ka mekanizma formalë në SAI-n e tyre për ndjekjen e rekomandimeve, ka

- marrëdhënie të forta me komitetet e zgjedhur të auditimit, të cilët janë përdorur për informime dhe prezantime të raporteve dhe rekomandimeve;
- dhe disa mekanizma informalë për raportet dhe rekomandimet për të tërhequr vëmendjen e ekzekutivit, të tilla si takime të rregullta në mes të ekzekutivit, strukturave të qeverisë, Thesarit etj .

Pyetja 3

A ka ndonjë fushë ku ju mendoni se jeni më të cënueshem në lidhje me pavarësinë dhe nëse po, shpjegoni?

Në vijim janë sfidat, pengesat ose rreziqet për pavarësinë e SAI-ve:

- Qeveria ka një rol në përcaktimin, ndarjen dhe alokimin e fondeve të buxhetit dhe të burimeve të tjera.
- Mandata shumë të shkurtra për kryetarët e SAI-ve, do thotë se ata nuk kanë kohën e mjaftueshme për të zbatuar planet e tyre të auditimit në mënyrë efektive ose realizimin efikas të mandateve të tyre.
- Nuk ka imunitet nga ndjekja ligjore për çdo akt që rezulton për shkak të përmbushjes së detyrës.
- Ndryshime ligjore janë të nevojshme.
- SAI organizon dhe menaxhon punën me buxhetin që ka në dispozicion.
- Mungesa e kontrollit nga ana e legjislativit mbi burimet e SAI-t mundëson që ky i fundit të ketë pushtet të plotë dhe pavarësi mbi organizimin dhe menaxhimin e institucionit.
- Mungesa e burimeve detyron ndonjëherë audituesit të rrezikojnë pavarësinë dhe integritetin e tyre.
- Mungesa e ekspertizës së klientëve dhe madhësia e SAI-t mund të pengojnë objektivitetin dhe pavarësinë e audituesve.
- Mungesa e burimeve të duhura kompetente, ndikon në kohën e përfundimit të raportit, i cili, nga ana tjetër, krijon vonesa në rezultatet e auditimit.
- Çështjet që janë konsideruar më të ndjeshme, ndonjëherë ndikojnë në përmbajtjen e raportit.
- Nuk ka asnjë forum parlamentar në të cilën SAI mund të jetë i sigurt se raportet e tyre të auditimit do të marrin vëmendjen e parlamentarëve.
- Nga ekzekutivi nuk kërkohet që të përgjigjet në Parlament për rekomandimet e raporteve.
- Ka një mungesë të burimeve adekuate dhe të parashikueshme financiare.
- Pavarësia e SAI-ve është e kufizuar, pasi ata nuk kanë autoritetin apo lirinë për të marrë burimet që ata kanë nevojë për të ushtruar kompetencat e tyre në mënyrë efektive.
- Mospërputhje të konsiderueshme ekzistojnë ndërmjet buxhetit vjetor, propozimeve dhe ndarjeve aktuale, duke përfshirë problemet me kohën e lëvrimin të fondeve nga Thesari.
- Ekzekutivi ushtron një ndikim të madh në procesin e miratimit të buxhetit, i cili çon në shkurtime të mëdha të propozimeve buxhetore të bëra.

- Edhe pse SAI-et kanë të drejtën e ankimit të drejtpërdrejtë, ankesa zakonisht refuzohet.

Pyetja 4

Përkrahësi për ne, rastet kur ju keni qenë në gjendje të përmirësoni pavarësinë e SAI-t tuaj dhe na tregoni se si keni mundur ta realizoni këtë ?

Edhe pse pjesëmarrësit kanë treguar sfida të rëndësishme, barrierat dhe rreziqet për pavarësinë e SAI-ve të tyre, ata gjithashtu kanë treguar aftësinë e tyre për të përmirësuar nivelin e tyre të pavarësisë. Rastet e mëposhtme janë raste të izoluara, në të cilat SAI specifike kanë qenë në gjendje për të bërë përmirësime të tilla.

Rritja e kërkesave për pavarësi të profesionale të SAI-t.

- Po përmirësohet puna e SAI-ve në drejtim të propozimit të projekt-ligjeve për përmirësimin e kuadrit strukturor të SAI-ve, sidomos marrëdhënia e saj me ekzekutivin dhe legjislativin, si edhe mandati për auditimin e performancës. Rishikimi i kornizave ligjore.
- SAI-t kanë miratuar sjelljen organizative, në mënyrë që të çfaqen më të pavarur nga ekzekutivi duke u angazhuar me të vetëm për auditimet, duke u distancuar nga qëllimet e tyre politike.
- SAI-t po zbatojnë një sistem të brendshëm për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve.

Përfundime

Ky raport përmbledh përgjigjet e rasteve studimore në lidhje me besnikërinë ndaj Draft Deklaratës së Meksikos për Pavarësinë dhe përgjigjet e tyre në lidhje me katër pyetje të përfshira në pyetësorin e përgatitur nga ana e Nënkomitetit.

Pjesëmarrësit e rasteve studimore janë të mendimit se në përgjithësi përmbushen kërkesat për një SAI të pavarur. Megjithatë, shumë prej tyre treguan se ata kanë ende sfida në përmbushjen e parimeve të Deklaratës së Pavarësisë së Meksikos. Këto sfida janë konsideruar nga disa si

pengesa për pavarësinë e tyre, nga të tjerët dhe si mundësi për përmirësim. Në shumicën e rasteve, pjesëmarrësit kanë ngritur shqetësime të ngjashme në lidhje me prekjen e autonomisë financiare dhe menaxheriale dhe të dy principeve që janë konsideruar si më sfidueset për SAI.

Së fundi, edhe pse shumica apo të gjithë pjesëmarrësit treguan se ka vend për përmirësim, shumë pak u përgjigjen për pyetjen 4, e cila kërkon që ata të përshkruanin një situatë në të cilën SAI i tyre ishte në gjendje për të përmirësuar pavarësinë e tij dhe metodën e përdorur për të arritur këtë objektiv.

ISSAI 20

Përgjegjësitë e SAI-t

Qëllimi dhe Objektivat

Qëllimi i këtij dokumenti është të avancojë principet e transparencës dhe llogaridhënies për SAI-t, në mënyrë që t'i ndihmojnë ata me shembull për të çuar përpara qeverisjen e tyre dhe praktikën. SAI-t janë pjesë e një sistemi të përgjithshëm ligjor dhe kushtetues në vendet përkatëse dhe janë përgjegjëse ndaj palëve të ndryshme, duke përfshirë organet legjislative dhe publikun. SAI-t janë gjithashtu përgjegjës për planifikimin dhe kryerjen e funksioneve të punës së tyre, duke përdorur metodologjitë dhe standardet e duhura për t'u siguruar që ata promovojnë përgjegjshmërinë dhe transparencën mbi aktivitetet publike, të zbatojnë ligjin dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre në mënyrë të plotë dhe objektive.

Një sfidë e madhe me të cilën përballen të gjitha SAI-t është që të promovojë kuptimin më të mirë të roleve dhe detyra të tyre të ndryshme në shoqëri, pra për publikun dhe administratën. Në përputhje me mandatet e tyre dhe kornizat ligjore që i rregullojnë, informacioni në lidhje me SAI-t duhet të jetë lehtësisht i arritshëm. Proceset e tyre të punës, aktivitetet dhe produktet duhet të jenë transparente. Ata gjithashtu duhet të komunikojë hapur me median dhe palët e tjera të interesit, si dhe të jenë të dukshme në arenën publike.

Ky dokument përbën një pjesë integrale të standardeve të tjera ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAIs) dhe parimet janë të destinuara për t'u përdorur në lidhje me këto standarde. SAI-t veprojnë nën mandate dhe modele të ndryshme. Këto parime nuk mund të jenë njësoj të zbatueshme për të gjitha SAI-t, por me qëllim të orientoi SAI-t në një qëllim të përbashkët, si transparenca dhe llogaridhënia.

Konceptet e përgjegjshmërisë dhe transparencës

Sundimi i ligjit dhe demokracisë janë themelet për kryerjen e një auditimi të pavarur dhe të përgjegjshëm të qeverisë dhe do të shërbejë si një nga shtyllat mbi të cilat Deklarata e Limë-s është themeluar. Pavarësia, përgjegjshmëria dhe transparenca e SAI-t janë parakushte thelbësore në një demokraci të bazuar në sundimin e ligjit dhe i mundësojnë SAI-t të udhëheqë me shembuj dhe të rrisë besueshmërinë e tij.

Llogaridhënia dhe transparenca janë dy elemente të rëndësishme të qeverisjes së mirë. Transparenca është një forcë e fuqishme që kur aplikohet vazhdimisht, mund të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të nxitur llogaridhënien.

Llogaridhënia dhe transparenca nuk mund të ndahen lehtë: ato të dyja përfshijnë shumë prej veprimeve të njëjta, për shembull, raportimin publik.

Koncepti i përgjegjësisë i referohet kuadrit ligjor dhe strukturës së raportimit, asaj organizative, strategjive, procedurave dhe veprimeve për të ndihmuar dhe të siguruar që:

- SAI-t përmbushin detyrimet e tyre ligjore në lidhje me mandatin e tyre të auditimit dhe të raportimit të kërkuar brenda buxhetit të tyre.
- SAI-t vlerësojnë dhe ndjekin punën e tyre, si dhe ndikimin e auditimit të tyre.
- SAI-t raportojnë mbi rregullsinë dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve publike, duke përfshirë veprimet e tyre dhe përdorimin e burimeve të SAI-t.
- Kryetari i SAI-t, anëtarët (e institucioneve kolegjiale) dhe personeli i SAI-t mund të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre.

Nocioni i transparencës i referohet dhënies nga SAI të një raporti auditimi të besueshëm, të qartë dhe të rëndësishëm brenda statusit të tij, mandatit, strategjive, aktiviteteteve, menaxhimin financiar dhe performancës. Përveç kësaj, ai përfshin detyrimin e raportimit publik mbi gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe të aksesit publik ndaj informacionit rreth SAI-t.

Parimet

Parimi 1

SAI-t i kryejnë detyrat e tyre sipas një kuadri ligjor që kërkon përgjegjshmëri dhe transparencë.

- SAI-t duhet të kenë një legjislacionin dhe rregulloret ku atyre u tregohet se ndaj cilave organe ata mund të jenë përgjegjës dhe të përgjegjshëm.
- Legjislacioni i tillë dhe rregulloret në përgjithësi mbulojnë (1) autoritetin e auditimit, juridiksionin dhe përgjegjësitë, (2) kushtet që rrethojnë emërimin dhe shkarkimin e kreut të SAI-t dhe anëtarët e

institucioneve kolegjinale, (3) kërkesat për veprimtarinë dhe menaxhimin financiar të SAI-t, (4) botime të raporteve të auditimit, (5) mbikëqyrja e aktiviteteve të SAI-t, dhe (6) ekuilibri midis aksesit të publikut në informacion dhe konfidencialitetit të dëshmimeve të auditimit dhe të tjera informacione të SAI-t.

Parimi 2:

SAI-t të bëjnë publik mandatin e tyre, përgjegjësitë, misionin dhe strategjinë

SAI-t bëjnë publik mandatin e tyre, misionet e tyre, organizimin, strategjinë dhe marrëdhëniet me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë organet legjislative, ekzekutive dhe autoritetet.

- Kushtet e emërimit, riemërimit, të daljes në pension dhe largimit të kreut të SAI-t dhe anëtarëve të institucioneve kolegjinale bëhen publike.
- SAI-t inkurajohen të bëjnë publik informacionin themelor rreth mandatit të tyre, përgjegjësitë, misionin, strategjinë dhe aktivitetet në njërin nga gjuhët zyrtare të INTOSAI-t, përveç gjuhëve të tyre.

Parimi 3:

SAI-t miratojnë standardet e auditimit ,proceset dhe metodat që janë objektive dhe transparente.

- SAI-t miratojnë standardet dhe metodologjitë që përputhen me parimet themelore të auditimit të INTOSAI-t, të përpunuara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
- SAI-t i komunikojnë këto standarde dhe metodologji dhe mënyrën se si ato përputhen me ta.
- SAI-t komunikojnë qëllimin e aktiviteteve të auditimit që ata ndërmarrin nën mandatin e tyre, si dhe në bazë të vlerësimit të riskut të tyre dhe të proceseve të planifikimit.
- SAI-t komunikojnë me subjektet e audituara në lidhje me kriteret mbi të cilat ata do të bazojnë opinionet e tyre.
- SAI-t i informojnë subjektet e audituara në lidhje me objektivat e tyre të auditimit, metodologjinë dhe gjetjet.
- Gjetjet e SAI-t i nënshtrohen procedurave të komentit dhe rekomandimeve në diskutimet dhe përgjigjet nga subjektet e audituar.
- SAI-t kanë mekanizma vijuese efektive dhe raportojnë për rekomandimet e tyre, për të siguruar që subjektet e audituara duhet të

trajtojnë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre, sikurse ato të bëra nga ligji (ISSAI 10 mbi parimin e pavarësisë).

- Procedurat vijuese e lejojnë subjektin e audituar të sigurojë informacion mbi masat korigjuuese të marra ose pse veprimet korigjuuese nuk janë ndërmarrë.

- SAI-t duhet të zbatojë një sistem të përshtatshëm të sigurimit të cilësisë mbi aktivitetet e tyre dhe raportimet e auditimit; këto sisteme duhet të vlerësohen në mënyrë periodike dhe të pavarur.

Parimi 4:

SAI-t aplikojnë standarde të larta të integritetit dhe të etikës për stafin në të gjitha nivelet

- SAI-t kanë rregulla etike ose kodet, politikat dhe praktikat që janë të lidhur me ISSAI 30, Kodi i Etikës, përpunuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

- SAI-t parandalojnë konfliktet e brendshme të interesit dhe korrupsionit, për të siguruar transparencën dhe ligjshmërinë e veprimeve të tyre.

- SAI-t vazhdimisht promovojnë sjelljen etike në të gjithë organizatën.

- Kërkesat etike dhe detyrimet e audituesve, gjykatëve (në modelin e Gjykatës), nëpunësve civilë apo të tjerëve janë bërë publike.

Parimi 5:

SAI-t sigurojnë se këto përgjegjësi dhe parimet e transparencës nuk janë të komprometuara, kur ata kryejnë aktivitetet e tyre.

- SAI-t duhet të sigurohen që kontratat për aktivitetet e deleguara nuk komprometojnë këto përgjegjshmëri dhe parimet e transparencës.

- Delegimi i ekspertizës dhe auditimi i veprimtarive të subjekteve të jashtme, publike ose private, bie në kuadër të përgjegjësisë së SAI-t dhe është subjekt i politikave etike (sidomos konfliktin e interesit) dhe politikave për të siguruar integritetin dhe pavarësinë.

Parimi 6:

SAI-t i menaxhojnë operacionet e tyre me ekonomikitet, efikasitet, efektivitet dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret, si dhe raportojnë publikisht për këto çështje.

- SAI-t përdorin praktika të shëndosha të menaxhimit, duke përfshirë edhe kontrollet e duhura të brendshme mbi menaxhimin e tij financiar dhe operacionet. Kjo mund të përfshijë auditime të brendshme dhe masa të tjera të përshkruara në INTOSAI GOV 9100.

- Pasqyrat financiare të SAI-t bëhen publike dhe janë subjekt i auditimit të jashtëm të pavarur apo rishqyrtimit parlamentar.

- SAI-t vlerësojnë dhe raportojnë mbi operacionet e tyre dhe performancën në të gjitha fushat, të tilla si auditimi financiar, auditimi i përputhshmërisë, aktivitetet ligjore (SAI-t që janë Gjykata), auditimi i performancës, vlerësimin e programit dhe konkluzionet lidhur me aktivitetet qeveritare.

- SAI-t ruajnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kryer punën, për të arritur misionin e tyre dhe për të përbushur përgjegjësitë e tyre.

- SAI-t bëjnë publike buxhetin e tyre total dhe raportojnë mbi origjinën e burimeve të tyre financiare (ndarja parlamentare, buxheti i përgjithshëm, ministria e financave, agjencitë, taksat) dhe se si këto burime janë përdorur.

- SAI-t masin dhe raportojnë mbi efikasitetin dhe efektivitetin me të cilën ata përdorin fondet e tyre.

- SAI-t mund të përdorin gjithashtu edhe komitete të auditimit, të përbërë nga një shumicë e anëtarëve të pavarur, të shqyrtojnë dhe të japin kontributin për menaxhimin e tyre financiar dhe proceset e raportimit.

- SAI-t mund të përdorin treguesit e performancës për të vlerësuar vlerën e punës së auditimit të Parlamentit, qytetarët dhe palët e interesit.

- SAI-t masin shikueshmërinë e tyre publike, rezultatet dhe impaktin nëpërmjet reagimeve të jashtme.

Parimi 7:

SAI-t raportojnë publikisht mbi rezultatet e kontrolleve të tyre dhe konkluzionet e tyre lidhur me aktivitetet e përgjithshme qeveritare.

- SAI-t i bëjnë publike konkluzionet dhe rekomandimet e tyre, që rezultojnë nga auditimet, përveç rasteve kur ato konsiderohen konfidenciale nga ligjet dhe rregulloret e veçanta.

- Raporti i SAI-t duhet të përcjellë masat e marra në lidhje me rekomandimet e tyre.

- SAI-t që janë edhe gjykata raportojnë mbi sanksionet dhe gjobat e vendosura mbi zyrtarët apo menaxherët e kontabilitetit.

- SAI-t gjithashtu raportojnë publikisht mbi rezultatet e auditimit të përgjithshëm, p.sh. zbatimi i përgjithshëm i buxhetit të qeverisë, gjendja financiare dhe operacionet, përparimi i përgjithshëm i menaxhimit financiar, si dhe nëse ato përfshihen në kuadrin e tyre ligjor për kapacitetet profesionale.
- SAI-t duhet të mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet e auditimit e përfundimet, si dhe për të marrë masat e duhura.

Parimi 8:

SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht mbi aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimit bëhen publike përmes mediave, faqeve të internetit dhe me mjete të tjera.

- SAI-t komunikojnë hapur me mediat apo palët e interesit për veprimtaritë e tyre dhe rezultatet e auditimit, si dhe janë të dukshme në arenën publike.
- SAI-t nxisin interesin publik dhe akademik në konkluzionet e tyre më të rëndësishme.
- Abstraktet e raporteve të auditimit dhe vendimeve gjyqësore janë në dispozicion në një nga gjuhët zyrtare të INTOSAI-t, përveç gjuhëve të vendit.
- SAI-t kryejnë auditime dhe të lëshojnë raportet përkatëse në kohën e duhur.

Transparenca dhe përgjegjshmëria duhet të rritet në qoftë se puna e auditimit dhe të dhënat lidhur me të janë të vjetëruara.

- Raportet e SAI-t janë në dispozicion dhe të kuptueshme për publikun e gjerë nëpërmjet mjeteve të ndryshme (p.sh. përmbledhje, grafika, prezantime video, njoftime për shtyp).

Parimi 9:

SAI-t e përdorin këshillimin nga ekspertë të jashtëm dhe të pavarur për të rritur cilësinë dhe besueshmërinë e punës së tyre.

- SAI-t punojnë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe përpiqen të mësojnë vazhdimisht, duke përdorur udhëzime ose ekspertizë nga palët e jashtme.

- SAI-t mund të kërkojnë vlerësimin e një eksperti të jashtëm, të pavarur për operacionet e tyre dhe zbatimin e standardeve. Për këtë qëllim ata mund të përdorin shqyrtim e homologëve.
- SAI-t mund të përdorin ekspertë të jashtëm për të siguruar këshilla të pavarura, për çështjet teknike që lidhen me auditimin
- SAI-t publikisht raportojnë rezultatet e rishikimeve të homologëve dhe vlerësimet e ekspertëve të pavarur, të jashtëm.
- SAI-t mund të përfitojnë nga auditimet e përbashkëta ose paralele.
- SAI-t mund të kontribuojnë në përmirësimin e aftësive profesionale në menaxhimin financiar, duke rritur cilësinë e punës.

ISSAI 21

Praktikat më të Mira

Hyrje

Qëllimi dhe objektivat

ISSAI 20 paraqet parimet e transparencës dhe llogaridhënies për SAI-t, në mënyrë që t'i ndihmojë ata në drejtimin me shembuj dhe sipas praktikave më të mira.

Praktikat e mira të paraqitura në këtë dokument janë disa shembuj të praktikave të SAI-ve që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien. Në mënyrë që të mirëkuptohen, 20 parimet e para të këtij dokumenti janë përmbledhur në italic.

Ky është një dokument mbi mënyrën se si praktikat evoluojnë dhe zhvillohen metoda të reja për të inkurajuar SAI-t të ndajnë eksperiencat e tyre.

Parimet

Parimi 1

SAI-t kryejnë detyrat e tyre sipas një kuadri ligjor për llogaridhënie dhe transparencë.

- SAI-t duhet të kenë udhëzues dhe rregullore ligjore në bazë të të cilave ata mund të ruajnë përgjegjshmërinë.

- Një legjislacion i tillë në përgjithësi mbulon (1) autoritetin, juridiksion dhe përgjegjësitë e auditimit, (2) kushtet që përcaktojnë emërimin dhe shkarkimin e kreut të SAI-t dhe anëtarëve të institucioneve kolegjiale, (3) veprimtarinë dhe kërkesat e menaxhimit financiar të SAI-t, (4) botimi në kohë i raporteve të auditimit, (5) mbikëqyrja e aktiviteteve të SAI-ve dhe (6) ekuilibri mes aksesit të publikut në informacion dhe konfidencialitetin e dëshmive të auditimit të SAI-ve.

Praktikat më të mira

- Shumica e faqeve të internetit kanë një përmbajtje me titull "Legjislacioni" ose "Mandati ligjor", i cili detajon kornizën ligjore nën të cilën SAI funksionon dhe në disa raste edhe dokumentet përkatëse
- Në disa SAI, referencat në legjislacion për parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë janë të detajuara.

- Një numër i SAI-ve ofrojnë qasje në dokumentet parlamentare. Në disa prej tyre ofrohet një listë e gjerë e shkaqeve, për të cilat informacioni nuk mund të jepet.
- Disa SAI marrin të dhëna nga "Kodi i praktikave të mira për transparencën në politikat monetare dhe financiare" të FMN-së të miratuar në vitin 1999.

Parimi 2:

SAI-t bëjnë publike mandatin e tyre, përgjegjësitë, misionin dhe strategjinë

- *SAI-t vënë në dispozicion mandatin e tyre, misionet, organizimin, strategjinë dhe marrëdhëniet me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë organet legjislative, ekzekutive dhe autoriteteve.*
- *Kushtet e emërimit, riemërimit, të daljes në pension dhe largimin e kreut të SAI-t dhe anëtarëve të institucioneve kolegjiale.*
- *SAI-t janë të inkurajuar për të bërë publike informacione themelore rreth mandatit të tyre, përgjegjësisë, misionit, strategjisë dhe aktiviteteve, në gjuhët zyrtare të INTOSAI-t.*

Praktikat e mira

Shumica e SAI-ve publikojnë detajet e mandatit të tyre, përgjegjësitë, misionin dhe strategjitë.

- Disa SAI deklarojnë nëse ata kanë liri të plotë për të vendosur mbi auditimet që do të ndërmerren (p.sh. kur organe të tjerë janë në krye të auditimeve, për shembull në fondet ekstra-buxhetore dhe të sektorit të sigurisë).
- Një SAI ka një seri fletë-palosjesh në terma shumë praktike, në mënyrë që të ndihmojë parlamentarët dhe aktorë të tjerë të kuptojnë punën e tij (për shembull: si Zyra e Audituesit të Përgjithshëm kryen një auditim të performancës).
- Disa SAI vënë në dispozicion në faqen e tyre, broshura informative rreth detyrave dhe auditiveve të kryera, në dy ose më shumë gjuhë zyrtare të INTOSAI-t.
- Disa SAI i vënë në dispozicion këto informacione edhe në gjuhë të tjera

Parimi 3:

SAI-t miratojnë standarde, procese dhe metoda auditimi që janë objektive dhe transparente.

- *SAI-t miratojnë standarde dhe metodologji që përputhen me parimet themelore të auditimit të INTOSAI-t*
- *SAI-t komunikojë qëllimin e aktiviteteve të auditimit që ata ndërmarrin nën mandatin e tyre dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut të tyre edhe proceset e planifikimit.*
- *SAI-t komunikojnë me njësinë e audituar në lidhje me kriteret mbi të cilat ata do të bazojnë opinionet e tyre.*
- *SAI-t mbajnë të informuar njësitë e audituara, në lidhje me objektivat e tyre të auditimit, metodologjinë dhe gjetjet.*
- *SAI-t i nënshtrohen procedurave të komentimit të gjetjeve dhe rekomandimeve, nga njësia e audituar.*
- *SAI-t ndjekin zbatimin e vërejtjeve dhe rekomandimeve të tyre në praktike, për të siguruar që subjektet e audituara duhet të adresojnë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre në bazë të legjislacionit (ISSAI 10 mbi parimin e pavarësisë -7).*
- *Procedurat ndjekëse lejojnë që njësia e audituar të sigurojë informacion mbi masat korrigjuese të marra ose pse veprimet korrigjuese nuk janë ndërmarrë.*
- *SAI-t duhet të zbatojnë një sistem të përshtatshëm të sigurimit të cilësisë mbi aktivitetet e tyre dhe raportimet e auditimit, në vlerësimin periodik të pavarur.*

Praktikat më të mira

- Të gjitha SAI-t e anketuara e zbatojnë këtë parim. Megjithatë, përveç ISSAI-ve, disa SAI kanë lëshuar edhe manuale, direktiva funksionale, mjete dhe udhëzues.
 - Përsa i përket zbatimit të rekomandimeve të bëra nga SAI, mund të citohen tre shembuj
- Një SAI përfshin në raportimin periodik në Parlament një "raport Status" që ofron një vlerësim të asaj që qeveria ka bërë për të adresuar rekomandimet nga auditimet e performancës raportuar më parë;
 - Një tjetër SAI, në pjesën e dytë të raportit vjetor, mat numrin e rekomandimeve të ndjekura nga vërejtjet e dhëna

- Në raportin vjetor dorëzuar në Kuvend, SAI përmbledh rekomandimet më të rëndësishme të nxjerra në të gjitha raportet e auditimit të vitit.

- Një numër i SAI-ve:

- Publikon metodologjinë e tyre të auditimit në faqet e tyre në internet. Kjo përfshin punën e tyre dhe manualët financiarë të auditimit, si dhe udhëzues dhe mjete funksionale të auditimit.

- Boton në faqen e saj, listën e auditimeve të performancës së planifikuar.

- Përfshin në raportin e auditimit, përgjigjet nga subjekti i audituar.

- Te këtë rishikime periodike të jashtme nga kolegët për të siguruar që menaxhimi i cilësisë së tyre është projektuar në mënyrë të përshtatshme dhe që vepron në mënyrë efektive. SAI-t gjithashtu, kryejnë shqyrtimet për auditivet e tyre. Rezultatet e rishikimeve të kolegëve dhe përmbledhjet e rishikimeve praktike publikohen në faqet e internet, në raportet e tyre vjetore ose në ndonjë formë të shtypur.

SAI-t kryejnë një krahasim sistematik për të siguruar që udhëzimet e brendshme të auditimit të reflektojnë ato të ISSA-ve.

Parimi 4:

SAI-t aplikojnë standarde të larta të integritetit dhe të etikës për stafin e të gjitha niveleve.

- *SAI-t kanë rregulla etike , politika dhe praktika në përputhje me Kodin Etik ISSA 30,*

- *SAI-t parandalojnë konfliktet e brendshme të interesit dhe korrupsionit dhe sigurojnë transparencën dhe ligjshmërinë e veprimeve të veta.*

- *SAI-t në mënyrë aktive promovojnë sjelljen etike në të gjithë organizatën.*

- *Kërkesat etike dhe detyrimet e audituesve, magjistratët (në modelin e Gjykatës), nëpunësve të shërbimit civil apo të tjerëve, janë bërë publike.*

Praktikat më të mira

-SAI miraton një sërë vlerash dhe një kod të etikës dhe sjelljes profesionale që udhëheqin punën e saj.

-SAI është e angazhuar për transparencën dhe përdorimin e standardeve më të larta etike në administrimin financiar. Një SAI bën publike në faqen e saj të shpenzimeve të udhëtimit dhe mikpritjen e kreut të SAI-t dhe menaxhimit të lartë.

-Në dy SAI, audituesi, në fillim të çdo auditimi, nënshkruan një deklaratë të mungesës së konfliktit të mundshëm të interesit që mund të vlerësohet dhe të adresohet nga Drejtuesit e lartë.

- Gjithashtu, një numër i SAI-ve kanë miratuar një statut etik për magistratët e tyre dhe kanë krijuar një komision të etikës.

- Disa SAI kanë detyrim për të tërhequr anëtarët e tyre nga aktivitetet ku ata kanë një lidhje personale

- Një SAI ka të përfshirë në raportin e saj të auditimit çdo situatë ku ka ekzistuar një konflikt interesi dhe hapat që janë ndërmarrë nga SAI për të siguruar që nuk kishte asnjë punonjës i lartë përfshirje ose qasje në dokumente ose aktivitetet që kanë të bëjnë me auditimin.

-Në disa raste detyrimet etike përfshijnë marrjen e betimit nga ana e magistratit dhe regjistrimin e deklaratave.

Parimi 5:

SAI siguron që këto përgjegjësi dhe parimet e transparencës nuk kompromentohen, kur ata transferojnë aktivitetet e tyre.

- SAI duhet të sigurojë që kontratat për aktivitetet e deleguara nuk komprometojnë llogaridhënien dhe parimet e transparencës.

- Delegimi i ekspertizës dhe Auditimi i veprimtarive të subjekteve të jashtme, publike ose private është në kuadër të përgjegjësisë së SAI dhe është subjekt i politikave etike (sidomos konflikti i interesit) dhe politikave për të siguruar integritetin dhe pavarësinë.

Praktikat më të mira

-Rregullat kontraktuese janë përcaktuar pikërisht nga disa SAI, duke përfshirë një deklaratë të konfliktit të mundshëm të interesit nga ana e ekspertizës së dhënë.

- Një SAI bën publike në faqen e saj të gjitha kontratat që ka lëshuar për vlerat më të mëdha se 10.000 \$.

Parimi 6:

SAI menaxhon operacionet e veta ekonomike, në mënyre efikase, efektive dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret dhe raporton publikisht për këto çështje.

- SAI-t përdorin praktika të shëndosha të menaxhimit, duke përfshirë edhe kontrollet e duhura të brendshme mbi menaxhimin e vet financiar

dhe operacionet. Kjo mund të përfshijë auditime të brendshme dhe masa të tjera të përshkruara në INTOSAI GOV 9100.

- Pasqyrat financiare janë bërë publike dhe janë subjekt i auditimit të jashtëm të pavarur ose rishikimit parlamentar.

- SAI vlerëson dhe raporton mbi operacionet e veta dhe performancën në të gjitha fushat, të tilla si auditimi financiar, auditimi i përputhshmërisë, aktivitetet juridiksionale, auditimin e performancës, vlerësimin e programit dhe konkluzionet lidhur me aktivitetet qeveritare.

- SAI ruajnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kryer punën për të arritur misionin e tyre dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.

- SAI bën publike se sa është buxheti i saj total dhe raporton mbi origjinën e burimeve të veta financiare dhe se si këto burime janë përdorur.

-SAI vlerëson dhe raporton efikasitetin dhe efektivitetin me të cilën ajo përdor fondet e veta.

- SAI mund të përdorë gjithashtu edhe komitete të auditimit, të përbërë nga një shumicë e anëtarëve të pavarur, të shqyrtojë dhe të japë kontributin për menaxhimin e tyre financiar dhe proceset e raportimit.

- SAI mund të përdorë treguesit e performancës për të vlerësuar vlerën e punës së auditimit për Kuvendin, qytetarët dhe palët e tjera.

- SAI-et ndjekin transparencën e tyre publike, rezultatet dhe impaktin nëpërmjet reagimeve të jashtme.

Praktikat më të mira

- Një pjese e SAI-ve japin shumë shembuj të treguesve të tyre të performancës.

-Disa SAI kanë kushtuar raporte publike mbi këtë temë.

Disa tregues të performancës të përdorur:

- Numri i raporteve të performancës (aktiviteti)

- Shkalla e planit të ekzekutimit të auditimit

- Shkalla në të cilën janë zbatuar rekomandimet

- Përfitimet financiare / jo-financiare që rrjedhin nga rekomandimet e zbatuara të SAI-ve

- Numri i dëshmimeve / prezantime para parlamentit / Kongresit

- Afatet kohore të raportit të auditimit dhe finalizimit

Një numër i SAI-ve përdorni reagime të jashtëme të tilla si konsultime interneti, anketat e kënaqësisë, mbulimi nga media.

-Një pjese e SAI-ve:

- Kane një program trajnimi të detyrueshëm për të siguruar që stafi te ketë aftësitë e duhura dhe njohuritë për të kryer punën e tij të auditimit.
- Kane marrëveshje formale trajnimi me institucionet profesionale.
- Publikojne një raport vjetor të performancës së SAI-t i cili përfshin një numër të treguesve të performancës dhe rezultateve, me një faqe që evidenton arritjet për vitin si dhe fushat për përmirësim. Një tabelë përmbledhëse duhet të paraqitet në raport, duke deklaruar objektivat dhe rezultatet aktuale për vitin. Shembuj të treguesve të performancës përfshijnë shkallën në të cilën janë zbatuar rekomandimet dhe numrin e seancave parlamentare dhe informimeve. Informacione të tjera në këtë raport përfshijnë të interesuarit (parlamentarët, strukturat qeveritare dhe korporatat shtetërore) rezultatet e studimit, kënaqësinë, performancën financiare që tregon koston e operacioneve të kompensimit dhe përfitimet si dhe pasqyrat financiare të audituara.
- Disa SAI kanë një Komision Auditimi dhe Risku
- Një Sai përcakton objektivat e performancës bazuar në rezultatin e vlerësimit të jashtëm të një draft-raporti. Raportimi i SAI-t në parlament për ankesat dhe rezultatet e auditimit të performancës është vlerësuar nga ekspertë të njohur akademik. Specialistët e komunikimit të jashtëm vlerësojnë cilësinë e prezantimit në raporte. SAI raporton mbi ecurinë e objektivat në raportin e tij vjetor.

Parimi 7

SAI-t raportojnë publikisht mbi rezultatet e kontrolleve të tyre dhe në konkluzionet e tyre lidhur me aktivitetet e përgjithshme qeveritare.

- *SAI-t bëjnë publike konkluzionet dhe rekomandimet e tyre që rezultojnë nga auditimet, përveçse nëse ato konsiderohen konfidenciale nga ligjet dhe rregulloret e veçanta.*
- *SAI-t raportojnë mbi mbarvajtjen e masave të marra në lidhje me rekomandimet e tyre*
- *SAI-t e organizuara si gjykata raportojnë mbi sanksionet dhe gjobat e vendosura mbi zyrtarët ose menaxherët e kontabilitetit*
- *SAI-t gjithashtu raportojnë publikisht mbi rezultatet e auditimit të përgjithshëm, p.sh. Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit të*

qeverisë, gjendjen financiare dhe të operacioneve, mbi përparimin e përgjithshëm të menaxhimit financiar dhe, nëse përfshihen në kuadrin e tyre ligjor, për kapacitetet profesionale.

- *SAI-t mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet e auditimit dhe përfundimet dhe për të marrë masat e duhura.*

Praktikat e mira

- SAI-t (ose Gjykatat ose modele të tjera) raportojnë për numrin e veprave penale të mundshme të zbuluara nga auditimet e tyre.
- Pjesa më e madhe e SAI-ve e pranojnë publikisht nevojën për raportimin e rezultateve të kontroleve të tyre dhe për qasje në botime të tjera. Një kërkim i këtyre botimeve mund të bëhet në bazë të kriterëve të ndryshme: viti, agjencitë / institucionet, temat, etj.
- Disa SAI ofrojnë raporte përmbledhëse. Një faqe zyrtare e një SAI ofron "E-mail Updates", e cila, pas abonimit, lejon qasje me e-mail te publikimeve të fundit.
- Në shumicën e vendeve, kreu i SAI-t paraqet gjetjet e raporteve të tyre (të gjitha ose ato përzgjedhura) në komisionet parlamentare dhe në disa vende para Mbretit apo Presidentit.
- Në një SAI, kreu i Sai-t, çdo vit angazhohet personalisht me grupet e aktorëve të jashtëm (me ligjvënësit, nivelin ekzekutiv të qeverisë, këshilltarët dhe kryetarët e bashkive) mbi konkluzionet e tij/saj dhe analizën e rezultateve që dalin nga auditimet.
- I njëjti SAI, gjithashtu i ofron komisioneve të llogarive publike orientim dhe trajnim mbi menaxhimin financiar që ata të kuptojnë më mirë raportet e auditimit dhe të rritet integriteti i tyre në çështjet me subjektet e audituara.
- Një numër i SAI-ve u japin letra anëtarëve të rinj të komisioneve parlamentare duke theksuar rastet ku qeveria nuk kishte zbatuar masat e rekomanduara në raportet e auditimit të mëparshëm. Kjo është bërë pas çdo të legjislativit, duke pranuar se ka shumë anëtarë të rinj të Parlamentit.
- Kreu i SAI-t mban rregullisht takime formale dhe jo formale me kryetarët dhe anëtarët e komisioneve parlamentare dhe me zëvendës titullarët e subjekteve të audituara. Këto takime i ofrojnë Kreu të SAI-t një mundësi për të shpjeguar rolin dhe

mandatin e SAI-t dhe për të marrë një kuptim më të mirë të nevojave të komisioneve të ndryshme, çështjeve dhe rreziqeve me të cilat përballen subjektet e audituara.

Një SAI u dha parlamentarëve një udhëzues të titulluar "Shpenzimet dhe Ekzaminimi Publik" për t'i ndihmuar ata në rishikimin e buxhetit të qeverisë. Udhëzuesi tenton të bëjë të kuptueshëm procesin dhe përfshin pyetje të rekomanduara që parlamentarët mund të bëjnë ndaj strukturave të qeverisë dhe agjencive.

- Disa SAI kanë një mandat për të komentuar mbi projekt-buxhetin.
- Disa SAI komentojnë mbi projektet e mëdha të infrastrukturës.

Një numër i madh SAI-sh komunikojnë me institucionet qeveritare kundër korrupsionit.

Parimi 8

SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht mbi aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimit përmes mediave, faqeve të internetit dhe me mjete të tjera.

- SAI-t komunikojnë hapur me mediat apo palët e tjera të interesuara për auditimet e tyre, rezultatet e auditimit të cilët janë të dukshme në sferën publike.
- SAI-t nxisin interesin publik dhe akademik në konkluzionet e tyre më të rëndësishme.
- Përmbledhjet e raporteve të auditimit dhe vendimeve gjyqësore janë në dispozicion në një nga gjuhët zyrtare të INTOSAI-t, përveç gjuhëve të vendit.
- SAI-t fillojnë dhe kryejnë auditime dhe lëshojnë raportet përkatëse në kohën e duhur. Transparenca dhe llogaridhënia do të rritet në qoftë se puna e auditimit dhe dhënia e informacioneve nuk janë të vjetërsuara.
- Raportet e SAI-ve janë në dispozicion dhe të kuptueshëm për publikun e gjerë nëpërmjet mjeteve të ndryshme (p.sh. përmbledhjet, grafika, prezantime video, njoftime për shtyp).

Praktikat më të mira

- Raportet e SAI janë në dispozicion në faqet e internetit.
- SAI mbajnë konferenca shtypi pas lëshimit të raportit të auditimit për të shpjeguar përmbajtjen e tyre.
- SAI mbajnë një qëndrim propozitiv ndaj shoqërisë civile. Një numër i SAI-ve angazhojnë specialistë të komunikimit për të rishikuar raportet e tyre dhe për të siguruar që ato janë të shkruara në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.
- Një SAI ofron një portal mediatik gazetarëve dhe të tjerëve që kërkojnë informacion rreth tij, si dhe njoftime për lajme, deklarata, fjalime dhe informacionet përkatëse.
- Një SAI paraqet një faqe të parë të njëjtë për çdo botim të SAI-t, njoftime për shtyp, fjalime, përmbledhjet dhe artikuj janë në dispozicion.
- Një SAI ka një zëdhënës që komunikon me mediat. Përveç kësaj, SAI mban seanca të rregullta me mediat kryesore për të ndihmuar që ata të kuptojnë raportet e auditimit dhe të botojnë artikujt e tyre të saktë dhe në kontekstin e duhur.
- Kryetari i SAI-t takohet rregullisht me gazetarët në konferencën për shtyp për intervistë, pas publikimit të raportit të auditimit. Kreu i SAI-t gjithashtu takohet me parlamentarët për të shpjeguar buxhetin e SAI-t dhe për të diskutuar raportin e tij mbi planet dhe prioritetet, raportin e tij të performancës dhe praktikat e tij të menaxhimit.

Parimi 9

SAI-t përdorin këshillat e jashtme dhe të pavarura për të rritur cilësinë dhe besueshmërinë e punës së tyre.

- SAI-t pajtohen me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe përpiqen të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur udhëzime ose ekspertizë nga palët e jashtme.

- SAI mund të kërkojë një vlerësim të jashtëm të pavarur për auditimet tija dhe zbatimin e standardeve. Për këtë qëllim ata mund të përdorin vlerësimet e kolegëve.
- SAI-t mund të përdorin ekspertë të jashtëm për të siguruar këshilla të pavarura, duke përfshirë çështjet teknike që kanë të bëjnë me auditimin.
- SAI-t publikisht raportojnë rezultatet e rishikimeve të kolegëve dhe vlerësimet e pavarura të jashtme.
- SAI mund të përfitojnë nga auditimet e përbashkëta ose paralele.
- Duke përmirësuar cilësinë e punës së tyre, SAI-t mund të kontribuojnë në përmirësimin e kapaciteteve profesionale në menaxhimin financiar.

Praktikat e mira

- Një numër i SAI-ve kanë qenë subjekt i rishikimeve të kolegëve dhe rezultatet janë publikuar në faqet e tyre të internetit.
- SAI-t marrin këshilla nga një numër komisionesh me anëtarë të jashtëm. Këta anëtarë janë ekspertë me përvojë përkatëse, si përfaqësues kryesorë nga grupet mjedisore, komuniteti akademik, ish nëpunësit civilë dhe publikë, firmat private të kontabilitetit.
- SAI-t përdorin vlerësimin e ekspertëve (në fushat që përfshijnë çështjet teknike që lidhen me kontrollet) apo reagimet akademike, krahasimet: sistemet e informacionit dhe llogaritjet aktuariale.
- Disa SAI marrin pjesë në auditime të përbashkëta për çështjet mjedisore.
- SAI të tjerë i nënshtrojnë auditimet e rregullsisë së tyre Bordit të Pavarur Rregullator Kombëtar për Audituesit, për vlerësim teknik të pavarur dhe kontrollet e tyre të performancës për vlerësim nga një ekip kolegësh ndërkombëtar.
- Një numër SAI-sh kryejnë auditime bashkëpunuese me SAI-t e një juridiksioni tjetër, ku ka një ndarje të objektivave të auditimit, kritereve dhe programeve të auditimit. Zyrat e Auditimit raportojnë individualisht për legjislaturat e tyre

përkatëse. Shembuj të këtyre auditimeve bashkëpunuese përfshijnë çështje të tilla si shërbimet për fëmijët dhe në sektorin e shëndetësisë, treguesit e performancës.

- Një SAI krijoi një panel të pavarur për të shqyrtuar praktikën mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të rekomanduar rrugët për të forcuar potencialisht praktikën të tilla.
- Një SAI përdor konsulentë të jashtëm për të kryer rishikime të "menaxhimit total të cilësisë" ose "konsumatorëve" duke përfshirë komente, intervista me drejtuesit e nivelit të lartë dhe kontakte të rëndësishme në ministritë dhe subjektet e audituara publike dhe aktorë të tjerë.
- Disa SAI mbajnë lidhje me universitetet, për të rritur cilësinë e punës së tyre.
- Disa SAI ruajnë mekanizma formalë përmes të cilave publiku mund të komunikojë ankesat specifike dhe të sugjerojë në lidhje me auditimet.

ISSAI 30

Kodi Etik

Kapitulli 1 Prezantimi

Konceptimi, Sfondi dhe Qëllimi i Kodit të Etikës

- 1.** INTOSAI ka konsideruar të domosdoshëm krijimin e një Kodi Ndërkombëtar të Etikës, për audituesit në sektorin publik.
- 2.** Kodi i Etikës është një deklaratë gjithëpërfshirëse e vlerave dhe parimeve të cilat duhet të udhëheqin punën e përditshme të audituesve. Pavarësia, kompetencat dhe përgjegjësitë e audituesit të sektorit publik, zënë një vend të rëndësishëm në stafin e një SAI. Kodi i Etikës duhet të marrë parasysh kërkesat etike të nëpunësve civilë në përgjithësi dhe kërkesat e veçanta të audituesve, duke përfshirë detyrimet profesionale të këtij të fundit.
- 3.** Në bazë të Deklaratës së Limës mbi Udhëzuesit e Auditimit, Kodi i Etikës së INTOSAI-t, duhet të shihet si një plotësim i domosdoshëm, duke përforcuar standardet e auditimit të INTOSAI-it të lëshuara nga Komiteti i Standardeve të Auditimit në Qershor 1992.
- 4.** Kodi i Etikës i drejtohet audituesit si individ, kreut të SAI-t, zyrtarëve ekzekutivë dhe të gjithë individëve që punojnë për ose në emër të SAI-t. Megjithatë, Kodi nuk duhet të ketë ndonjë ndikim në strukturën organizative të SAI-t. Për shkak të dallimeve kombëtare të kulturës, gjuhës, sistemeve ligjore dhe shoqërore, është përgjegjësi e SAI-t të zhvillojë Kodin e tij në përshtatje me mjedisin. Mundësisht, këto kode kombëtare duhet të qartësojnë konceptet etike. Kodi Etik i INTOSAI-t, ka për qëllim të përbëjë bazën për kodet kombëtare të etikës. Çdo SAI, ka përgjegjësinë për të siguruar që të gjithë audituesit e tij të njihen me vlerat dhe parimet që përmban Kodi Kombëtar i Etikës dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat.
- 5.** Sjellja e një audituesi nuk duhet të kritikohet, në varësi të kohës dhe rrethanave. Çdo mangësi në sjelljen e tyre profesionale apo çdo sjellje e pahijshme në jetën e tyre personale e vendos integritetin e audituesve, si dhe cilësinë dhe vlefshmërinë e punës së tyre, në një dritë të pafavorshme, dhe mund të ngrejë dyshime në lidhje me besueshmërinë dhe kompetencën e SAI-t. Miratimi dhe zbatimi i kodit etik për audituesit, promovon besimin në punën e tyre.
- 6.** Është e një rëndësie themelore që SAI të shihet me besim. Audituesi e promovon këtë duke miratuar dhe zbatuar kërkesat etike të koncepteve të integritetit, pavarësisë, objektivitetit, si dhe kompetencës.

Besimi, Konfidencialiteti dhe Kredibiliteti

7. Autoriteti legjislativ dhe / ose ekzekutiv, publiku i gjerë dhe subjektet e audituara, kanë të drejtë të dinë se sjellja e SAI-t është e denjë për respekt dhe besim.

8. Audituesit duhet të sillen në mënyrë që të promovojnë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira mes tyre dhe brenda profesionit. Mbështetja e profesionit nga anëtarët, si dhe bashkëpunimi i tyre me njëri-tjetrin janë elemente thelbësorë të karakterit profesional. Besimi publik dhe respekti që gëzon një auditues është kryesisht rezultat i arritjeve të grumbulluara të gjithë audituesve që kanë dhënë kontributin e tyre në të shkuarën dhe atyre që punojnë aktualisht. Prandaj, është në interesin e audituesve, si edhe atë të publikut të gjerë, që një auditues të sillet me audituesit e tjerë në një mënyrë të drejtë dhe të balancuar.

9. Autoriteti legjislativ dhe/ose ekzekutiv, publiku i gjerë dhe subjektet e audituara duhet të jenë plotësisht të sigurtë mbi drejtësinë dhe paanshmërinë e të gjithë punës së SAI-t. Për këtë arsye është thelbësore që të ekzistojë një Kod Kombëtar i Etikës ose një dokument i ngjashëm, i cili duhet të qeverisë ofrimin e shërbimeve.

10. Në të gjitha pjesët e shoqërisë ka nevojë për besueshmëri, prandaj është thelbësore që raportet dhe opinionet e SAI-t të konsiderohen plotësisht të sakta dhe të besueshme nga palët e treta.

11. E gjithë puna e kryer nga SAI duhet të përballet me testin e shqyrtimit legjislativ dhe/ose ekzekutiv, me gjykimet publike mbi përshtatshmërinë dhe me ekzaminimin kundrejt një Kodi Kombëtar të Etikës.

Kapitulli 2 Integriteti

12. Integriteti është vlera kryesore e Kodit të Etikës. Audituesit kanë për detyrë tu përmbahen standardeve të larta të sjelljes (p.sh. ndershmëria dhe çiltërsia) në rrjedhën e punës së tyre dhe në marrëdhëniet e tyre me stafin e subjekteve të audituara. Për të ruajtur besimin e publikut, sjellja e audituesve duhet të jetë mbi çdo dyshim dhe qortim.

13. Integriteti mund të matet sipas asaj që është e ligjshme dhe e drejtë. Integriteti u kërkon audituesve të vëzhgojnë si formën ashtu dhe frymën e auditimit dhe standardet etike. Integriteti gjithashtu u kërkon audituesve të respektojnë parimet e pavarësisë dhe objektivitetit, të ruajnë standardet e sjelljes profesionale, të marrin vendime duke pasur në mendje interesin

publik, dhe të kenë një ndershmëri absolute në kryerjen e punës së tyre dhe në trajtimin e burimeve të SAI-t.

Kapitulli 3 Pavarësi, Objektivitet dhe Paanshmëri

14. Pavarësia nga organi i audituar dhe nga grupet e tjerë të jashtëm të interesit është i domosdoshëm për audituesit. Kjo nënkupton se audituesit duhet të sillen në një mënyrë që rrit, dhe nuk ul në asnjë mënyrë pavarësinë e tyre.

15. Audituesit duhet të përpiqen që, jo vetëm të jenë të pavarur nga subjektet e audituara dhe grupet e tjera të interesuara, por edhe të jenë objektivë në trajtimin e çështjeve dhe temave nën shqyrtim.

16. Është thelbësore që audituesit të jenë të pavarur dhe të paanshëm, jo vetëm faktikisht, por edhe në dukje.

17. Në të gjitha çështjet që lidhen me punën e auditimit, pavarësia e audituesit nuk duhet të dëmtohet nga interesat personale apo të jashtëm. Pavarësia mund të dëmtohet, për shembull, nga presioni apo ndikimi i jashtëm mbi audituesit; nga paragjykimet e audituesit rreth individëve, subjekteve të audituara, projekteve apo programeve; nga marrëdhënie pune të mëparshme me organin e audituar; ose nga çështje personale apo financiare të cilat mund të shkaktojnë konflikte besnikërie apo të interesave. Audituesit kanë për detyrë që të mos përfshihen në ato çështje ku ata kanë një interes personal.

18. Ekziston një nevojë për objektivitet dhe paanshmëri në të gjithë punën e kryer nga audituesit, veçanërisht në raportet e tyre, të cilët duhet të jenë të saktë dhe objektivë. Konkluzionet në opinione dhe raporte duhet të bazohen ekskluzivisht në provat e marra dhe të përpunuara në përputhje me standardet e auditimit të SAI-t.

19. Audituesit duhet të përdorin informacionin e sjellë nga subjekti i audituar dhe nga palët e tjera. Ky informacion duhet të merret parasysht në mendimet e shprehura nga audituesit në mënyrë të paanshme. Audituesi, gjithashtu, duhet të mbledhë informacione në lidhje me pikëpamjet e subjektit të audituar dhe palëve të tjera. Sidoqoftë, konkluzionet e vetë audituesve nuk duhet të ndikohen nga këto pikëpamje.

Neutraliteti Politik

20. Është e rëndësishme ruajtja e neutralitetit politik real dhe të perceptuar të SAI-t. Prandaj, është e rëndësishme që audituesit të mbajnë

pavarësinë e tyre nga ndikimi politik, në mënyrë që të përmbushin përgjegjësitë e tyre të auditimit në mënyrë të paanshme. Kjo është e rëndësishme për audituesit duke qenë se SAI-t punojnë ngushtë me autoritetet legjislative, ekzekutive apo me subjekte të tjerë qeveritarë, të autorizuar me ligj të marrin në konsideratë raportet e SAI-t.

21. Është e rëndësishme që, kur audituesit ndërmarrin, ose mendojnë të ndërmarrin aktivitete politike, ata të mbajnë në mend ndikimin që mund të ketë kjo përfshirje, ose të shohin nëse ky aktivitet mund të ketë ndikim në aftësinë e tyre për të përmbushur detyrat profesionale në mënyrë të paanshme. Nëse audituesve u lejohet të marrin pjesë në aktivitete politike ata duhet të jenë të vetëdijshëm se këto aktivitete mund të çojnë në konflikte profesionale.

Konfliktet e Interesit

22. Kur audituesve u jepet mundësia të japin këshilla dhe shërbime të tjera tek organi i audituar përveç auditimit, duhet pasur kujdes që këto shërbime të mos shkaktojnë konflikt interesi. Në veçanti, audituesit duhet të sigurohen që këto këshilla apo shërbime nuk përfshijnë përgjegjësi ose kompetenca menaxhimi, të cilat duhet të mbeten vendosmërisht me menaxhimin e entitetit të audituar.

23. Audituesit duhet të mbrojnë pavarësinë e tyre dhe të shmangin çdo konflikt interesi të mundshëm, duke refuzuar dhurata ose shpërblime në para, të cilat mund të influencojnë ose mund të perceptohen sikur influencojnë pavarësinë dhe integritetin e tyre.

24. Audituesit duhet tu shmangen marrëdhënieve me menaxherët dhe stafin e organit të audituar, si dhe me patët e tjera, të cilët mund të influencojnë, komprometojnë dhe venë në rrezik aftësinë e tyre për të vepruar dhe për tu parë si veprues të pavarur.

25. Audituesit nuk duhet të përdorin pozitën e tyre zyrtare për qëllime private dhe duhet të shmangin marrëdhëniet që përfshijnë rrezikun e korrupsionit apo ato që mund të ngrenë dyshime në lidhje me objektivitetin dhe pavarësinë e tyre.

26. Audituesit nuk duhet të përdorin informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrave të tyre si një mjet për të siguruar përfitim personal për veten e tyre apo për të tjerët. Ata nuk duhet të shpërndajnë informacionin që mund të sigurojë një avantazh të padrejtë apo të paarsyeshëm individëve apo organizatave të tjera, as nuk duhet ta përdorin një informacion të tillë si një mjet për të dëmtuar të tjerët.

Kapitulli 4 Fshehtësia Profesionale

27. Audituesit nuk duhet të zbulojnë informacionet e marra në procesin e auditimit të palëve të treta, qoftë me gojë ose me shkrim, përveçse për të përmbushur përgjegjësitë ligjore të SAI-t apo përgjegjësi të tjera të identifikuar si pjesë e procedurave normale të SAI-t ose ato në përputhje me ligjet përkatëse.

Kapitulli 5 Kompetencat

28. Audituesit kanë për detyrë të sillen në mënyrë profesionale gjatë gjithë kohës dhe të aplikojnë standarde të larta profesionale në kryerjen e punës së tyre në mënyrë që ata të mundën të kryejnë detyrat e tyre me kompetencë dhe me paanshmëri.

29. Audituesit nuk duhet të ndërmarrin punë për të cilën ata nuk janë të aftë.

30. Audituesit duhet të dinë dhe të ndjekin standardet e aplikueshëm të auditimit, të kontabilitetit, të menaxhimit financiar, si dhe politikat, procedurat dhe praktikat. Gjithashtu, ata duhet të kenë njohuri të mjaftueshme të parimeve kushtetuese, ligjore, institucionale dhe standardeve që rregullojnë veprimtarinë e subjektit të audituar.

Zhvillimi Profesional

31. Audituesit duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur profesional në kryerjen dhe mbikëqyrjen e auditimit dhe në përgatitjen e raporteve përkatëse.

32. Audituesit duhet të përdorin metodat dhe praktikat e cilësisë më të lartë të mundshme në auditimet e tyre. Në kryerjen e auditimit dhe lëshimin e raporteve, audituesit kanë për detyrë tu përmbahen standardeve themelore dhe përgjithësisht të pranuarat të auditimit.

33. Audituesit kanë një detyrim të vazhdueshëm për të përditësuar dhe për të përmirësuar aftësitë e nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre profesionale.

FJALOR

Shprehjet e përdorura në këtë Kod të Etikës kanë të njëjtin interpretim apo përkufizim, si ato të përdorura në Standardet e Auditimit të INTOSAI-t.

ISSAI 40

Kontrolli i Cilësisë për SAI-t

1. Hyrje

Qëllimi i këtij dokumenti është të ndihmojë SAI-t të krijojnë dhe mbajnë një sistem të përshtatshëm të kontrollit të cilësisë i cili mbulon të gjithë punën e tyre. Ky dokument duhet të ndihmojë SAI-t të projektojnë një sistem të kontrollit të cilësisë që është i përshtatshëm për mandatin dhe rrethanat e tyre dhe që përgjigjet ndaj rreziqeve të tyre për cilësinë.

Një sfidë e madhe me të cilën përballen të gjitha SAI-t është ofrimi i vazhdueshëm i një auditimi me cilësi të lartë dhe i punëve të tjera. Cilësia e punës së kryer nga SAI-t ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e tyre dhe përfundimisht aftësinë e tyre për të përmbushur mandatin.

Që një sistem i kontrollit të cilësisë të jetë efektiv, ai duhet të jetë pjesë e strategjisë, kulturës, politikave, procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim të çdo SAI. Në këtë mënyrë, cilësia ndërtohet në bazë të performancës së punës së secilit SAI dhe të prodhimit të raporteve të SAI-t, në vend që të jetë një proces shtesë pasi në raport është prodhuar.

Ky dokument është një pjesë përbërëse e strukturës së ISSAI-t. Ky udhëzim brenda kornizës së ISSAI-t duhet përdorur së bashku me standarde të tjerë ISSAI.

2. Qëllimi i ISSAI 40

ISSAI 40 bazohet në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë (ISQC1)¹, të përshtatur sipas nevojës për tu zbatuar dhe për SAI-t. Edhe pse ISQC1 përfshin disa çështje specifike në lidhje me organizatat e auditimit të sektorin publik që në shumë aspekte janë të përshtatshme edhe për SAI-t, parimet bazë kërkojnë interpretime për tu aplikuar drejt së drejti SAI-ve. ISSAI 40 pasqyron mandatin e SAI-ve, i cili është shpesh më i gjerë se ai i një auditimi profesional ose firmë të sigurimit. ISSAI 40 jep udhëzime për të ndihmuar SAI-t në zbatimin e parimeve kyçe të ISQC 1 në spektrin e plotë të punës së tyre, sipas mandatit të tyre dhe sipas rrethanave. Ky dokument përshkruan masat e kontrollit të cilësisë që janë të rëndësishme për arritjen e cilësisë së lartë në ambientin e sektorit publik.

¹ *International Standard on Quality Control (ISQC1)*, Kontrolli i Cilësisë së Sipërmarrjeve që Performojnë Auditime dhe Rishikime të Deklaratave Financiare dhe të Marrëveshjeve mbi Sigurimet dhe Shërbimet e Lidhura me këto, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC).

Ndonëse qëllimi i përgjithshëm dhe parimet bazë të ISSAI 40 janë në përputhje me ISQC1, kërkesat e këtij ISSAI-i janë përshtatur në mënyrë që të jenë të përshtatshëm për SAI-t.

Duke njohur dhe duke u mbështetur në parimet kyçe të ISQC1, ISSAI 40 ISSAI 40 përcakton një kornizë të përgjithshme të punës për kontrollin e cilësisë në SAI-t. Kjo kornizë është projektuar për tu zbatuar në sistemin e kontrollit të cilësisë për të gjithë punën e bërë nga SAI-t (për shembull, auditim financiar, auditim pajtueshmërie, auditim performance dhe çfarëdo lloj pune tjetër).

ISSAI 40 fokusohet në aspektet organizative të auditimit të cilësisë që operon në të gjithë SAI-t. ISSAI 40, gjithashtu, krijon një kornizë që plotëson udhëzimet e tjera të INTOSAI-t, duke përfshirë ato për një kontroll cilësie në një nivel angazhimi personal (për shembull, auditim financiar individual, auditim pajtueshmërie, auditim performance dhe çfarëdo lloj pune tjetër).

Udhëzime për kontrollin e cilësisë në nivel angazhimi personal mund të gjenden edhe në:

- ISSAI 1000-2999 (Udhëzimet e Auditimit Financiar)
[ISSAI 1000, ISSAI 1220, ISSAI 1620 japin udhëzime në lidhje me kontrollin e cilësisë për auditimin financiar]
- ISSAI 3000 – 3999 (Udhëzimet e Auditimit të Performancës)
[ISSAI 3100, Seksioni 2.5 jep udhëzime në lidhje me kontrollin e cilësisë së auditimit të performancës]
- ISSAI 4000 – 4999 (Udhëzimet e Auditimit të Pajtueshmërisë)
[ISSAI 4100, Seksioni 5.2 dhe ISSAI 4200, Seksioni 5.2 japin udhëzime në lidhje me kontrollin e cilësisë të auditimit të pajtueshmërisë]

Nëse ndonjë SAI dëshiron të verifikojë nëse pajtohet me ISQC1 (dhe me ISA-t), do të duhet të konsiderojë kërkesat e ISQC1. Kërkesat për ISA-t e aplikueshme përshkruhen në Udhëzimet e Auditimit Financiar.

ISQC1 gjendet në faqen:

Disa terma të përdorura në ISQC1 kanë nevojë të interpretohen nga SAI-t. Këto janë të përcaktuara në seksionin 7 të këtij dokumenti.

3. Përmbledhje e ISQC

ISQC merret me përgjegjësitë e një sipërmarrjeje në lidhje sistemin e saj të kontrollit të cilësisë për auditimet, për rishikimin e deklaratave financiare dhe për angazhimin në shërbime të tjera.

ISQC1 thotë që “qëllimi i një firme është të vendosë dhe të mbajë një sistem të kontrollit të cilësisë dhe ti japi atij siguri të arsyeshme që:

(a) firma dhe personeli i saj të pajtohen me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregulloret e aplikueshme; dhe

(b) raportet e lëshuara nga firma ose nga partnerët e angazhuar janë të përshtatshëm për rrethanat.”²

Korniza e ISSAI 40 duhet të përmbushi të njëjtin qëllim në lidhje me mandatin dhe rrethanat e çdo SAI.

4. Çfarë është një Sistem i Kontrollit të Cilësisë?

ISSAI 40 përdor elementet e kontrollit të cilësisë të përshkruar në ISQC1. ISSAI 40, gjithashtu, e konsideron këtë si një çështje të një rëndësie të veçantë në ambientin e auditimit të sektorit publik që prek të gjithë sistemet e kontrollit të cilësisë së SAI-ve. ISQC1 paraqet elementet e një sistemi të kontrollit të cilësisë:

(a) Përgjegjësitë e Leadership-it për cilësi brenda sipërmarrjes;

(b) Kërkesat etike të rëndësishme;

(c) Pranim dhe vazhdim i marrëdhënies me klientin dhe angazhime specifike;

(d) Burimet njerëzore;

(e) Performancë angazhimi; dhe

(f) Monitorim.

Përveç elementeve të mësipërm, ISQC1 vë në dukje nevojën për të dokumentuar linjat e veprimit dhe procedurat e kontrollit të cilësisë së sipërmarrjes dhe ti komunikojë ato personelit.

Elementet e sistemit të kontrollit të cilësisë të përmbajtura në ISQC1 i aplikohen të gjithë punës të zhvilluar nga SAI-t (i cili mund të jetë më i gjerë se sa termi “angazhim” i ISQC1”. Prandaj, parimet bazë në ISQC1 duhet të konsiderohen nga SAI-t kur projektojnë sistemet e tyre të kontrollit.

Si një objektiv parësor, çdo SAI duhet të konsiderojë rreziqet në cilësinë e punës së tij dhe të vendosi një sistem kontrolli të cilësisë që është

² ISQC1, paragrafi 11.

projektuar për tu përgjigjur këtyre rreziqeve në mënyrë të përshtatshme. Rreziqet në cilësi do të varen nga mandati dhe funksionet e çdo SAI, si dhe nga kushtet dhe mjedisi në të cilin ai vepron. Këto rreziqe mund të shfaqen në shumë aspekte të punës së një SAI. Për shembull, rreziku në cilësi mund të shfaqet gjatë aplikimit të gjykimeve profesionale, projektimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave, ose në metodat e përdorura nga SAI-t për të komunikuar rezultatet e punës së tyre. Mbajtja e një sistemi të kontrollit të cilësisë kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe angazhim për përmirësim të vazhdueshëm.

5. Struktura e ISSAI 40

Seksioni 6 i ISSAI 40 prezantohet në të njëjtën mënyrë për çdo element të identifikuar në ISQC1 si në vijim:

- Parimi bazë në ISQC1;
- Parimi bazë i përshtatur për SAI-t;
- Udhëzimi i aplikimit për SAI-t.

6. Korniza për një Sistem të Kontrollit të Cilësisë të SAI-ve

(a) Elementi 1: Përgjegjësitë e Leadership-it për Cilësi brenda SAI-t.

Parimi bazë i ISQC:

“Firma duhet të vendosi politika dhe procedura të projektuara për të nxitur një kulturë të brendshme e cila pranon se cilësia është esenciale në kryerjen e angazhimeve. Këto politika dhe procedura duhet ti kërkojnë zyrtarit më të lartë, ose bordit të partnerëve që menaxhon sipërmarrjen të marrë përsipër përgjegjësinë përfundimtare të sistemit të kontrollit të cilësisë.”³

Parimi Bazë i Përshtatur për SAI-t

Një SAI duhet të vendosi politika dhe procedura të projektuara për të nxitur një kulturë të brendshme e cila pranon se cilësia është esenciale për të gjithë punën e tij. Këto politika dhe procedura duhet të përcaktohen nga Drejtuesi i SAI-t, i cili mban përgjegjësinë totale për sistemin e kontrollit të cilësisë.

³ ISQC1, paragrafi 18.

Udhëzime Aplikimi për SAI-t

- Drejtuesi i SAI-t mund të jetë një individ ose një grup individësh në bazë të mandatit dhe rrethanave të SAI-t.
- Drejtuesi i SAI-t duhet të mbajë përgjegjësinë totale për cilësinë e të gjithë punës së bërë në SAI.⁴
- Drejtuesi i SAI-t mund të delegojë autoritetin e tij për menaxhimin e sistemit të kontrollit të cilësisë së SAI-t tek një person ose disa persona që kanë eksperiencën e duhur dhe të mjaftueshme për të marrë këtë rol.
- SAI-t duhet të përpiqen të arrijnë një kulturë që njeh dhe vlerëson punën me cilësi të lartë në të gjithë SAI-n. Për të arritur këtë kulturë Drejtuesi i SAI-t duhet të vendosi “tonin e duhur në krye” i cili vë në dukje rëndësinë e cilësisë në të gjithë punën e SAI-t duke përfshirë punën që është kontraktuar jashtë. Kjo kulturë varet edhe nga veprimet e qarta, të përputhshme dhe të shpeshta e të gjithë niveleve të menaxhimit të SAI-t, që venë në dukje rëndësinë e cilësisë.
- Strategjia e çdo SAI duhet të njohë që është kërkesë thelbësore për SAI-n arritja e një cilësie të lartë në të gjithë punën e tij në mënyrë që konsideratat politike, ekonomike dhe të tjera të mos komprometojnë cilësinë e punës së kryer.
- SAI-t duhet të sigurohen që politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë tu komunikohen stafit të SAI-t dhe çdo pale të tretë të autorizuar të kryejë punë për një SAI.
- SAI duhet të sigurohet që të ketë burime të mjaftueshëm për sistemin e kontrollit të cilësisë brenda SAI-t.

(b) Elementi 2: Kërkesa Etike të Rëndësishme

Parimi bazë i ISQC1

“Firma duhet të krijojë politika dhe procedura të hartuara për ti dhënë sigurinë e mjaftueshme që ajo dhe personeli i saj pajtohen me kërkesat etike më të rëndësishme.”⁵

⁴ Në përputhje me ISSAI 20, Parimet e Transparencës dhe Përgjegjësisë, Parimi 5.

⁵ ISQC1, paragrafi 20.

Parimi Bazë i Përshtatur për SAI-t

Një SAI duhet të krijojë politika dhe procedura të hartuara për ti dhënë sigurinë e mjaftueshme që SAI, duke përfshirë gjithë personelin dhe palët e autorizuara për të kryer punë për SAI-n, pajtohet me kërkesat etike më të rëndësishme.

Udhëzime Aplikimi për SAI-t

- SAI-t duhet të venë në dukje rëndësinë e përputhshmërisë më kërkesat etike më të rëndësishme në kryerjen e punës së tyre.
- I gjithë personeli i SAI-t dhe palët e treta të autorizuara për të kryer punë për SAI-n, duhet të kenë një sjellje etike të përshtatshme.
- Drejtuesi i SAI-t dhe personeli me përvojë duhet të shërbejë si shembull i një sjelljeje etike të përshtatshme.
- Kërkesat etike më të rëndësishme duhet të përshijnë çdo kërkesë të përcaktuar në kornizën ligjore dhe rregulluese që qeverisë veprimtarinë e SAI-t.
- Kërkesat etike për SAI-t mund të përfshijnë ose të hartohen mbi bazën e Kodit Etik të INTOSAI-t (ISSAI 30) dhe të kërkesave etike të IFAC në përputhje me mandatin dhe rrethanat e tij si edhe rrethanat e stafit të tij profesional.
- SAI-t duhet të sigurohen që politikat dhe procedurat në fuqi të përforcojnë parimet themelore të etikës profesionale siç janë përkufizuar në ISSAI 30, për shembull:
Integriteti;

Pavarësia, objektiviteti, paanshmëria

Sekreti profesional;

Kompetenca.

- SAI-t duhet të sigurohet që palët e autorizuara për të kryer punë për SAI-t janë objekt i marrëveshjeve fshehtësisë përkatëse.
- SAI-t duhet të marrin në konsideratë përdorimin e deklaratave në formë të shkruar nga personeli për të konfirmuar pajtimin me kërkesat etike të SAI-t.

- SAI-t duhet të sigurohen që politikat dhe procedurat në fuqi e njoftojnë në kohë Drejtuesin e SAI-t për thyerjet e kërkesave etike dhe e lejojnë atë të ndërmarrë veprimet e duhura për të zgjidhur çështjen.
- SAI-t duhet të sigurohen që politikat dhe procedurat në fuqi ruajnë pavarësinë e Drejtuesit të SAI-t, gjithë personelit dhe palëve të tjerë të autorizuar për të kryer punë për SAI-n.

(Për më shumë udhëzime për pavarësinë e SAI-t referohuni ISSAI 10 *Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t* dhe ISSAI 11 *Udhëzime dhe Praktika të Mira në lidhje me Pavarësinë e SAI-t*.)

- SAI-t duhet të sigurohen që politikat dhe procedurat në fuqi, të cilat përforcojnë rotacionin e personelit më të rëndësishëm, të ulin, aty ku është e nevojshme, rrezikun që lind nga familiariteti me organet që po auditohen. SAI-t, gjithashtu, mund të marrin në konsideratë masa të tjera për të ulur rrezikun e familiaritetit.

(c) Elementi 3: Pranimi dhe Vazhdimi

Parimi bazë i ISQC1

"Firma duhet të vendosë politika dhe procedura për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet specifike të hartuara për ti dhënë firmës sigurinë e mjaftueshme që do të ndërmarrë vetëm ose do të vazhdojë marrëdhëniet dhe angazhimet aty ku ajo:

- (a) është kompetente për të përmbushur angazhimet dhe ka kapacitetet, duke përfshirë kohën dhe burimet për të bërë këtë;*
- (b) mund të pajtohet me kërkesat etike të rëndësishme; dhe*
- (c) ka marrë në konsideratë integritetin e klientit dhe nuk ka informacione se kjo gjë mund ta çojë atë te përfundimi se klientit i mungon integriteti."⁶*

⁶ ISQC1, paragrafi 26.

Parimi Bazë i Përshtatur për SAI-t

Një SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për ti dhënë SAI-t sigurinë e mjaftueshme që do të ndërmarrë auditime ose punë të tjera aty ku SAI:

- (a) ka kompetencë për të kryer punën dhe ka kapacitetet duke përfshirë kohën dhe burimet për të bërë këtë;
- (b) mund të pajtohet me kërkesat etike të rëndësishme; dhe
- (c) ka marrë në konsideratë integritetin e klientit dhe ka konsideruar si të trajtojë rrezikun ndaj cilësisë që mund të lind.

Politikat dhe procedurat duhet të reflektojnë gamën e punës së kryer nga çdo SAI. Në shumë raste SAI-t kanë pak liri në lidhje me punën që ata kryejnë. SAI-t kryejnë auditime në tre kategori të gjera:

- Punë që u kërkohet për shkak të mandatit dhe statutit të tyre, për të cilën ata nuk kanë zgjidhje tjetër përveç kryerjes;
- Punë që u kërkohet për shkak të mandatit të tyre, por ku ata kanë liri veprimi për sa i përket kohës, qëllimit dhe natyrës së saj;
- Punë që ata mund të zgjedhin për të kryer.

Udhëzime Aplikimi për SAI-t

- Për të gjitha auditimet dhe punët e tjera, SAI-t duhet të krijojnë sisteme që marrin në konsideratë rreziqet ndaj cilësisë, të cilat lindin gjatë kryerjes së punës. Këto do të ndryshojnë në bazë të llojit të punës që po kryet.
- SAI-t zakonisht punojnë me burime të kufizuara. SAI-t duhet të marrin në konsideratë programin e tyre të punës dhe nëse ata i kanë burimet e nevojshme për të ofruar gamën e punës në nivelin e cilësisë të dëshiruar. Për të arritur këtë, SAI-t duhet të kenë një sistem që i jep përparësi punës së tyre në mënyrë të tillë që nevoja për cilësi të ruhet. Nëse burimet nuk janë të mjaftueshme dhe venë në rrezik cilësinë, SAI duhet të ketë procedura që sigurojnë që mungesa e burimeve i nënshtrohet vëmendjes së Drejtuesit të SAI-t dhe legjislaturës ose autoritetit buxhetor aty ku është e përshtatshme.
- SAI-t duhet të vlerësojnë nëse ekziston një rrezik material ndaj pavarësisë së tyre në përputhje me ISSAI 10. Atëherë kur ky rrezik identifikohet, SAI duhet të përkufizojë dhe të dokumentojë se si ai po planifikon të adresojë këtë rrezik dhe të sigurojë që një

proces miratimi është në fuqi dhe është dokumentuar në mënyrë adekuate.

- Atëherë kur integriteti i organit të audituar vihet në dyshim, SAI duhet të konsiderojë dhe të adresojë rreziqet që lindin nga aftësitë e stafit, niveli i burimeve dhe çdo çështje etike që mund të lind në organizatën e audituar.
- SAI-t duhet të marrin parasysh procedurat për pranimin dhe vazhdimin e punës, duke përfshirë edhe punën e kontraktuar. Nëse SAI vendos të ndërmarrë këtë detyrë, ai duhet të sigurohet që vendimi është miratuar në nivelin e duhur dhe rreziqet e përfshira janë vlerësuar dhe menaxhuar.
- SAI-t duhet të sigurohen se procedurat e menaxhimit të riskut janë të përshtatshme për zbutjen e riskut. Përgjigjet ndaj riskut mund të përfshijnë:
 - të përcaktohet me kujdes qëllimi i punës
 - emërimi i në stafi me eksperiencë
 - realizimi i një kontrolli cilësie më të thellë, para lëshimit të raportit
- SAI-t duhet të përfshijnë në raport çdo çështje me rëndësi, të cilat japin arsye të paktën nëse nuk është pranuar detyra

(d) Elementi 4: Burimet Njerëzore

Parimi bazë i ISQC1

“Firma duhet të vendosë politika dhe procedura të krijuara për të siguruar se ka aftësitë, kompetencat dhe përkushtimin e duhur ndaj parimeve etike të nevojshme për:

- (a) të kryer angazhimet në pajtim me standardet profesionale dhe ligjore dhe kërkesat e rregulloreve në fuqi.*
- (b) të mundësojë që firma dhe partnerët të lëshojnë raporte në rrethanat e duhura⁷”*

Parimi Bazë i Përshtatur për SAI-t

SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të krijuara për të siguruar se ka burimet e mjaftueshme (personeli apo palët e kontraktuara) me

⁷ ISQC1 paragrafi 29

aftësitë, kompetencat dhe përkushtimin e duhur ndaj parimeve etike të nevojshme për:

- (c) të kryer angazhimet në pajtim me standardet profesionale dhe ligjore dhe kërkesat e rregulloreve në fuqi.
- (d) të bërë të mundur që SAI të lëshojë raportet në rrethanat e duhura.

Udhëzime Aplikimi për SAI-t

- SAI-t mund të tërheqin fonde nga burime të ndryshme për të siguruar që atë të kenë aftësitë dhe ekspertizën e duhur për të kryer gamën e punës së tyre, të përfunduar si nga personeli i SAI-t dhe i kontraktuar.
- SAI duhet të sigurohet që përgjegjësia të caktohet qartësisht për të gjithë punën e ndërmarrë nga SAI.
- SAI duhet të sigurohet që personeli dhe palët e autorizuar për të kryer punë për SAI-n (për shembull, nga firmat e kontabilitetit të certifikuar dhe të konsultimit) i kanë kompetencat e përgjithshme të kërkuara për të kryer këtë punë.
- SAI duhet të pranojë që në disa situata personeli dhe palët e autorizuar për të kryer punë për SAI-n, mund të kenë detyrime të veçanta në përputhje me kërkesat profesionale të organeve, përveç kërkesave të SAI-t.
- SAI duhet të sigurohet që politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore i japin fokus të mjaftueshëm cilësisë dhe përkushtimit ndaj parimeve etike të SAI-t. Këto politika dhe procedura në lidhje me burimet njerëzore përfshijnë:
Rekrutimin (dhe kualifikimet e stafit të rekrutuar)

Vlerësimin e Performancës

Zhvillimin Professional

Kapacitetet (duke përfshirë kohën e mjaftueshme për të përfunduar angazhimet sipas standardit të kërkuar)

Kompetencën (duke përfshirë kompetencën etike dhe teknike)

Zhvillimin e Karrierës

Promovimin

Kompensimin dhe

Vlerësimin e nevojave të personelit.

- SAI-t duhet të promovojnë trajnimin dhe formimin e të gjithë stafit për të inkurajuar zhvillimin e tyre profesional dhe që ata të trajnohen në zhvillimet e tanishme të profesionit të tyre.
- SAI-t duhet të sigurohen që personeli dhe çdo palë tjetër e autorizuar për të kryer punë për SAI-n kanë një njohuri të përshtatshme të ambientit të sektorit publikë në të cilën SAI vepron dhe një njohuri të mirë të punës që atyre u kërkohet të kryejnë.
- SAI duhet të sigurohet që cilësia dhe parimet etike të SAI-t janë drejtuesit kryesorë të vlerësimit të performancës së personelit dhe çdo pale tjetër e autorizuar për të kryer punë për SAI-n.

(e) Elementi 5: Performanca e Auditimeve dhe Punë të Tjera

Parimi bazë i ISQC1

“Firma duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për ti dhënë asaj sigurinë e duhur që angazhimet po kryen në përputhje me standardet profesionale, ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe që sipërmarrja ose partneri i angazhuar lëshojnë raportet e që janë të nevojshëm për rrethanat. Këto politika dhe procedura duhet të përfshijnë:

- (a) çështjet relevante për promovimin e qëndrueshmërisë në cilësinë e performancës së angazhimeve;*
- (b) mbikëqyrjen e përgjegjësive dhe;*
- (c) rishikimin e përgjegjësive.”⁸*

Parimi Bazë i Përshtatur për SAI-t

SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për ti dhënë atij sigurinë e duhur që angazhimet po kryen në përputhje me standardet profesionale, ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe që SAI lëshon raportet e që janë të nevojshëm për rrethanat. Këto politika dhe procedura duhet të përfshijnë:

- (a) çështjet relevante për promovimin e qëndrueshmërisë në cilësinë e performancës së angazhimeve;

⁸ ISQC1, paragrafi 32.

(b) mbikëqyrjen e përgjegjësive dhe;

(c) rishikimin e përgjegjësive.

Udhëzime Aplikimi për SAI-t

- SAI-t duhet të kenë politika, procedura dhe mjete të përshtatshëm, si metodologjitë e auditimit që ndihmojnë për kryerjen e të gjithë gamës së punës për të cilën është përgjegjës SAI, duke përfshirë dhe atë që kryet nga palët e autorizuara.⁹
- SAI-t duhet të vendosin politika dhe procedura që inkurajojnë cilësinë e lartë dhe shkurajojnë ose parandalojnë cilësinë e ulët. Kjo përfshin edhe krijimin e një ambienti i cili është stimulues, inkurajon përdorimin e duhur të gjykimeve profesionale dhe promovon rritjen e cilësisë. E gjithë puna e kryer duhet ti nënshtrohet një rishikimi, si një mënyrë për të ndihmuar në rritjen e cilësive, promovimin e arsimimit dhe zhvillimin e personelit.
- Atëherë kur lindin çështje të vështira dhe të diskutueshme, SAI-t duhet të sigurohen që burimet e duhura (si teknikët ekspertë) janë të mësuar të merren me të tilla çështje.
- SAI-t duhet të sigurohen që standardet ndiqen gjatë kryerjes së punës dhe nëse ndonjë kërkesë në standarde nuk ndiqet. SAI duhet të sigurohet që arsyet aprovohen dhe dokumentohen në mënyrë të përshtatshme.
- SAI duhet të sigurohet që çdo diferencë në mendim brenda SAI-t dokumentohet qartësisht dhe zgjidhet përpara se një raport të lëshohet nga SAI.
- SAI duhet të sigurohet që politika dhe procedura të përshtatshme të kontrollit të cilësisë janë në fuqi (si për shembull mbikëqyrje dhe risimin i përgjegjësive dhe rishikim i angazhimeve të kontrollit të cilësisë) për të gjithë punën e kryer (duke përfshirë auditimin financiar, auditimin e performancës dhe auditimin e përputhshmërisë). SAI-t duhet ta njohin rëndësinë e rishikimit të angazhimeve të kontrollit të cilësisë për punën e tyre dhe atëherë kur një rishikim i angazhimeve të kontrollit të cilësisë është kryer, çështjet që

⁹ Në përputhje me Parimin e ISSAI 20.

lindin si rrjedhojë e kësaj duhet të zgjidhen para se një raport është lëshuar nga SAI.

- SAI-t duhet të sigurohen që procedurat janë në fuqi për të autorizuar lëshimin e raporteve. Disa punë të një SAI kanë një nivel ndërlikimi dhe rëndësie që kërkon kontroll cilësie intensiv përpara se një raport është lëshuar.
- Nëse SAI-t u nënshtrohen një procedure specifike në lidhje me rregullat e provës (si në rastin e SAI-ve me rol gjyqësor), ai duhet të sigurohet që këto procedura ndiqen vazhdimisht.
- SAI-t duhet të kenë qëllim përfundimin në kohë të auditiveve dhe të gjithë punëve, duke vlerësuar që cilësia e punës së SAI-t ulet kur nëse puna nuk kryet në kohë.
- SAI-t duhet të sigurohen që procedurat e përshtatshme ndiqen për gjetjet e verifikuara dhe për të siguruar që palët që ndikohen drejtpërsëdrejti nga këto gjetje kanë mundësinë për të komentuar përpara finalizimit të punës, pavarësisht nëse raporti është bërë publik apo jo nga SAI.
- SAI-t duhet të sigurohen që ata kanë të gjithë dokumentacionin që përcaktohet nga ligji, rregulloret, standardet dhe udhëzimet.
- SAI-t duhet të balancojnë fshehtësinë e dokumentacionit me nevojën për transparencë dhe përgjegjësi. SAI-t duhet të vendosin procedura transparente kur merren me kërkesa për informacion që janë në përputhje me me legjislacionin në juridiksionin e tyre.

(f) Elementi 6: Monitorimi

Parimi bazë i ISQC1

“Firma duhet të vendosë një proces monitorimi i hartuar për ti dhënë asaj siguri të mjaftueshme që politikat dhe procedurat në lidhje me sistemin e kontrollit të cilësisë janë përkatëse, të rëndësishme dhe operojnë në mënyrë efektive. Ky proces duhet:

a) të ketë një konsideratë dhe vlerësim të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të cilësisë, duke përfshirë, sipas një cikli, inspektimin e të paktën një angazhimi të përfunduar për çdo partner të angazhuar;

(b) të kërkojë përgjegjësi për procesin e monitorimit që i caktohet një partneri ose personave të tjerë me përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, si dhe me autoritet për të pranuar përgjegjësitë.

(c) kërkon që ata që janë angazhuar në rishikimin e kontrollit të cilësisë, të mos jenë të përfshirë në inspektim.”

Parimi Bazë i Përshtatur për SAI-t

Një SAI duhet të krijojë një proces monitorimi, për të siguruar se politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e kontrollit të cilësisë janë të përshtatshme dhe po operojnë me eficiencë. Procesi i monitorimit duhet të:

(a) të marrë vazhdimisht në konsideratë dhe të vlerësojë sistemin e kontrollit të cilësisë, duke përfshirë një rishikim të kampionëve të punës së kryer;

(b) të kërkojë përgjegjësi për procesin e monitorimit që i caktohet një individ me përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, si dhe me autoritet për të pranuar përgjegjësitë;

(c) të kërkojë që përgjegjësit për rishikimet të jenë të pavarur (të mos kenë marrë pjesë gjatë kontrollit të cilësisë).

Udhëzime aplikimi për SAI-t

- SAI-t duhet të sigurohen se sistemi i tyre i kontrollit të cilësisë, përfshin monitorimin e pavarur të gamës së kontrolleve
- Nëse shërbimi është kontraktuar nga jashtë, SAI-t duhet të kërkojnë informacione lidhur me efektivitetin e sistemit të kontrollit të cilësisë së firmës
- SAI-t duhet të sigurojnë se rezultatet e procesit të monitorimit duhet ti raportohen Kreut brenda një kohe të caktuar, në mënyrë që ai të marrë masat e duhura
- Në rast se është e përshtatshme, SAI-t duhet të përfshijnë SAI të tjerë ose organe të ngjashme në procesin e monitorimit
- Nëse është e nevojshme, SAI-t mund të përfshijnë në këtë proces edhe:
 - mendimin e pavarur të akademikëve;
 - sondazhe me palët e interesit;
 - vazhdimi i shqyrtimit të rekomandimeve;

- përgjigja nga organizatat e audituara (p.sh sondazhe të klientëve).

SAI-t duhet të ndjekin procedura të caktuara kur kanë të bëjnë me ankesa dhe pretendime rreth cilësisë së punës së kryer nga SAI.

SAI-t duhet të marrin në considerate faktin nëse ekziston ndonjë ligj ose ndonjë formë tjetër për monitorimin e raporteve publike, ose t'i përgjigjet ankesave dhe pretendimeve të publikut lidhur me punën e kryer nga SAI¹⁰.

7. Interpretimi i termave

Nëse një SAI do të sigurojë që punon në përputhje me ISQC-1 (dhe me ISA-t), do t'i duhet të marrë në konsideratë kërkesat e ISQC-1. ISQC-1 përmban përkufizimet e një nuri të caktuar termash. Për të aplikuar ISSAI 40, termat e përmendur në ISQC-1 do të kuptohen në këtë mënyrë:
“Firm”

Termi firm i referohet SAI-t si tërësi. Ku kreu i SAI-t emëron një punonjës, një kontabilist të zotin ose një partneritet auditimi, ose persona të tjerë të kualifikuar për të kryer auditime ose punë të tjera, pra termi “firm” i referohet kombinimit të punës së kreut të SAI-t dhe personit të emëruar për të kryer auditimet ose punët e tjera.

“Angazhim”

Termi “angazhim” i referohet punës që kryhet, duke udhtruar funksionet e SAI-t (për shembull kryerja e një auditimi financiar në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës).

“Partner i angazhuar”

Termi “partner i angazhuar” i referohet të punësuarit, kontabilistit ose personit të kualifikuar, i cili është përgjegjës për punën, si dhe për raportin që publikohet në emër të kreut të SAI-t, në përputhje me politikat dhe procedurat e SAI-t.

“Klient”

Termi “klient” i referohet subjektit ose subjekteve publike për t'u audituar ose për të bërë punë të tjera të SAI-t (p.sh organizata e audituar).

Udhëzuesi i mundësuar përmes këtij ISSAI është në përputhje me këto terma.

¹⁰ Në përputhje me ISSAI 30, Kodi i Etikës, paragrafi 11

ISSAI 100

Parimet themelore në Auditimin e Njësive
Publike.

1. Kuadri i përgjithshëm i standardeve të auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI), ka ardhur si rrjedhojë e Deklaratave të Limës dhe të Tokios, deklaratat dhe raportet e miratuar nga INTOSAI në kongrese të ndryshme, në raportin e Grupit të Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara në takimin e Kontabilitetit Publik dhe Auditimit në vendet në zhvillim.

2. Standardet e auditimit të INTOSAI përbëhen nga katër pjesë (*shih grafikun në faqen 15*):

- a) Parimet Themelore
- b) Standardet e Përgjithshme
- c) Standardet e Fushës së Auditimit
- d) Standardet e Raportimit

INTOSAI ka zhvilluar këto standarde për të siguruar një kuadër për vendosjen e procedurave dhe praktikave që duhet të ndiqen në kryerjen e një auditimi, duke përfshirë edhe auditimin e bazuar në sistemet kompjuterike. Ato duhet të shihen në rrethana të veçanta kushtetuese, ligjore dhe në detaje të tjera të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (SAI).

3. Parimet bazë për standardet e auditimit janë; angazhimet themelore, premisë e qëndrueshme, parime logjike dhe kërkesat të cilat ndihmojnë në zhvillimin e standardeve të auditimit dhe i shërbejnë audituesve në formimin e opinioneve dhe raporteve të tyre, veçanërisht në rastet kur nuk mund të zbatohen standarde specifike.

4. Standardet e auditimit duhet të jenë në përputhje me parimet e auditimit. Ato gjithashtu ofrojnë udhëzimet minimale për audituesit, në përcaktimin e nivelit të hapave të auditimit dhe procedurat që duhet të aplikohen në auditim. Standardet e auditimit përbëjnë kriteret ose shtrirjen përkundrejt të cilës vlerësohet cilësia e rezultateve të auditimit.

5. Interpretimet dhe shpjegimet e këtyre standardeve janë një e drejtë e posaçme e Bordit Drejtues të INTOSAI, ndërsa ndryshimet janë përgjegjësi e Kongresit të INTOSAI.

6. Parimet bazë janë:

a) SAI duhet të marrë në konsideratë përputhshmërinë me standardet e auditimit të INTOSAI në të gjitha çështjet që e mendon se janë materiale. Disa standarde që nuk mund të jenë të zbatueshme për disa punë të kryera nga SAI, duke përfshirë ato institucione që janë të organizuara si gjykata llogarie, sikurse dhe punët jo audituese të kryer nga SAI. SAI duhet të përcaktojë standarde të aplikueshme për punë të tilla për të siguruar vazhdimësinë e një cilësie të lartë.

b) SAI duhet të zbatojë vendimin e vet në situata të ndryshme që lindin gjatë kryerjes së auditimit të njërive publike.

c) Me rritjen e ndërgjegjësimit publik, kërkesa për përgjegjësinë e personave ose njësitë publike që administrojnë burimet publike ka ardhur gjithnjë e në rritje, për këtë arsye ekziston nevoja që procesi i llogaridhënies të jetë në vendin e duhur dhe që të veprojë në mënyrë efektive.

d) Zhvillimi i një sistemi të duhur informacioni, kontrolli, vlerësimi dhe raportimi brenda qeverisë do të lehtësojë procesin e llogaridhënies. Menaxhimi është përgjegjës për saktësinë, mjaftueshmërinë dhe përmbajtjen e dokumenteve standarde të raporteve financiare dhe informacioneve të tjera.

e) Organet përkatëse duhet të sigurojnë shpalljen e standardeve të pranueshme të kontabilitetit për raportimin financiar dhe zbulimin e përshtatshëm të nevojave qeveritare si dhe njësitë e auditimit duhet të zhvillojnë objektivat specifike të matshme dhe planifikimin e performancës së njësisë.

f) Zbatimi i saktë i standardeve të pranueshme të kontabilitetit duhet të rezultojë në paraqitjen e drejtë të pozicionit financiar dhe rezultateve të operacioneve.

g) Ekzistenca e një sistemi të përshtatshëm kontrolli të brendshëm minimizon rrezikun e gabimeve dhe parregullsive.

h) Aktet legjislative do të lehtësonin bashkëpunimin e njërive publike të auditimit në ruajtjen dhe sigurimin e të drejtës të marrjes së të gjitha të dhënave të nevojshme për një vlerësim të plotë të aktiviteteve gjatë auditimit.

i) Të gjitha aktivitetet e auditimit duhet të jenë brenda mandatit të auditimit të SAI-t.

j) SAI-t duhet të punojnë drejt përmirësimit të teknikave për auditimin e vlefshmërisë së masave të performancës.

k) SAI-t duhet të shmangin konfliktin e interesave midis audituesit dhe njësisë publike që auditon.

7. Paragrafët në vijim shtjellojnë rëndësinë e parimeve bazë të auditimit.

8. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

SAI-t duhet të marrin në konsideratë përputhshmërinë me standardet e auditimit të INTOSAI në të gjitha çështjet që janë përcaktuar si materiale. Standardet e caktuara nuk mund të jenë të zbatueshme për disa punë të bëra nga SAI, duke përfshirë ato që janë të organizuara si Gjykata Llogarie dhe as nga punët që s'janë pjesë e auditimeve të kryera nga SAI. SAI duhet të përcaktojë standarde të aplikueshme për punë të tilla për të siguruar që puna e kryer është e një cilësie të lartë dhe të vazhdueshme.

9. Në terma të përgjithshme, një çështje mund të gjykohet materiale, nëse njohja e saj do ndikojë tek përdoruesit e pasqyrave financiare ose tek raportimi i auditimit të performancës.

10. Materialiteti shpesh është konsideruar në aspektin e vlerës, por natyra e trashëguar/pandarë ose karakteristikat e një artikulli ose grupi artikujsh mund të bëjnë një çështje materiale – për shembull, kur ligji apo një rregullore kërkon që të zbulohet veçmas pavarësisht nga shumica e përfshirë.

11. Përveç materialitetit sipas vlerës dhe nga natyra, një çështje mund të jetë materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodhet. Për shembull, duke e konsideruar një objekt në lidhje me:

- a) pamjen e përgjithshme të dhënë në informacionin financiar;
- b) totalin me të cilat formon një pjesë;
- c) kushtet e lidhura;

d) shumën koresponduese në vitet e mëparshme.

12. SAI-t shpesh kryejnë aktivitete që me përkufizim strikt nuk përcaktohen si auditime, por që kontribuojnë në një qeverisje më të mirë. Shembuj të punës jo audituese mund të përfshijnë (a) mbledhjen e të dhënave, duke mos kryer analiza të detajuara, (b) pune juridike, (c) një detyrë informimi për Parlamentin për sa i përket shqyrtimit të projekt – buxheteve, (d) një detyrë ndihmuese për anëtarët Parlamentit për sa i përket hetimeve dhe konsultimeve të dosjeve të SAI-t, (e) aktivitetet administrative dhe (f) funksionet e përpunimeve kompjuterike. Këto aktivitete jo audituese japin një informacion të vlefshëm për vendimmarrësit dhe duhet të jenë vazhdimisht të një cilësie të lartë.

13. Për shkak të strukturës dhe drejtimit të disa SAI-ve, jo të gjitha standardet e auditimit janë të zbatueshme në të gjitha aspektet e punës së tyre. Për shembull, natyra juridike dhe kolegjiale e shqyrtimeve të kryera nga Gjykatat e Llogarive, aspektet e punës që kryejnë janë krejtësisht të ndryshme nga auditimet financiare dhe të performancës të sjella nga SAI të cilat janë të organizuara sipas një sistemi hierarkik të udhëhequr nga Audituesi i Përgjithshëm ose nga Kryetari.

14. Për të siguruar kryerjen e një pune me një cilësi të lartë, duhet të ndiqen standardet e duhura. Objektivat e një lloji pune të veçantë ose detyrë të veçantë duhet të tregojnë standardet e caktuara që janë ndjekur. Çdo SAI duhet të krijojë një politikë mbi të cilën standardet e INTOSAI ose standarde të tjera të veçanta, duhet të ndiqet në kryerjen e llojeve të ndryshme të punëve që kryen institucioni për të siguruar që puna dhe rezultatet janë të një cilësie të lartë.

15. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se::

SAI duhet të përdorë gjykimin e tij në situata të ndryshme që lindin gjatë kryerjes së auditimit të njësive publike.

16. Evidencat e auditimit luajnë një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen e audituesit në lidhje me përzgjedhjen e çështjeve, natyrën dhe zonat që do auditohen, kohën dhe shtrirjen e testeve e procedurave të auditimit.

17. Kushtet e mandatit të auditimit me të cilat SAI është i pajisur kanë përparësi ndaj ndonjë konvente të kontabilitetit apo auditimit me të cilat ka konflikt si dhe kanë një influencë të rëndësishme në standardet e

auditimit që zbaton SAI. Si rrjedhojë, standardet e auditimit të INTOSAI dhe gjithashtu çdo standard i auditimit të jashtëm për SAI-t nuk mund të jetë normativ, ose të ketë një kërkesë të detyrueshme për SAI-t ose për anëtarët e stafit të tij.

18. SAI do të gjykojë masën në të cilën standardet e auditimit të jashtëm janë në përputhje me përmbushjen e mandatit të SAI-t. Sidoqoftë, SAI duhet të njohë se standardet e auditimit të INTOSAI shprehin një konsensus të opinionit midis auditimeve të njëjësive publike dhe të përpiqen për t'i aplikuar aty ku ato janë në përputhje me mandatin e SAI-t. SAI duhet të kërkojë heqjen e papajtueshmërive ku kjo është e nevojshme për të lejuar zbatimin e standardeve të dëshirueshme.

19. Për disa elemente të mandatit të SAI-t, veçanërisht në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, objektivat e auditimit të SAI-t mund të jenë të ngjashme me objektivat e auditimit në sektorin privat. Përkatësisht, standardet e sektorit privat për auditimin e pasqyrave financiare të cilat janë të shpallura nga organet zyrtare përkatëse mund të jenë të zbatueshme për audituesin shtetëror.

20. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

Me rritjen e ndërgjegjësimit publik, kërkesa për përgjegjësinë e personave ose njësitë publike që administrojnë burimet publike ka ardhur duke u rritur, kështu që ekziston një nevojë e madhe që procesi i llogaridhënies të jetë me vend dhe që të veprojë në mënyrë efektive.

21. Në disa vende, rregullat kërkojnë që njësitë publike përgjegjëse të raportojnë tek Presidenti, Mbreti ose Këshilli i Ministrave, por më shumë ato raportojnë në legjislaturën e zgjedhur, direkt ose nëpërmjet degës ekzekutive të qeverisë. SAI të caktuara kanë status juridik. Pushteti juridik ushtrohet, në varësi të vendit/shtetit, mbi pasqyrat financiare, mbi kontabilistët edhe mbi administratorët. Gjykimet dhe vendimet që këto institucione kryejnë janë plotësim i natyrshëm i funksionit administrativ të auditimit me të cilat ato janë të ngarkuar. Veprimet e tyre juridike duhet të shihen si pjesë e logjikës së objektivave të përgjithshme të ndjekura nga auditimet e jashtme dhe në veçanti me ato objektiva që kanë të bëjnë me pyetjet e kontabilitetit.

22. Ndërmarrjet publike janë gjithashtu të detyruara që të përmbushin detyrimet publike të llogaridhënies. Ndërmarrjet publike mund të

përfshijnë ndërmarrjet tregtare, p.sh., njësitë publike të themeluara me statut ose me urdhër ekzekutiv, ose ku qeveria ka pjesën kontrolluese. Pavarësisht nga mënyra se si këto njësi publike janë themeluar, funksionet që kanë, shkalla e autonomisë ose nga marrëveshja/rregullat e financimit, njësi publike të tilla janë përfundimisht llogaridhënëse tek organet e larta ligjvënëse.

23. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

Zhvillimi i një sistemi informacioni, kontrolli, vlerësimi dhe raportimi të saktë brenda qeverisë, do të lehtësojë procesin e llogaridhënies. Menaxhimi është përgjegjës për saktësinë, mjaftueshmërinë e formës dhe përmbajtjen e raporteve financiare dhe informacione të tjera.

24. Korrektësia dhe mjaftueshmëria e deklaratave dhe raporteve financiare janë shprehje e pozicionit financiar dhe rezultateve operacionale të një njësie ekonomike. Gjithashtu është detyrimi i njësisë publike për të hartuar një sistem praktik i cili do të sigurojë informacione të rëndësishme dhe të besueshme.

25. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

Autoritetet përkatëse duhet të sigurojnë shpalljen e standardeve të pranueshme të kontabilitetit për raportimin financiar dhe zbulimin relevant për nevojat e qeverisë, gjithashtu njësitë publike të audituara duhet të zhvillojnë objektiva specifike e të matshme dhe qëllimet e performancës.

26. SAI-t duhet të punojnë me standardet e kontabilitetit të vendosura nga organizatat në mënyrë që të sigurohet se janë lëshuar standardet e duhura të kontabilitetit për qeverinë (sektorin publik).

27. SAI duhet të rekomandojë për njësitë publike të kontrolluara objektiva të qarta dhe të matshme dhe të vendosë qëllimet e performancës për arritjen e këtyre objektivave.

28. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

Zbatimi i saktë i standardeve të pranueshme të kontabilitetit duhet të rezultojë në paraqitjen e drejtë të pozicionit financiar dhe rezultateve të veprimtarive.

29. Pranimi në zbatimin e standardeve të kontabilitetit është një kusht paraprak i ndershmërisë që do të thotë se një njësi publike e audituar duhet të përputhet me standardet e kontabilitetit duke u përshtatur me rrethanat si dhe kërkesat e aplikimit të standardeve të tilla të kontabilitetit në mënyrë të vazhdueshme. Një auditues nuk duhet të konsiderojnë pajtueshmërinë me standardet e kontabilitetit në një mënyrë të qëndrueshme, si një provë definitive e paraqitur në mënyrë të drejtë të raporteve të ndryshmeve financiare. Drejtësia është një shprehje e opinionit të audituesit që shkon përtej kufijve të zbatimit të vazhdueshëm të standardeve të kontabilitetit. Një supozim i tillë thekson se standardet e auditimit nuk janë më shumë se kërkesat minimale të angazhimit të audituesit. Gjykimi i audituesit shkon përtej këtij minimumi.

30. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

Ekzistenca e një sistemi adekuat (përshtatshëm) të kontrollit të brendshëm minimizon rrezikun e gabimeve ose të parregullsive.

31. Është përgjegjësi e njësisë publike të kontrolluar për të zhvilluar sisteme të përshtatshme të kontrollit të brendshëm për të mbrojtur burimet e saj. Kjo nuk është përgjegjësi e audituesit. Gjithashtu është detyrimi i njësisë publike të audituar të sigurojë se kontrollet e brendshme funksionojnë dhe ekzistojnë për të ndihmuar zbatimin e standardeve të aplikueshme dhe rregullave, sikurse drejtësia e korrektësia janë zbatuar në marrjen e vendimit. Megjithatë, kjo nuk do të ndalojë audituesin të paraqesë propozime dhe rekomandime tek njësi e audituar ku janë konstatuar se kontrollet e brendshme janë të pamjaftueshme ose mungojnë.

32. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

Aktet legislative duhet të lehtësonin bashkëpunimin e njësisve publike të audituar në ruajtjen dhe sigurimin e të gjitha të dhënave relevante të nevojshme për një vlerësim të plotë të aktiviteteve gjatë auditimit.

33. SAI-t duhet të kenë të drejtën të shqyrtojnë të dhënat dhe burimet e informacionit, si dhe të kenë të drejtë për të kontaktuar zyrtarët dhe punonjësit e njësisë publike të audituar, me qëllim për të kryer siç duhet përgjegjësitë e tij gjatë auditimit. Miratimi i kërkesave ligjore me qëllim që audituesi të ketë të drejtë për shqyrtim e një informacion të tillë dhe të

personelit, do të ndihmojë për të minimizuar problemet e ardhshme në këtë fushë.

34. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

Të gjitha aktivitetet e auditimit duhet të kryhen brenda mandatit të auditimit të ILA.

35. SAI-t në përgjithësi janë të përcaktuar nga organi suprem ligjvënës, ose me dispozitë kushtetuese. Në disa raste elementet e rolit të SAI-t mund të jenë me marrëveshje në vend të dispozitës së veçantë ligjore. Zakonisht, ligji ose rregullorja për krijimin përcakton formën e SAI-t (të tilla si gjykatë, bord, komision, zyra ligjore ose ministri), termat dhe kushtet e mbajtjes së postit, kompetencat, detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, dhe çështje të tjera që i përkasin drejtimit dhe mbajtjes së zyrës si dhe shkarkimin e funksioneve dhe detyrave që duhet të kryhen.

36. Cilado qoftë marrëveshja, funksioni thelbësor i SAI-t është të mbështesë dhe të nxisë përgjegjshmërinë publike. Në vende të caktuara, SAI është gjykatë, e përbërë nga gjyqtarë, që kanë pushtet mbi kontabilistët e shtetit të cilët duhet të japin llogari tek kjo gjykatë. Ky funksion juridik kërkon që SAI të sigurohet se çdo njeri që është i ngarkuar me fonde publike është përgjegjës për atë dhe nga kjo pikëpamje t'i nënshtrohet juridiksionit të tij.

37. Ekziston një komplementaritet i rëndësishëm midis këtij autoriteti juridik dhe karakteristikave të tjera të auditimit. Këto karakteristika duhet të shihen si pjesë e logjikës së objektivave të përgjithshme që ndiqen nga auditimet e jashtme dhe më në veçanti ato që kanë të bëjnë me menaxhimin e kontabilitetit.

38. Fusha e plotë e auditimit të njësive publike përfshin auditimin e rregullshmërisë dhe atë të performancës.

39. Auditimi i rregullsisë përfshin:

(a) Verifikimin e përgjegjshmërisë financiare të njësive publike përgjegjëse, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare dhe shprehjen e mendimeve mbi pasqyrat financiare;

- (b) Verifikimin e përgjegjshmërisë financiare të administratës së qeverisë si e tërë;
- (c) Auditimin e sistemeve dhe transaksioneve financiare duke përfshirë një vlerësim të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- (d) Auditimin e kontrollit të brendshëm dhe funksionet e auditimit të brendshëm;
- (e) Auditimin e ndershmërisë dhe drejtësisë në vendimet administrative të marra nga njësia publike e audituar; dhe
- (f) Raportimin e çdo çështje tjetër që del apo që ka lidhje me auditimin të cilat SAI mendon se duhet të publikohen.

40. Auditimi i performancës ka të bëjë me auditimin e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit. Ky auditim përfshin:

- (a) Auditimin e ekonomicitetit të aktiviteteve administrative në përputhje me parimet dhe praktikën e shëndosha administrative dhe politikave të menaxhimit;
- (b) Auditimin e efikasitetit në përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe burimeve të tjera duke përfshirë shqyrtimin e sistemeve të informacionit, masave të performancës dhe veprimtarive monitoruese si dhe procedurat e ndjekura nga njësitë publike të audituara për korrigjimin e mangësive të identifikuara; dhe
- (c) Auditimi i efektivitetit të performancës në lidhje me arritjen e objektivave të njësisë publike të audituar, dhe auditimi i ndikimit/impaktit aktual të aktiviteteve duke e krahasuar me ndikimin/impaktin e synuar.

41. Në praktikë mund të ketë një mbivendosje midis auditimit të rregullshmërisë me atë të performancës, dhe në të tilla raste klasifikimi i një auditimi të veçantë do të varet nga qëllimi kryesor i atij auditimi.

42. Në shumë vende mandati i auditimit të performancës ndalet shkurtimisht në shqyrtimin e politikave duke u bazuar në programet e qeverisë. Në çdo rast, mandati duhet të përcaktojë qartë kompetencat dhe

përgjegjësitë e SAI-t në lidhje me auditimin e performancës në të gjitha fushat e veprimtarisë qeveritare, për të lehtësuar zbatimin e përshtatshëm të standardeve të auditimit nga ana e SAI-t.

43. Në disa vende kushtetuta ose legjislacioni në fuqi nuk i japin gjithmonë SAI-t autoritetin për të audituar "efektivitetin" ose "efiçencën" e menaxhimit financiar të Ekzekutivit. Në këto raste vlerësimi i përshtatshmërisë ose shërbimeve të vendimeve administrative dhe efektiviteti i menaxhimit është për Ministrat, të cilëve u është dhënë detyra e organizimit të shërbimeve administrative dhe të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e tyre para organeve legjislative. Shprehja e cila do të paraqitet në këtë rast që të jetë më e përshtatshme për të përshkruar auditimet e SAI-ve të cilat shkojnë përtej kornizës tradicionale të rregullshmërisë dhe ligjshmërisë është ajo e "auditimit për një menaxhim të mirë". Një auditim i këtillë ka për qëllim të vazhdojë me një analizë të shpenzimeve publike në dritën e parimeve të përgjithshme të një menaxhimi të shëndoshë. Të dy llojet e auditimit -- të rregullsisë dhe të menaxhimit -- mund të kryhen në praktikë në një veprimtari, aq më tepër ato janë reciprokisht përforcuese: auditimet e rregullshmërisë janë në gjendje të përgatisin auditimet e menaxhimit, dhe këto të fundit rezultojnë në korrigjimin e situatave që shkaktojnë parregullsi.

44. Përgjegjshmëria publike do të promovohet në mënyrë më efektive aty ku mandati t'i mundësojë SAI-n të kryejë, ose drejtojë sjelljen e auditimeve të rregullshmërisë dhe të performancës në të gjitha njësitë publike.

45. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

SAI duhet të punojë drejt përmirësimit të teknikave për vlefshmërinë e masave të auditimit të performancës.


46. Zgjerimi i rolit të auditimit prej audituesve do t'u kërkojë atyre (audituesve) për të përmirësuar dhe zhvilluar teknika dhe metodologji të reja për të vlerësuar nëse masat e arsyeshme dhe të vlefshme të performancës janë përdorur nga ana e entit publik të audituar. Audituesit duhet të përfitojnë nga teknikat dhe metodologjitë e disiplinave të tjera.

47. Parimet themelore të auditimit përcaktojnë se:

SAI duhet të shmangi konfliktin e interesave midis audituesve dhe njërive publike që auditohen.

48. SAI kryen rolin e tij duke audituar njësitë publike përgjegjëse dhe duke raportuar rezultatet. Për të përmbushur këtë rol, SAI duhet të ruaj pavarësinë dhe objektivitetin e tij. Zbatimi i standardeve të përgjithshme përkatëse të auditimit ndihmon SAI-n për të arritur këto kërkesa.

49. Shtrirja e mandatit të auditimit do të përcaktojë shtrirjen e standardeve që duhet të zbatohen nga ana e SAI-t.



Standardet e Auditimit të INTOSAI

ISSAI 200

Standardet e Përgjithshme të Auditimit Shtetëror.

Ky seksion trajton standardet e përgjithshme në auditimin shtetëror. Standardet e përgjithshme të auditimit përshkruajnë kualifikimet e audituesit dhe / ose institucionit të auditimit, kështu që ata të mund të kryejnë detyrat lidhur me fushën dhe standardet raportuese në mënyrë kompetente dhe të efektshme.

Standardet e përgjithshme të auditimit përfshijnë standardet që zbatohen si për audituesit dhe për SAI-t dhe standardet që zbatohen vetëm për SAI-t. Standardet e përbashkëta për audituesit dhe SAI-t janë:

- (a) audituesi dhe SAI duhet të jenë të pavarur.
- (b) audituesi dhe SAI duhet të zotërojnë kompetencën e kërkuar.
- (c) audituesi dhe SAI duhet të ushtrojë kujdesin e duhur dhe puna e kryer të jetë në përputhje me standardet e auditimit të INTOSAI. Kjo përfshin kujdesin e duhur në planifikimin, specifikimin, mbledhjen dhe vlerësimin e provave, në raportimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Standardet e përgjithshme të auditimit janë që SAI duhet të adoptojnë politika dhe procedura për

- (a) Rekrutimin e personelit me kualifikimet e duhura.
- (b) Zhvillimin dhe trajnimin e punonjësve të SAI për t'i mundësuar atyre që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive, dhe për të përcaktuar bazat për avancimin e mëtejshëm të audituesve dhe pjesës tjetër të personelit.
- (c) Përgatitjen e manualeve, udhëzuesve dhe instruksioneve të tjera lidhur me kryerjen e auditimeve.

(d) Mbështetjen e aftësive dhe përvojës ekzistuese brenda SAI dhe identifikimin e aftësive që mungojnë. Të sigurojë një shpërndarje të mirë të aftësive gjatë ushtrimit të auditimit dhe të caktoj një numër të mjaftueshëm të personave për auditim. Të ketë planifikimin dhe mbikëqyrjen e duhur për të arritur qëllimet e tyre në nivelin e kërkuar me shqetësimin dhe kujdesin e duhur.

(e) Rishikimi i efikasitetit dhe efektivitetit të standardeve të brendshme dhe procedurat të SAI.

Pavarësia

Standardet e përgjithshme të audituesve dhe të SAI-ve përfshijnë:

Audituesit dhe SAI-t duhet të jenë të pavarur.

Paragrafët në vijim shpjegojnë pavarësinë si një standard i auditimit. Në veçanti, paragrafët 56 – 63 shpjegojnë pavarësinë nga legjislatura, paragrafët 64 – 75 nga ana e ekzekutivit dhe paragrafët 76 – 80 nga njësitë publike të audituar.

Sido që të jetë forma e qeverisjes, nevoja për pavarësi dhe objektivitet gjatë auditimit është me rëndësi jetike. Një shkallë e mjaftueshme e pavarësisë nga të dy degët, ajo e legjislaturës dhe ekzekutivi i qeverisë është thelbësore për kryerjen e auditimit dhe për besueshmërinë e rezultateve të tij.

Kriteret për krijimin dhe ruajtjen e pavarësisë së mjaftueshme të SAI-ve mund të bëhen më lehtë të qarta për shtetet, të cilat SAI-t kanë një legjislaturë të zgjedhur që dallohet nga dega e pushtetit ekzekutiv (nëse anëtarët e qeverisë janë ose jo edhe anëtarë të legjislaturës së SAI-t). Si marrëveshje e përgjithshme e këtij lloji veprohet për pjesën më të madhe të vendeve anëtare të INTOSAI, këto standarde përcaktojnë kriteret e pavarësisë së SAI-ve për vendet me marrëveshje të tillë, duke pranuar se ndryshimi dhe përshtatja e këtyre kriterëve do të jetë e nevojshme në vendet e tjera.

Pushteti legjislativ është një nga përdoruesit kryesorë të shërbimeve të SAI-ve. Mandati i SAI-ve buron nga kushtetuta ose legjislatura, një tipar i vazhdueshëm i funksionit të SAI-t është raportimi i tij në parlament.

SAI mund të pritet që të bashkëpunojë ngushtë me legjislativin, duke përfshirë çdo komision të autorizuar të ngritur nga legjislativi që të shqyrtojë raportet e SAI-t. Një lidhje e tillë mund të kontribuojë në ndjekjen efektive të punës së SAI-t.

Në mënyrë të ngjashme me rezultatet e rëndësishme të auditimeve të kryera për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe të administratës, kundërshtimet dhe mosmarrëveshjet me administratat e audituara duhet të sillen në vëmendjen e organit legjislativ me anë të raporteve ose komunikimeve të veçanta.

Komitetet e veçanta të krijuara brenda trupit legjislativ mund të ngarkohen me detyrë për të shqyrtuar në prani të Ministrave, delegatëve të organeve të audituara dhe përfaqësuesve të tjerë, komentet dhe komunikimet e veçanta të raporteve të SAI-ve. Lidhja e ngushtë midis trupit legjislativ dhe SAI-t mund të kryhet gjithashtu nga një hetim financiar, si dhe me asistencë teknike për punën e komisioneve parlamentare të ngarkuara me shqyrtimin e projekt buxheteve.

SAI mund t'i japë anëtarëve të pushtetit legjislativ përmbledhje faktesh mbi raportet e auditimit, por është e rëndësishme që SAI të ruajë pavarësinë e tij nga ndikimet politike, në mënyrë që të mbaj një qëndrim të paanshëm të përgjegjësive të auditimit. Kjo nënkupton që SAI nuk duhet jetë i gatshëm, as të mos japi një pamje e të qenit i gatshëm, ndaj dëshirave dhe interesave të veçanta politike.

Ndërsa SAI-t duhet të respektojë ligjet e miratuara nga legjislativi, pavarësia e tij kërkon që të mos të jetë subjekt që drejtohet nga pushteti legjislativ gjatë programimit, planifikimit dhe kryerjes së auditimeve. SAI ka nevojë për liri për të përcaktuar prioritetet dhe programin e punës së tij në përputhje me mandatin dhe të miratojë metodologji të përshtatshme për auditimet që do të ndërmerren.

Në disa vende auditimi i menaxhimit financiar i pushtetit ekzekutiv është prerogativë (e drejtë e posaçme) e Kuvendit ose e asamblesë së zgjedhur, kjo mund të zbatohet edhe për auditimin e shpenzimeve dhe të arkëtimeve në nivel rajonal, ku auditimi i jashtëm është përgjegjësi e asamblesë legjislative. Në këto raste auditimet janë kryer në emër të këtij organi dhe kjo është e përshtatshme për SAI-n që të marrë në konsideratë kërkesat e këtij organi për shqyrtime të veçanta në detyrën e programimit të auditimit. Është gjithsesi e rëndësishme që SAI të mbetet i lirë për të

përcaktuar mënyrën se si të kryej punët e tij, duke përfshirë edhe ato detyra të kërkuara nga Kuvendi.

Është e përshtatshme për pushtetin legjislativ të specifikojë kërkesat minimale të raportimit, duke përfshirë çështjet që do të jenë objekt i një opinionit të auditimit dhe brenda një afati të arsyeshëm ku duhen të përgatiten raportet. Përveç kësaj, dispozita ligjore fleksibile për raportimin e SAI-t në legjislaturë, pa kufizim në përmbajtje ose afatet e raportimit, do të mbështesë në ruajtjen e pavarësisë.

Është e nevojshme që pushteti legjislativ t'i sigurojë SAI-t burimet e mjaftueshme, për të cilat ai është përgjegjës, si dhe për ushtrimin efektiv të mandatit të tij.

Pushteti ekzekutiv dhe SAI mund të kenë disa interesa të përbashkëta në përkrahjen e llogaridhënies publike. Por marrëdhënia thelbësore me ekzekutivin është ajo e auditimit të jashtëm. Si e tillë raportet e SAI-t e ndihmojnë ekzekutivin duke tërhequr vëmendjen mbi mangësitë e administratës dhe duke i rekomanduar përmirësimet e tyre. SAI duhet të ketë kujdes për të shmangur pjesëmarrjen në funksionet e ekzekutivit të cilat janë në kundërshtim me pavarësinë dhe objektivat e tij gjatë ushtrimit të mandatit.

Është e rëndësishme për pavarësinë e SAI-t që të mos ekzistojë asnjë mundësi drejtimi nga ana e ekzekutivit në lidhje me performancën dhe mandatin e SAI-t. SAI nuk duhet të jetë i detyruar të kryejë, modifikojë ose të frenohet nga kryerja e një auditimi, të shtypet ose të modifikojë gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e një auditimi.

Shkalla e bashkëpunimit midis SAI-t dhe ekzekutivit është e pëlqyeshme në disa çështje. SAI duhet të jetë gati për ti dhënë mendime ekzekutivit në çështje të tilla si politikat e standardeve të kontabilitetit dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. SAI duhet të sigurohet që në dhënien e mendimeve të tilla të shmangë ndonjë angazhim të qartë ose të nënkuptuar, një gjë e tillë do të pengojë e pavarësinë e mandatit të auditimit.

Ruajtja e pavarësisë së SAI-t nuk përjashton marrjen në konsideratë të kërkesës që i drejtohen atij nga ekzekutivi për çështjet që i propozohen për auditim. Por në qoftë se këto kërkesa cenojnë pavarësinë e konsiderueshme, SAI duhet të jetë në gjendje ta refuzojë një kërkesë të

tillë. Kjo është thelbësore për konceptin e pavarësisë së SAI-t që merr vendimet për sa i përket detyrave të auditimit duke përfshirë programimin, i cili duhet t'i mbeten përfundimisht SAI-t.

Zona e ndjeshme në marrëdhëniet midis SAI-ve dhe shqetësimeve të ekzekutivit është sigurimi i burimeve të SAI-t. Në shkallë të ndryshme, duke reflektuar ndryshimet kushtetuese dhe institucionale, marrëveshjet për sigurimin e burimeve të SAI-t mund të jenë të lidhura me degën e ekzekutivit, me situatën financiare të qeverisë dhe politikave të përgjithshme të shpenzimeve. Kundrejt kësaj, promovimi efektiv i përgjegjësisë publike kërkon që SAI-t t'i jepen burime të mjaftueshme për të mundësuar që të përmbushë përgjegjësitë e saj në mënyrë të arsyeshme.

Çdo imponim i burimeve apo kufizime të tjera nga ana e ekzekutivit të cilat do të kufizonin veprimtarinë e mandatit të SAI-t do të jetë një çështje e duhur për raportin e SAI-t para legjislativit.

Mandati ligjor duhet t'i parashikojë SAI-t të drejtën e plotë dhe të lirë për të hyrë dhe parë të dhënat përkatëse në të gjitha zyrat dhe entet publike që auditohen dhe veprimtaritë e tyre. SAI-t duhet t'i japin kompetenca të mjaftueshme për të marrë informacione të rëndësishme nga personat ose entet publike që e zotërojnë atë.

Gjithashtu, me dispozita ligjore ose konventë, ekzekutivi duhet të lejojë hyrjen e SAI-t për marrjen e çdo lloj informacioni i cili është i nevojshme dhe i rëndësishëm për përmbushjen e përgjegjësisë së tij.

Kushtet e qëndrimit në detyrë të kreut (Kryetarit) të SAI-t mund të kontribuojnë në pavarësinë e SAI-t nga ekzekutivi, p.sh. nëpërmjet emërimit për një periudhë të caktuar kohore, ose deri në një moshë të caktuar të daljes në pension. Në të kundërt, kushtet e qëndrimit të cilat e vendosin SAI-n nën presion për të kënaqur ekzekutivin do të ketë një ndikim negativ (erozive) në pavarësinë e tij. Për këtë arsye është e dëshirueshme në parim, që dispozitat në lidhje me përfundimin e emërimit ose shkarkimit nga funksioni duhet të ushtrohen vetëm në procese të veçanta të ngjashme me ato që lidhen me titullarët e funksionit gjyqësor ose të ngjashme me to.

Për ato SAI, që ushtrojnë funksione juridike dhe të cilat shpesh janë më të organizuara në formë kolegjiale, pavarësia e anëtarëve të tyre duhet të

sigurohet me garanci të ndryshme, sidomos parimi i mos-heqjes së gjyqtarëve, privilegji i ushtrimit të funksionit, në përcaktimin interpretimit të ligjit, dhe në pavarësinë e shqyrtimit të magjistratit.

Me qëllim që SAI jo vetëm të ushtrojë funksionet në mënyrë të pavarur prej ekzekutivit, por të shihet që e bën këtë, është e rëndësishme që mandati i tij dhe statusi i tij i pavarur të kuptohet mirë në komunitet. SAI duhet, kur është e mundur, të ndërmarrë një rol arsimor në këtë drejtim.

Pavarësia funksionale e SAI-t nuk duhet të përjashtojë marrëveshjet me organet e ekzekutivit në lidhje me administrimin e SAI-t në çështje të tilla si marrëdhëniet industriale, menaxhimin e personelit, menaxhimin e pronës ose blerjes së përbashkët të pajisjeve dhe ndërtesave. Organet e ekzekutivit nuk duhet të jenë në një pozicion për të marrë vendime që do të rrezikonin pavarësinë e SAI-t gjatë ushtrimit të mandatit të tij.

SAI duhet të mbetet i pavarur nga njësitë publike të audituara. Megjithatë, ai duhet të kërkojë të mësojë njësitë publike të audituara kuptimin e rolit dhe funksionit të tij, me qëllim ruajtjen e marrëdhënieve miqësore me to. Marrëdhëniet e mira mund të ndihmojnë SAI-n për të marrë informacione të lira e të sinqerta dhe për të zhvilluar diskutime në një atmosferë respekti dhe mirëkuptimi reciprok. Në këtë aspekt, SAI-t, duke mbajtur pavarësinë e tyre, mund të pranojnë të bashkohet me reforma të cilat janë planifikuar nga ana e administratës në fusha të tilla si llogaritë publike ose në legjislacionin financiar ose të bien dakord të konsultohen në lidhje me përgatitjen e projekt-ligjeve ose rregullave që ndikojnë në kompetencën ose autoritetin e tij. Sidoqoftë, këto raste nuk janë ndërhyrje e SAI-t në menaxhimin administrativ, por si një çështje që vepron bashkë me shërbime të caktuara administrative duke i dhënë atyre asistencë teknike, ose duke i vënë atyre në dispozicion përvojën e menaxhimit financiar të SAI-t.

Në kontrast me auditimin e sektorit privat, ku detyra e audituesit dhe rënia dakord është e specifikuar në një letër angazhimi, njësia publike e audituar nuk është në një marrëdhënie klienti me SAI-n. SAI duhet të kryejë mandatin e tij të lirë dhe të paanshëm, duke marrë në konsideratë pikëpamjet e menaxhimit në formimin e opinioneve të auditimit, konkluzioneve dhe rekomandimeve, por nuk mbart asnjë përgjegjësi për menaxhimin e entit publik të audituar për qëllimin ose natyrën e auditimeve të ndërmarra.

SAI-t nuk duhet të marrin pjesë në menaxhim ose operacionet e një njësie publike që është objekt auditimi. Personeli i auditimit nuk duhet të bëhet anëtar i komiteteve të menaxhimit dhe në qoftë se auditimi mendon se duhet caktuar, ata duhet të japin këshilla ose rekomandime të auditimit dhe të njihen në mënyrë të qartë si të tillë.

Çdo personeli i SAI-t që ka lidhje të ngushtë me menaxhimin e një njësi publike që është subjekt auditimi, siç janë lidhjet familjare, sociale, apo marrëdhënie të tjera të favorshme që zvogëlojnë objektivitetin, nuk duhet të caktohet për të audituar këtë njësi publike.

Personeli i SAI-t nuk duhet të përfshihet e të udhëzojë personelin e njësisë publike të audituar për sa i përket detyrave të tyre. Në ato raste kur SAI vendos të qëndrojë në zyrë të përhershme tek njësi publike që është subjekt auditimi, me qëllim lehtësimin e rishikimit të vazhdueshëm të operacioneve, programeve dhe veprimtarive të njësisë publike personeli i SAI-t nuk duhet të angazhohen në asnjë vendimmarrje apo proces miratimi i cili është konsideruar si përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike të audituar.

SAI mund të bashkëveprojë me institucionet akademike dhe të hyjë në marrëdhënie formale me organet profesionale, me kusht që marrëdhëniet nuk do të pengojnë pavarësinë dhe objektivitetin e tij, me qëllim që të përfitojë nga këshillat e anëtarëve që kanë përvojë të madhe në profesion.

Kompetenca

Standardet e përgjithshme për audituesit dhe SAI-t përfshijnë

Audituesi dhe SAI duhet të zotërojnë kompetencat e duhura.

Paragrafët në vijim shpjegojnë kompetencën si një standard auditimi.

Mandati i SAI-t në përgjithësi imponon një detyrë për formimin e opinioneve, raportimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të auditimit. Në disa SAI kjo detyrë mund t'i ngarkohet drejtuesit të institucionit (organizatës). Në SAI-t e organizuara në mënyrë kolegjiale detyra zakonisht është e vendosur nga vetë institucionin.

Diskutimi brenda SAI-t promovon objektivitetin dhe autoritetin e mendimeve dhe vendimeve. Kur një SAI është i strukturuar në formë

kolegjiale, opinionet dhe vendimet përfundimtare përfaqësojë pikëpamjen e organizatës në tërësi, edhe nëse veprimi është marrë ose ushtrohet në organet të ndryshme nga përbërja, por jo në pushtetin e tyre për shembull, Dhoma, Dhoma e Përbashkët ose pjesë të një Dhome. Në qoftë se SAI ka një drejtues të vetëm të gjitha mendimet dhe vendimet merren nga ky drejtues, ose në emër të tij.

Meqenëse detyrat dhe përgjegjësitë e lindura nga ana e SAI-t janë vendimtare në konceptin e përgjegjësisë publike, SAI duhet të aplikojë në auditimet e tij, metodologjitë dhe praktikat e një cilësie të lartë. Është detyrë e SAI-t të formulojë procedurat për të siguruar një ushtrim sa më efektiv të përgjegjësive të tij në raportet e auditimit, respektimin e të gjitha standardeve, procedurave të planifikimit, metodologjive dhe të mbikëqyrjes prej personelit ose ekspertëve të jashtëm.

86. SAI duhet të zotërojë një sërë aftësish dhe përvojën e nevojshme për kryerjen efektive të mandatit të auditimit. Cilado qoftë natyra e auditimeve që do të ndërmerren nën atë mandat, puna e auditimit duhet të kryhet nga persona ku arsimi dhe eksperiencia në punë është proporcionale me natyrën, qëllimin dhe kompleksitetin e detyrës së auditimit. ILA duhet të jetë e pajisur me një gamë të plotë të azhurnuar të metodikave të auditimit, duke përfshirë sistemet me bazë teknike, metodat analitike të shqyrtimit, marrjen e mostrave statistikore dhe auditimin e sistemeve të informacionit të automatizuar.

Sa më i gjerë dhe i lirë është në natyrë mandati i SAI-t, aq më e vështirë bëhet detyra për të siguruar cilësinë e performancës mbi të gjithë mandatin. Kështu një mandat i cili lejon SAI-n të vendosë vetë frekuencën e kryerjes së auditimeve dhe natyrën e ofrimit të raporteve, kërkon standarde të larta të menaxhimit brenda SAI-t.

Kujdesi i duhur

Standardet e përgjithshme të audituesve dhe të SAI-t përfshijnë

Audituesi dhe SAI duhet të ushtrojnë kujdesin dhe interesimin e duhur që të jetë në përputhje me standardet e auditimit të INTOSAI. Kjo përfshin kujdesin e duhur në specifikimin, mbledhjen dhe vlerësimin e evidencave, si dhe në raportimin e gjetjeve, përfundimeve dhe rekomandimeve.

Paragrafët në vijim shpjegojnë kujdesin e duhur si një standard auditimi.

SAI duhet të jetë objektiv, dhe të shihet si e tillë, në auditimin e tij mbi njësitë publike dhe ndërmarrjet publike. Ai duhet të jetë i drejtë në raportimin e rezultateve të auditimeve dhe në vlerësimet e tij.

Performanca dhe ushtrimi i aftësive teknike i një cilësie duhet të jenë të përshtatshme me kompleksitetin e një auditimi të caktuar. Audituesit duhet të jenë vigjilent për situatat, dobësitë e kontrollit, mangësitë në mbajtjen e të dhënave, gabimet dhe transaksionet e pazakonshme ose rezultate të cilat mund tregojnë mashtrimin, shpenzime të pahijshme ose të paligjshme, operacione të paautorizuara, humbjet, mosarritjen rendimentit ose mungesa e ndershmërisë.

Kur një njësi publike e autorizuar ose e njohur vendos standardet dhe udhëzimet për kontabilitetin dhe raportimin ndaj ndërmarrjeve publike, SAI mund t'i përdorë këto udhëzime gjatë shqyrtimit të tij.

Nëse SAI punëson ekspertë të jashtëm si konsulentë ai duhet të ushtrojë kujdesin e duhur për t'u siguruar rreth kompetencave dhe zotësive të konsulentëve në përfshirjen e detyrave të caktuara. Ky standard zbatohet gjithashtu kur SAI merr auditues të jashtëm me kontratë. Gjithashtu duhet treguar kujdes për të siguruar që kontratat e auditimit të cilat përfshijnë dispozita të mjaftueshme për SAI-n për të përcaktuar planifikimin, qëllimin e auditimit, të kryer dhe raportimi mbi atë auditimin.

SAI, në përmbushjen e funksioneve të tij, duhet të kërkojë këshilla nga specialistë të jashtëm, standardet për ushtrimin e kujdesit të duhur në marrëveshje të tilla kanë një influencë gjithashtu në ruajtjen e cilësisë së performancës. Marrja e këshillave nga një ekspert i jashtëm nuk e liron SAI-n prej përgjegjësive për mendimet e formuara ose përfundimet e arritura ndaj detyrës së auditimit.

Kur SAI përdor punën e një audituesi tjetër, ai duhet të aplikojë procedurat e duhura për të garantuar sigurinë se audituesi tjetër ka ushtruar kujdesin e duhur dhe në përputhje me standardet relevante të auditimit dhe mund të rishikojë punën e audituesit tjetër për të kënaqur veten për cilësinë e punës.

Në përputhje me përgjegjësitë e audituesit, informacioni i fituar rreth njësisë publike gjatë rrjedhës së punës së auditimit nuk duhet të përdoren për qëllime jashtë fushës së auditimit dhe raportimit ose formimin e opinionit. Është thelbësore që SAI të ruaj fshehtësinë në lidhje me çështjet e auditimit dhe informacionet që mund të dalin gjatë ushtrimit të detyrës e tij. Megjithatë, SAI duhet të ketë të drejtën për të raportuar shkeljet ligjore tek autoritetet e duhura të prokurorisë.

Standardet të tjera të përgjithshme për SAI-t

Standardet e përgjithshme për SAI-t përfshijnë

SAI duhet të adoptojnë politika dhe procedura për rekrutimin e personelit që kanë kualifikimet e duhura.

Paragrafi i mëposhtëm shpjegon rekrutimin, si një standard të auditimi.

Personeli i SAI-t duhet të ketë kualifikimet e duhura akademike dhe të jetë i pajisur me trajnimin dhe eksperiencën e duhur. SAI duhet të krijojë dhe të rishikojë rregullisht, kërkesat minimale arsimore për emërimin e audituesve.

Standardet e përgjithshme për SAI-t përfshijnë

SAI-t duhet të adoptojnë politika dhe procedura për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tyre për t'i aftësuar ata që të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë efektive dhe për të përcaktuar bazat për avancimin profesional të audituesve dhe stafit tjetër.

Paragrafët në vijim shpjegojnë trajnimin dhe zhvillimin si një standard auditimit.

SAI duhet të marrë masat e duhura për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të tij, duke përfshirë përgatitjen e trajnimit në institucion dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së kurseve të jashtme.

SAI duhet të mbajë një inventar për aftësitë e personelit, që të ndihmojnë në planifikimin e auditimeve, si dhe për të identifikuar nevojat e zhvillimit profesional.

SAI duhet të vendosë dhe të rishikojë rregullisht kriteret, duke përfshirë kërkesat arsimore, për përmirësimin e audituesve dhe të stafit tjetër të SAI-t.

SAI duhet të krijojë dhe mirëmbajë procedurat dhe politikat për zhvillimin profesional të stafit të audituesve në lidhje me teknikat e auditimit dhe metodologjitë e zbatueshme rreth auditimeve që ai ndërmerr.

Personeli i SAI-t duhet të ketë njohuri të mira rreth mjedisit të qeverisë, duke përfshirë aspekte të tilla si roli i pushtetit legjislativ, dispozitave ligjore dhe institucionale që rregullon veprimtarinë e ekzekutivit dhe statutet e ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, personeli auditues i trajnuar duhet të ketë njohuritë e mjaftueshme rreth standardeve, politikave, procedurave dhe praktikave të auditimit të SAI-t.

Auditimi i sistemeve financiare, të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare kërkon trajnim në fushën e kontabilitetit dhe në disiplinat përkatëse, gjithashtu një njohuri të legjislacionit në fuqi dhe urdhrave ekzekutive që ndikojnë në përgjegjshmërinë e njësisë publike të audituar. Për më tepër, kryerja e auditimeve të performancës mund të kërkojë, përveç sa thamë më sipër, trajnimin e personelit në fusha të tilla si administrim, menaxhim, ekonomi dhe shkenca sociale.

SAI-t duhet të inkurajojnë personelin e tij për t'u bërë anëtarë të një organi profesional të rëndësishme për punën e tyre dhe për të marrë pjesë në aktivitete e atij organi.

Standardet e përgjithshme për SAI-t përfshijnë:

SAI-t duhet të adoptojnë politika dhe procedura për të përgatitur manuale dhe instruksione e udhëzime të tjera të shkruara për kryerjen e auditimeve.

Paragrafi i mëposhtëm shpjegon udhëzimin e shkruar si një standard auditimi.

Komunikimi i stafit të SAI-t me anë të qarkoreve që përmbajnë udhëzime dhe mirëmbajtjen e azhurnuar të manualit të auditimit, vendosjen e

politikave të SAI-t, praktikave dhe standardeve, është i rëndësishëm në ruajtjen e cilësisë së auditimeve.

Standardet e përgjithshme për SAI-t përfshijnë

SAI-t duhet të adoptojnë politika dhe procedura për të mbështetur aftësitë dhe përvojat e disponueshme brenda SAI-t dhe të identifikojnë ato aftësi që i mungojnë; të sigurojnë një shpërndarje të mirë të aftësive gjatë detyrave të auditimit dhe të sigurojnë një numër të mjaftueshëm të personave për kryerjen e auditimit; të kenë planifikimin dhe mbikëqyrjen e duhur për të arritur qëllimet e tij në nivelin e kërkuar.

Paragrafët e mëposhtëm të shpjegojnë përdorimin e aftësive si një standard të auditimit.

Për të ndërmarrë çdo auditim duhet të vlerësohen burimet e nevojshme, si rrjedhojë mund të përshtatet stafi i kualifikuar për të punuar dhe të kontrolluar stafin e ri që do kryejë auditimin.

Shkalla në të cilën arritjet akademike duhet të jenë të lidhura në mënyrë specifike me detyrën e auditimit ndryshon me llojin e auditimit të ndërmarrë. Nuk është e nevojshme që secili auditues të ketë aftësi në të gjitha aspektet (pikat) e mandatit të auditimit. Megjithatë, politika dhe procedura që rregullojnë në caktimin e personelit në detyrat audituese duhet të synojë vendosjen e personelit që ka aftësitë audituese të kërkuara me natyrën e detyrës së auditimit në mënyrë që grupi i përfshirë në një auditim të caktuar kolektivisht të posedojë aftësitë dhe ekspertizën e nevojshme.

Nëse kryerja e suksesshme e një auditimi kërkon që gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet të jenë të kuptueshme dhe të bazuara mirë dhe pasqyrojnë një përmbajtje të përshtatshme të periudhës së audituar të një njësie publike, SAI duhet të jetë i lirë që të rekrutojë e të fitojnë aftësitë e specializuara nga burimet e jashtme. Është në gjykimin e SAI-t, në rrethana të veçanta, deri në çfarë mase janë përmbushur më së miri kërkesat e tij prej ekspertizës së kryer nga specialistët e tij kundrejt punësimit të ekspertëve të jashtëm.

Politikat dhe procedurat që rregullojnë mbikëqyrjen e auditimeve janë faktorë të rëndësishëm në kryerjen në nivelin e duhur e kompetent të rolit të SAI-t. SAI-t duhet të sigurojnë që auditimet janë planifikuar dhe

mbikëqyrur nga audituesit që janë kompetent, që njohin standardet dhe metodologjitë e SAI-t dhe që kanë njohuri mbi specialitetet dhe veçoritë e mjedisit.

Kur mandati i SAI-t përfshin auditimin e pasqyrave financiare që mbulojnë degët e qeverisë ekzekutive në tërësi, grupet e vendosura të auditimit duhet të jenë të pajisura për të ndërmarrë një vlerësim të koordinuar të sistemeve të departamentit të kontabilitetit, si dhe të agjencisë qendrore të marrëveshjeve të koordinimit dhe mekanizmave të kontrollit. Grupeve do t'u kërkohet që të kenë njohuri mbi sistemet përkatëse qeveritare të kontabilitetit dhe të kontrollit, si dhe një ekspertizë të mjaftueshme në teknikat e auditimit të aplikuara nga SAI-t për këtë lloj auditimi.

Nëse SAI është i pajisur për të ndërmarrë, në një kohë të arsyeshme, të gjitha auditimet përkatëse, duke përfshirë auditimet e performancës që mbulojnë të gjithë veprimtarinë e çdo njësie publike të audituar, janë të nevojshme kriteret për përcaktimin e shkallës e aktiviteteve të auditimit të cilat, brenda periudhës ose ciklit të auditimit, do të japin siguri maksimale praktike në lidhje me përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësisë publike nga çdo njësi ekonomike e audituar.

Në përcaktimin e shpërndarjes së burimeve të tij midis aktiviteteve të ndryshme të auditimit, SAI duhet ti jap përparësinë që duhet çdo detyrë të auditimit, me ligj, të përfundojë brenda një periudhe të caktuar kohore. Kujdes duhet t'i kushtohet planifikimit strategjik në mënyrë që të identifikojnë sipas përparësive për auditimet që do të ndërmerren.

Caktimi i prioriteteve në përputhje me ruajtjen e cilësisë gjatë përmbushjes së mandatit përfshin ushtrimin e gjykimit të SAI-t në bazë të informatave të vëna në dispozicion. Mirëmbajtjen e një portofoli të dhënash që kanë të bëjnë me strukturën, funksionet dhe operacionet e njësive publike të audituara do të ndihmojë SAI-n në identifikimin e fushave të materialitetit dhe vulnerabilitetit dhe zonat që kanë mundësi për përmirësime në administratë.

Para çdo auditimi është ndërmarrë autorizimi (programi) i duhur për fillimin e tij, i cili duhet të jepet nga personeli i caktuar brenda SAI-t. Ky autorizim (program) duhet të përfshijë një deklaratë të qartë të objektivave të auditimit, objektivin dhe qëllimin e tij, burimet që do të zbatohen për auditimin në lidhje me aftësitë dhe sasitë, rregullimet për

rishikimin e progresit në pikat e duhura, si dhe datat në të cilin do të jetë përfunduar puna në terren dhe sigurimi i një raporti mbi auditimi.

Standardet e përgjithshme për SAI-t përfshijnë

SAI-t duhet të adoptojnë politika dhe procedura për rishikimin e efikasitetit dhe efektivitetit të standardeve dhe procedurave të brendshme të tij.

Paragrafët në vijim shpjegojnë rishikimin e sigurimit të cilësisë si një standard auditimit.

Për shkak të rëndësisë për të siguruar një standard të lartë të punës nga ana e ILA, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë programeve të sigurimit të cilësisë për të përmirësuar performancën dhe rezultatet e auditimit. Përfitimet që rrjedhin nga programe të tilla e bëjnë të domosdoshme të jenë në dispozicion burimet e përshtatshme për këtë qëllim. Është e rëndësishme që përdorimi i këtyre burimeve të krahasohet me përfitimet që do të merret.

SAI duhet të vendosi sisteme dhe procedura për:

- (a) të konfirmuar se proceset e integruara për sigurimin e cilësisë kanë vepruar në mënyrë të kënaqshme;
- (b) të siguruar cilësinë e raportit të auditimit, dhe
- (c) të siguruar përmirësime dhe për të shmangur përsëritjen e dobësive.

Si një mjet i mëtejshëm për sigurimin cilësor të performancës, është shtimi i personelit për shqyrtimin e veprimtarisë së auditimit, i cili ka përgjegjësi të njëjtë për auditimet në fjalë, është e dëshirueshme për SAI-t të krijojnë rregullat (standardet) e tyre për sigurimin e cilësisë. Kjo përfshin, planifikimin, kryerjen dhe raportimin në lidhje me auditimet e marra sipas metodës me përzgjedhje mund të rishikohet në thellësi nga personeli i kualifikuar i SAI-t që nuk janë të përfshirë në këto auditime, duke u konsultuar me drejtuesit përkatës të auditimit në lidhje me rezultatit e angazhimeve të brendshme për sigurimin e cilësisë dhe raportimin periodik tek menaxhimi i lartë i SAI-t.

Është e nevojshme që SAI-t të krijojnë e të vënë në funksionim auditimin e brendshëm, i cili ka një status të gjerë për të ndihmuar menaxhimin e SAI-t që të arrijnë efektivisht punët e tyre dhe të mbështesin cilësinë e punës së tyre.

Cilësia e punës së SAI-t mund të rritet duke forcuar rishikimin e brendshëm dhe ndoshta me një vlerësim të pavarur të punës së tij.

Në disa vende auditimi i rregullshmërisë dhe ligjshmërisë merr formën e një kontrolli parandalues të shpenzimeve publike, në mënyrë që shpenzimet të miratohen nga ana e SAI-t.

Përgjithësisht, auditimi parandalues duhet të kuptohet si një auditim i cili kryhet në një kohë që ende e lejon institucionin auditues për të parandaluar një veprim i cili është gjykuar si i pa rregullt.

Ndërsa auditim "pas-faktit" mund të gjejë vetëm parregullsitë kur ato kanë ndodhur tashmë dhe kur është më e vështirë për të korrigjuar ato, auditimi "para-faktit" nga ana tjetër sjell një sanksion të menjëhershëm: refuzimi i përcaktuar për miratimin dhe autorizimin nga SAI në rast parregullsie juridike ose kontabël.

Disa SAI ndihmojnë në zhvillimin dhe/ose në shqyrtimin dhe miratimin e sistemeve të kontabilitetit dhe më pas të shqyrtojnë zbatimin e këtyre sistemeve në praktikë.

SAI duhet të sigurojë që standardet e aplikueshme janë ndjekur në të dyja rastet si në auditimin para faktit ashtu dhe në auditimin pas faktit dhe se mos zbatimi i standardeve të cilat janë miratuara duhet të jetë i dokumentuar.

ISSAI 300

Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror

Qëllimi i standardeve të fushës është vendosja e kriterëve ose e kuadrit të përgjithshëm për hapat e qëllimshme, sistematike dhe të balancuara ose veprimet që audituesi duhet të ndjekë. Këto hapa dhe veprime përfaqësojnë rregullat e hulumtimit që audituesi, si një kërkues i dëshmive të auditimit, zbaton për të arritur një rezultat të veçantë.

Standardet e fushës vendosin kuadrin për zhvillimin dhe menaxhimin e punës së auditimit. Ato janë të lidhura me standardet e përgjithshme të auditimit, të cilat përcaktojnë kërkesat bazë për ndërmarrjen e detyrave që mbuloohen nga standardet e fushës. Standardet e fushës janë të lidhura edhe me standardet e raportimit, të cilat mbulojnë aspektin e komunikimit të auditimit, këto standarde përbëjnë burimin kryesor për përmbajtjen e opinionit ose raportit.

Standardet e fushës janë të zbatueshme për të gjitha llojet e auditimit

(a) Audituesi duhet të planifikojë auditimin në mënyrë që të sigurojë një auditim të një cilësie të lartë, ta përfundojë në formë ekonomike, eficiente, efektive dhe në kohën e duhur.

(b) Puna e stafit auditues duhet të jetë e mbikëqyrur siç duhet gjatë çdo niveli dhe faze të auditimit dhe puna e dokumentuar duhet të rishikohet nga një anëtar i lartë i stafit të auditimit.

(c) Audituesi, në përcaktimin e shtrirjes dhe fushëveprimit të auditimit, duhet të studiojë dhe të vlerësojë besueshmërinë e kontrollit të brendshëm.

(d) Në kryerjen e auditimeve të rregullsisë (financiare), duhet të bëhet një test i përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Audituesit duhet të hartojnë hapat dhe procedurat e auditimit për të garantuar siguri të arsyeshme në zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme që mund të kenë një efekt të drejtpërdrejtë dhe material mbi shumat e pasqyrave financiare ose në rezultatet e auditimeve të rregullshmërisë. Audituesi gjithashtu duhet të jetë i vetëdijshëm për mundësinë e veprimeve të paligjshme që mund të kenë një efekt indirekt dhe material në pasqyrat financiare ose në rezultatet e auditimeve të rregullshmërisë.

Në kryerjen e auditimeve të performancës, duhet të bëhet një vlerësim i përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi kur është e nevojshme

për të përmbushur objektivat e auditimit. Audituesi duhet të planifikojë auditimin që të ofrojë siguri të arsyeshme për zbulimin e veprimeve të paligjshme që mund të ndikojnë dukshëm në objektivat e auditimit. Audituesi gjithashtu duhet të jetë vigjilent në situata apo transaksione që mund të jenë tregues i veprimeve të paligjshme dhe që mund të ketë një efekt indirekt mbi rezultatet e auditimit.

Çdo tregues i një parregullsie, veprimi të paligjshëm, mashtrimi apo gabimi që mund të ketë ndodhur i cili mund të ketë një efekt material në auditim duhet të nxisë audituesin që të kërkojë zgjatjen procedurave për të konfirmuar ose për të larguar dyshimet e tilla.

Auditimi i rregullshmërisë është një aspekt thelbësor i auditimit të qeverisë. Një objektiv i rëndësishëm i këtij lloji auditimi që i caktohet SAI-t është që të sigurohet me të gjitha mjetet e vëna në dispozicion të saj, që Buxhetit i Shtetit dhe llogaritë janë të plota dhe të vlefshme. Kjo do t'i japë Parlamentit dhe përdoruesve të tjerë të raportit të auditimit një siguri në lidhje me zhvillimet e detyrimeve financiare të shtetit. Për të arritur këtë objektiv SAI do të shqyrtojë llogaritë dhe pasqyrat financiare të administratës, me qëllim për të siguruar që të gjitha operacionet janë sipas rregullave, janë të plota, të miratuara, të paguara dhe të regjistruara. Për procedurat e auditimit që normalisht rezultojnë që nuk kanë parregullsi, jepet një "miratim."

(e) Duhet të merren evidenca kompetente, relevante dhe të arsyeshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e audituesit lidhur me organizimin, programin veprimtarinë, ose funksionimin sipas auditimit.

(f) Në kontrollet, auditimet e rregullsisë (financiare) dhe në llojet e tjera të auditimit kur aplikohen, audituesit duhet të analizojnë pasqyrat financiare për të përcaktuar nëse janë në përputhje me standardet e pranueshme të kontabilitetit për raportimin financiar dhe zbulimit. Analiza e pasqyrave financiare duhet të kryhet në një shkallë të tillë që të merret një arsyetim bazë për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare.

Planifikim

Standardet e fushës përfshijnë

Audituesi duhet të planifikojnë auditimin në një mënyrë që të sigurojë një auditim të një cilësie të lartë e të kryhet në një mënyrë ekonomike, eficiente dhe efektive dhe në kohën e duhur.

Paragrafët në vijim shpjegojnë planifikimin si një standard auditimi.

SAI duhet të japë përparësi të gjitha detyrave të auditimit që duhet të ndërmerren nga ligj dhe të vlerësojë përparësitë për zonat diskrete brenda mandatit të SAI-t.

Gjatë planifikimit të auditimit, audituesi duhet:

- (a) të identifikojë aspektet e rëndësishme të mjedisit në të cilin vepron njësia publike e audituar;
- (b) të zhvillojnë njohuritë e marrëdhënieve llogaridhënëse;
- (c) të marrë në konsideratë formën dhe përmbajtjen e opinionëve, përdoruesit e auditimit, konkluzionet ose raportet;
- (d) të përcaktojë objektivat e auditimit dhe testet e nevojshme që më pas t'i përmbushi ato;
- (e) të identifikojnë sistemet kryesore të menaxhimit dhe të kontrollit dhe të kryejë një vlerësim paraprak për të identifikuar anët e forta dhe të dobëta;
- (f) të përcaktojë materialitetin e çështjeve që do merren në konsideratë;
- (g) të rishikojë auditimin e brendshëm të njësisë publike që auditon dhe programin e tij të punës;
- (h) të vlerësojë nivelin e besueshmërisë që mund të vendoset nga audituesit e tjerë, për shembull, auditimit të brendshëm;
- (i) të përcaktojë mënyrën më eficiente dhe efektive të auditimit;

(j) të sigurojë një rishikim për të përcaktuar nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të cilat janë raportuar më parë; dhe

(k) të sigurojë dokumentacionin e duhur për planifikimin dhe programin e auditimit gjatë punës në terren.

Hapat e mëposhtme normalisht janë përfshirë në planifikimin e auditimit:

(a) të mbledhë informacion rreth njësisë publike që do auditohet, organizimin e tij dhe të vlerësojë rrezikun dhe për të përcaktuar materialitetin;

(b) të përcaktojë qëllimin dhe objektivat e auditimit;

(c) të ndërmarrë një analizë paraprake për të përcaktuar mënyrën dhe natyrën që do të miratohet dhe shtrirjen e hulumtimeve që të kryhen më vonë;

(d) të nxjerrë në pah probleme të veçanta që dalin gjatë planifikimit të auditimit;

(e) të përgatisë një buxhet dhe afatin kohor që duhet për kryerjen e auditimit;

(f) të identifikojë kërkesat e stafit dhe grupit të auditimit, dhe

(g) njësia publike e audituar të familjarizohet në lidhje me qëllimin, objektivat dhe kriteret e vlerësimit të auditimit dhe për të diskutuar me ata kur është e nevojshme.

SAI mund të rishikojë planin gjatë auditimit kur është e nevojshme.

Mbikëqyrja dhe rishikimi

Standardet e fushës përfshijë

Punën e stafit të auditimit në çdo nivel dhe fazë të auditimit duhet të jetë e mbikëqyrtur siç duhet gjatë auditimit, dhe puna e dokumentuar duhet të rishikohet nga një anëtar i lartë i stafit të auditimit.

Paragrafët në vijim shpjegojnë mbikëqyrjen dhe rishikimin, si një standard auditimit.

Mbikëqyrja është thelbësore për të siguruar përmbushjen e objektivave të auditimit dhe ruajtjen e cilësisë së punës së auditimit. Mbikëqyrja dhe kontrolli i duhur është e nevojshme në të gjitha rastet, pavarësisht nga kompetencat e secilit auditues.

Mbikëqyrja duhet të drejtojë si përmbajtjen ashtu dhe metodën e auditimit. Ky proces shërben për të siguruar që:

- (a) anëtarët e grupit të auditimit të kenë një kuptim të qartë dhe të qëndrueshëm të planit të auditimit;
- (b) që auditimi është kryer në përputhje me standardet dhe praktikat e auditimit të SAI-t;
- (c) planifikimi i auditimit dhe hapat e veprimit të përcaktuara në këtë plan janë ndjekur përveç se rasteve kur është bërë një ndryshim i autorizuar;
- (d) letrat e punës përmbajnë evidenca të sakta ku mbështeten të gjitha konkluzionet, rekomandimet dhe opinionet;
- (e) audituesi i ka arritur objektivat e përcaktuara të auditimit, dhe
- (f) raporti i auditimit përfshin konkluzionet e auditimit, rekomandimet dhe opinionet, sipas rastit.

Të gjithë punët e auditimit duhet të rishikohen nga një anëtar i lartë i stafit të auditimit para se opinionet ose raportet e auditimit të marrin formën përfundimtare. Ai duhet të kryhet si një pjesë e procesit të auditimit. Rishikimi në më shumë se një nivel të përvojës dhe gjykimit të detyrave të auditimit duhet të sigurojë që:

- (a) të gjitha vlerësimet dhe konkluzionet janë të bazuara dhe janë të mbështetura me evidenca kompetente, përkatëse dhe të arsyeshme të auditimit, për krijimin e opinionit ose raportit përfundimtar të auditimit;

(b) të gjitha gabimet, mangësitë dhe çështjet e pazakonta janë identifikuar si duhet, dokumentuar, ose t'u jepet zgjidhje e kënaqshme, ose t'i paraqitet stafit më të lartë të SAI-t; dhe

(c) janë të identifikuara, regjistruara ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme për kryerjen e auditimeve të ardhshme, janë marrë në konsideratë në planet e më vonshme të auditimit dhe në aktivitetet e zhvillimit të stafit.

Ky standard vepron ndryshe në SAI-t e organizuar në një formë kolegjiale. Në një strukturë të tillë, vendimet, përveç atyre të natyrës së zakonshme, janë marrë në mënyrë kolegjiale në një nivel të përshtatshëm mbi rëndësinë e çështjes. Një njësi publike i tillë, si një e tërë, vendos për shtrirjen e ekzaminimit, testet që do të ndërmerren dhe metodat që do të përdoren.

Studimi dhe vlerësimi i Kontrollit të Brendshëm

Standardet e fushës përfshijnë

Audituesi, në përcaktimin e qëllimit dhe shtrirjes së auditimi, duhet gjithashtu të studiojë dhe të vlerësojë besueshmërinë e kontrollit të brendshëm.

Paragrafët në vijim shpjegojnë kontrollin e brendshëm si një standard auditimit.

Studimi dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm duhet të kryhet sipas llojit të auditimit që ndërmerret. Në rastin e një auditimi të rregullsisë (financiare), studimi dhe vlerësimi bëhet kryesisht në kontrollet që ndihmojnë në ruajtjen e asetëve dhe burimeve, dhe të sigurojë saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të kontabilitetit. Në rastin e auditimit të rregullsisë (përputhshmërisë), studimi dhe vlerësimi bëhet kryesisht në kontrollet që ndihmojnë menaxhimin që të jetë në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Në rastin e auditimit të performancës, ato bëhen në kontrollet që ndihmojnë në realizimin e detyrave të njësisë publike të audituar në mënyrë ekonomike, efçente dhe efektive, duke siguruar respektimin e politikave të menaxhimit, dhe prodhimin e informacionit për menaxhimin në kohë dhe të besueshëm financiarisht.

Shtrirja e studimit dhe vlerësimit të kontrollit të brendshëm varet nga objektivat e auditimit dhe nga shkalla e sigurisë të parashikuar.

Kur kontabiliteti ose sistemet e tjera të informacionit janë të kompjuterizuara, audituesi duhet të vendosë nëse kontrollet e brendshme funksionojnë siç duhet për të siguruar integritetin, besueshmërinë dhe plotësinë e të dhënave.

Përputhja me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme

Standardet e fushës përfshijnë:

Në kryerjen e auditimeve të rregullsisë (financiare), duhet të bëhet një test i përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Audituesi duhet të hartojnë hapat e auditimit dhe procedurat për të dhënë një siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive, dhe akteve të paligjshme që mund të kenë një efekt të drejtpërdrejtë dhe materiale mbi shumat e pasqyrave financiare ose rezultateve të auditimeve të rregullshmërisë. Audituesit gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm për mundësinë e veprimeve të paligjshme që mund të ketë një efekt indirekt dhe material në pasqyrat financiare ose në rezultatet e auditimeve të rregullshmërisë.

Në kryerjen e auditimeve të performancës, një vlerësim duhet të bëhet mbi përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, kur është e nevojshme, për të përmbushur objektivat e auditimit. Audituesi duhet të planifikojë auditimin në mënyrë që të ofrojë një siguri të arsyeshme mbi zbulimin e veprimeve të paligjshme që mund të ndikojnë dukshëm në objektivat e auditimit. Audituesi po ashtu duhet të ketë kujdes në situata apo transaksione që mund të jenë tregues i veprimeve të paligjshme që mund të ketë një efekt indirekt mbi rezultatet e auditimit.

Auditimi i rregullsisë është një aspekt thelbësor i auditimit të qeverisë. Një objektiv i rëndësishëm i këtij auditimi që i caktohet SAI-t është për t'u siguruar, me të gjitha mjetet vënë në dispozicion të saj, se buxheti i shtetit dhe llogaritë janë të plota dhe të vlefshme. Kjo do t'i japë Parlamentit dhe përdoruesve të tjerë të raportit të auditimit siguri në lidhje me madhësinë dhe zhvillimin e detyrimit financiar të shtetit. Për të arritur këtë objektiv SAI do të shqyrtojë llogaritë dhe pasqyrat financiare të administratës, me qëllim për të siguruar që të gjitha operacionet janë bërë si duhet, të plota, të miratuara, të paguar dhe të

regjistruara. Procedurat e auditimit që normalisht rezultojnë që nuk kanë parregullsi, jepet një “miratim.”

Paragrafët në vijim shpjegojnë përputhshmërinë si një standard auditimi.

Rishikimi i përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret është veçanërisht e rëndësishme kur auditohen programet qeveritare për arsye se vendimmarrësi duhet të dijë nëse ligjet dhe rregulloret janë duke u ndjekur, nëse ato kanë pasur ose jo rezultatet e dëshiruara, çfarë ndryshimesh janë të nevojshme. Përveç kësaj organet qeveritare, programet, shërbimet, aktivitetet, dhe funksionet janë hartuar sipas ligjeve dhe janë subjekt i rregullave dhe rregulloreve më specifike.

Ata që planifikojnë auditimin duhet të kenë njohuri rreth kërkesave të përputhshmërisë që janë të aplikueshme për njësitë që do auditohen. Për shkak të ligjeve dhe rregulloreve që mund të zbatohen për një auditim të veçantë shpesh janë të shumta, audituesit duhet të ushtrojnë gjykimin profesional në përcaktimin e atyre ligjeve dhe rregulloreve që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në objektivat e auditimit.

Audituesi gjithashtu duhet të jetë i kujdesshëm në situata apo transaksioneve që mund të jenë tregues i veprimeve të paligjshme që mund të ndikojnë në mënyrë indirekte në rezultatet e auditimit. Kur hapat e auditimit dhe procedurat tregojnë se aktet e paligjshme kanë ose mund të ketë ndodhur, audituesi duhet të përcaktojë shkallën në të cilën këto veprime ndikojnë në rezultatet e auditimit.

Në kryerjen e auditimeve në përputhje me këtë standard, audituesit duhet të zgjedhin dhe të kryejnë hapa dhe procedurat e auditimit, sipas gjykimit të tyre profesional, që janë të përshtatshme. Këto hapa dhe procedura të auditimit duhet të jenë të planifikuara për të marrë evidenca të mjaftueshme, kompetente, dhe të rëndësishme që do të sigurojë një bazë të arsyeshme për gjykimin dhe konkluzionet e tyre.

Në përgjithësi, menaxhimi është përgjegjës për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm për të siguruar përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret. Në përcaktimin e hapave dhe procedurave për të testuar ose vlerësuar përputhshmërinë, audituesit duhet të vlerësojnë kontrollin e brendshëm të njësisë publike dhe të vlerësojnë rrezikun që struktura e kontrollit nuk mund të parandaloj ose zbuloj mospërputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret.

Pa ndikuar në pavarësinë e SAI-t, audituesit duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur profesional dhe maturinë e tyre në lidhje me shtrirjen e hapave të auditimit dhe me procedurat aktet e paligjshme, që të mos ndërhyjë në hetimet e mundshme në të ardhmen, ose në procedurat ligjore. Kujdesi i duhur do të përfshijë konsultimet, këshillat e nevojshme ligjore dhe organet e zbatimit të ligjit në fuqi, për të përcaktuar hapat e auditimit dhe procedurat që duhen ndjekur.

Evidencat e auditimit

Standardet e fushës përfshijnë:

Duhet të merren evidenca kompetente, të dhënat përkatëse dhe të arsyeshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e audituesit lidhur me organizimin, veprimtarinë programin, ose funksionimin që i nënshtrohet auditimit.

Paragrafët në vijim shpjegojnë evidencat e auditimit, si një standard auditimi.

Zbulimet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit duhet të bazohen në evidenca. Meqenëse audituesit rrallë kanë mundësi të shqyrtojnë të gjitha të dhënat rreth njësisë publike të audituar, është e rëndësishme që grumbullimi i të dhënave dhe teknikat e marrjes së mostrave të jenë të zgjedhura me kujdes. Kur të dhënat kompjuterike në bazë të sistemit janë një pjesë e rëndësishme e auditimit dhe besueshmëria e të dhënave është kritike për të realizuar objektivin e auditimit, audituesit duhet të sigurojnë veten e tyre se të dhënat janë të besueshme dhe të rëndësishme.

Audituesit duhet të kenë njohuri të mira të teknikave dhe procedurave të tilla si, inspektimi vëzhgimi hetim, dhe konfirmimi, për të mbledhur evidencat e auditimit. ILA duhet të sigurojnë që teknikat e përdorura të janë të mjaftueshme e të arsyeshme për të zbuluar të gjitha gabimet dhe parregullsitë materiale.

Në zgjedhjen e metodave dhe procedurave, duhet të merren në konsideratë cilësia e evidencave, pra evidencat duhet të jenë kompetente, relevante dhe të arsyeshme.

Audituesit duhet të dokumentojnë në mënyrë të saktë evidencat e auditimit në letrat e punës, duke përfshirë bazat dhe shtrirjen e planifikimit, punën e kryer dhe rezultatet e auditimit.

Dokumentacioni i saktë është i rëndësishëm për disa arsye. Ai do të:

- (a) konfirmojë dhe të mbështesë mendimet dhe raportet e audituesit;
- (b) rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e auditimit;
- (c) shërbejë si një burim informacioni për përgatitjen e raporteve, ose duke iu përgjigjur çdo pyetje nga njësitë publike të audituar ose nga ndonjë palë tjetër;
- (d) shërbejë si provë e zbatimit të standardeve të auditimit nga audituesi;
- (e) lehtësojë planifikimin dhe mbikëqyrjen;
- (f) ndihmojë zhvillimin profesional të audituesit;
- (g) ndihmojë për të siguruar që puna e deleguar është kryer në mënyrë të kënaqshme, dhe
- (h) ofrojë mbështetje për evidencën e punës së bërë në të ardhmen.

Audituesi duhet të ketë në konsideratë se përmbajtja dhe rregullimi i letrave të punës pasqyrojnë shkallën e aftësisë, përvojës dhe njohurive të audituesit. Dokumentet e punës duhet të jenë plotësuar dhe të jenë detajuar drejtë për të mundësuar një auditues me përvojë që nuk ka asnjë lidhje të mëparshme me auditimin e përfunduar, që të përcaktojë dhe të nxjerrë konkluzionet se çfarë pune është kryer nga dokumentet e punës.

Analiza e Pasqyrave Financiare

Standardet e fushës përfshijnë

Në auditimet e rregullsisë (financiare) dhe në llojet e tjera të auditimit kur janë të aplikueshme, audituesit duhet të analizojnë pasqyrat financiare për të përcaktuar nëse janë përmbushur standardet e pranueshme të kontabilitetit mbi zbulimin dhe raportimin financiar.

Analiza e pasqyrave financiare duhet të kryhet në një shkallë të tillë që të merret një mendim i qartë për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare.

Paragrafët në vijim shpjegojnë analizën e pasqyrave financiare si një standard auditimi.

Analiza e pasqyrave financiare ka për qëllim përcaktimin e ekzistencës së marrëdhënies së pritshme brenda dhe në mes të elementeve të ndryshme të pasqyrave financiare, duke identifikuar çdo marrëdhënie të papritur dhe ndonjë tendencë të pazakontë. Prandaj audituesi duhet të analizojë tërësisht pasqyrat financiare dhe të sigurohet nëse:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me standardet e pranueshme të kontabilitetit;
- (b) pasqyrat financiare janë paraqitur duke marrë në konsideratë rrethanat e njësisë publike të audituar;
- (c) janë paraqitur të dhëna e informacione shpjeguese të mjaftueshme në lidhje me elementet e ndryshme të pasqyrave financiare, dhe
- (d) elemente të ndryshme të pasqyrave financiare janë njohur, vlerësuar dhe prezantuar siç duhet.

Metodat dhe teknikat e analizës financiare varen gjerësisht nga natyra qëllimi dhe objektivat e auditimit, mbi njohuritë dhe gjykimi i audituesit.

Kur SAI-t i kërkohet për të raportuar mbi zbatimin e ligjeve buxhetore, auditimi duhet të përfshijë:

- (a) në llogaritë e të ardhurave, përcaktimin nëse parashikimet janë ato të buxhetit fillestar, dhe nëse auditimi i regjistrimit tatim – taksave dhe i faturave të atribuara, mund të kryhet duke i krahasuar me pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së audituar;
- (b) në llogaritë e shpenzimeve, duke verifikuar kreditë që asistojnë në buxhetin e shtetit, ligjet rregulluese, dhe raportimin e pasqyrave financiare si vitit të mëparshëm.

ISSAI 400

Standardet e Raportimit në Auditimin Shtetëror

Nuk është praktike për të hedhur poshtë një rregull për çdo situatë të veçantë gjatë raportimit. Ky standard është për të ndihmuar dhe jo të zëvendësojë gjykimin e kujdesshëm të audituesit në formulimin e opinionit ose raportit.

Shprehja "raportim" përfshin të dyja opinionin dhe vërejtjet e tjera të audituesit për një pjesë të pasqyrave financiare si rezultat i auditimit të rregullshmërisë (financiar) dhe raportimin e audituesit mbi përfundimin e auditimit të performancës.

Opinionin e audituesit në një pjesë të pasqyrave financiare në përgjithësi është i një formati konciz, me formularë të standardizuar që pasqyrojnë rezultatet e një game të gjerë të testeve dhe proceseve të tjera të auditimit. Shpesh ekziston një kërkesë për të raportuar në lidhje me përputhshmërinë e transaksioneve, ligjeve dhe rregulloreve dhe të raportohet mbi çështje të tilla si sistemet e papërshtatshme të kontrollit, veprimet e paligjshme dhe mashtrimi. Në disa shtete, detyrimet kushtetuese ose ligjore mund t'i kërkojnë SAI-t për të raportuar në mënyrë specifike mbi zbatimin e ligjeve buxhetore, duke koordinuar planifikimet buxhetore me rezultatet faktike të paraqitura në pasqyrat financiare.

Në një auditim performancë, audituesit raportojnë mbi ekonomicitetin dhe efikasitetin me të cilën burimet janë marrë e përdorur dhe efektivitetin e cila është arritja e objektivave. Raportet e tilla mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga fusha dhe natyra, për shembull, duke përfshirë nëse burimet janë përdorur në mënyrë të mirë, duke komentuar mbi ndikimin e politikave dhe programeve dhe duke rekomanduar planifikimin e ndryshimeve që do të sjellin përmirësime.

Në mënyrë që të njohë nevojat e përdoruesit, raporti i auditimit në të dy auditimet të rregullsisë dhe të performancës mund të kenë nevojë që të marrë në konsideratë periudhat e raportimit ose ciklet dhe kërkesat e nevojshme të zbulimit.

Për lehtësi të referimi në këtë kapitull, fjala "opinion" është përdorur për të kuptuar konkluzionet e audituesit si rezultat i një auditimi të rregullshmërisë (financiar), dhe mund të përfshijë çështjet e përshkruara në paragrafin 165, fjalën "raport" është përdorur për të nënkuptuar konkluzionet e auditimit pas një auditimi të performancës, siç përshkruhet në paragrafin 166.

Standardeve raportimit janë

(a) Në fund të çdo auditimi, audituesi duhet të përgatisë me shkrim një opinion ose raport, sipas rastit, të përcaktojë rezultatet në një formë të përshtatshme, përmbajtja e tij duhet të jetë e lehtë për të kuptuar dhe të mos ketë paqartësi ose dy kuptueshmëri, të përfshijnë vetëm informacionin që është mbështetur nga evidencat përkatëse dhe të përshtatshme të auditimit dhe të jetë i pavarur, objektiv, i drejtë dhe konstruktiv.

(b) I takon SAI-t për të vendosur përfundimisht veprimet që duhen të ndërmerren në lidhje me praktika mashtruese ose parregullsi serioze të zbuluara nga audituesit.

Në lidhje me auditimet e rregullsisë, audituesi duhet të përgatisë një raport me shkrim, i cili mund të jetë ose një pjesë e raportit mbi pasqyrat financiare ose një raport i veçantë, mbi testet e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Raporti duhet të përmbajë një deklaratë të sigurisë pozitive mbi ato çështjet/dokumentet e testuara në lidhje me pajtueshmërinë dhe siguri negative në ato çështje/dokumente të pa testuara.

Në lidhje me auditimet e performancës, raporti duhet të përfshijë të gjitha instancat e rëndësishme në lidhje me mos – përputhshmërinë që kanë të bëjnë me objektivat auditimit.

Paragrafët në vijim shpjegojnë raportimin si një standard auditimi. Paragrafi 170 ka lidhje me opinionet dhe raportet, paragrafët 171 – 182 kanë lidhje me opinionet dhe paragrafët 183 – 188 kanë lidhje me raportet.

Forma dhe përmbajtja e të gjitha opinionëve dhe raporteve të auditimit janë themeluar mbi parimet e përgjithshme:

(a) Titulli. Opinioni ose raporti duhet të paraprihet nga kreu ose një titull i përshtatshëm, duke ndihmuar lexuesin që ta dallojë atë nga deklaratat dhe informacionet e lëshuar nga të tjerët.

(b) Nënshkrimi/firma dhe data. Opinioni ose raporti duhet të nënshkruhet si duhet. Përfshirja e një date informon lexuesit se vlerësimi është dhënë për efekt të ngjarjeve ose transaksioneve për të cilat audituesi

ka qenë i vetëdijshëm deri në atë datë (e cila, në rastin e auditimeve të rregullshmërisë (financiar), mund të jetë pas periudhës së pasqyrave financiare).

(c) Objektivat dhe qëllimi. Opinioni ose raporti duhet të përfshijë objektivat dhe qëllimet e auditimit. Ky informacion përcakton synimin dhe kufijtë e auditimit.

(d) Tërësia. Opinionet duhet të bashkëlidhen dhe të publikohen me pasqyrat financiare të cilave ato i përkasin, por në raportet e performancës mund jenë të ndryshme. Opinionet dhe raportet e audituesit duhet të paraqiten siç janë përgatitur nga audituesi. Në ushtrimin e pavarësisë së tij, SAI duhet të jetë në gjendje të përfshijë çdo lloj dokumentacioni që e konsideron të arsyeshme, gjithashtu mund të marrë informacione që herë pas here për interesin kombëtar ato nuk mund të jepet lirisht. Kjo mund të ndikojë në mos plotësinë e raportit të auditimit. Në këtë situatë audituesi mban një përgjegjësi për të marrë në konsideratë nevojën për të bërë një raport, ndoshta duke përfshirë materiale të fshehta ose të ndjeshme, në një raport të veçantë dhe që nuk botohet.

(e) Marrësi. Opinioni ose raporti duhet të identifikojë ata të cilëve u është adresuar, siç kërkohet në kushtet e angazhimit të auditimit dhe rregulloret ose praktikrat e vendit. Kjo mund të jetë e panevojshme kur ekzistojnë procedura zyrtare për shpërndarjen e tij.

(f) Identifikimin i tematikës. Opinioni ose raporti duhet të identifikojë pasqyrat financiare (në rastin e auditimeve të rregullsisë (financiare)) ose fushën (në rastin e auditimit të performancës), të cilëve i referohet. Kjo përfshin informacion të tillë si emri i njësisë publike të audituar, datën dhe periudhën e përfshirë të pasqyrave financiare dhe tematikën që është audituar.

(g) Baza ligjore. Opinionet dhe raportet e auditimit duhet të identifikojnë legjislacionin ose dispozita të tjera që nevojiten në kryerjen e auditimit.

(h) Përputhshmëria me standardet. Opinionet dhe raportet e auditimit duhet të tregojnë standardet e auditimit dhe praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit, duke siguruar lexuesin se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

(i) Afati kohor. Opinioni ose raporti i auditimit duhet të jenë në dispozicion të menjëhershëm, që të jenë për një përdorim të madh për lexuesit dhe përdoruesit, veçanërisht për ata që duhet të marrin masat e nevojshme.

Opinioni i auditimit zakonisht hartohet sipas një formati standard në lidhje me pasqyrat financiare në tërësi, duke shmangur kështu kërkesën për t'u shprehur gjerësisht mbi gjithçka që qëndron pas tij, por duke i treguar gjendjen e përgjithshme sipas natyrës tek lexuesit. Natyra e këtyre fjalëve që do të përdoren në opinion do të duhet të jenë të ndikuara nga kuadri ligjor mbi auditimin, por përmbajtja e tij do të duhet të tregojë qartë nëse ai është opinion i pakualifikuar ose i kualifikuar dhe nëse ky i fundit është i kualifikuar në aspekte të caktuara apo i kufizuar (paragrafi 176), ose një refuzim opinionit (paragrafi 177).

Një opinion i pakualifikuar jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;

(b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;

(c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe

(d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Theksimi i çështjes. Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pakualifikuar, në rast se kjo keqinterpretohet si kualifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si “theksimi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit. Megjithatë, audituesi nuk duhet të përdorë theksimin e çështjes për të

korrigjuar mungesën e gjetjeve të duhura në pasqyrat financiare dhe as si alternative apo rezervë, për një opinionin të kualifikuar.

Një auditues mund të mos jetë i aftë të shprehë një opinion të pakualifikuar kur ekziston ndonjëra nga rrethanat që vijon si më poshtë dhe kur në gjykimin e audituesit efekti i tyre është ose mund të jetë material në pasqyrat financiare:

- (a) ka pasur një kufizim të qëllimit të auditimit;
- (b) audituesi i konsideron pasqyrat jo të plota, mashtrim ose ka një devijim të pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit;
- (c) ka pasiguri që ndikojnë në pasqyrat financiare.

Opinionin i Kualifikuar. Opinionin i kualifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe konçize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e kualifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinionin negativ (kundërshtues). Opinionin negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionin qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe konçize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave

financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

Zakonisht SAI duhet të sigurojë një raport të detajuar duke zgjeruar opinionin në rrethanat kur ka qenë e pamundur të jepet një opinion i pakualifikuar.

Përveç kësaj, auditimet e rregullshmërisë (financiare) zakonisht kërkojnë që raportet të bëhen aty ku shfaqen dobësi në sistemet financiare apo në ato të kontabilitetit (në ndryshim nga aspektet e auditimit të performancës). Kjo mund të ndodhë jo vetëm kur dobësitë kanë efekt mbi procedurat e njësive publike, por gjithashtu edhe aty ku ato lidhen me kontrollin që kjo njësi ka mbi aktivitetin e të tjerëve. Audituesi duhet të raportojë gjithashtu parregullsitë domethënëse, si ato të dallueshme po ashtu dhe ato potenciale, mbi moszbatimin e rregulloreve ose mashtrimin dhe praktikën korruptuese.

SAI-t me statut juridik kanë të drejtë të marrin masa rreth parregullsive të zbuluara në pasqyrat financiare. Mund të jenë të autorizuar gjithashtu për të bashkërenduar llogaritë e përgatitura nga kontabilistët, të propozojnë masa zhdëmtimi ndaj kontabilistëve dhe në rrethana të caktuara mund të propozojnë edhe pezullimin apo largimin e tyre nga puna.

Audituesit, në raportimin e parregullsive apo të rasteve kur nuk është vepruar në përputhje me ligjet dhe rregulloret, duhet të jenë të kujdesshëm për t'i paraqitur zbulimet e tyre në mënyrën e duhur. Shkalla e mospërputhjes mund të jetë e lidhur me numrin e rasteve të shqyrtuara ose me shumën monetare.

Raportet mbi parregullsitë mund të përgatitjen pavarësisht kualifikimit të opinionit të audituesit. Për nga natyra e tyre, raportet kanë tendencë që të përmbajnë vërejtje të rëndësishme, por në mënyrë që të jenë konstruktive, ato duhet të përmbajnë deklarata si nga vetë njësia publike e audituar ashtu dhe nga audituesit duke përfshirë edhe konkluzione e rekomandime.

Në dallim nga auditimi i rregullshmërisë (financiare), i cili është subjekt i kërkesave mjaft specifike dhe i parashikimeve, auditimi i performancës në

natyrën e tij i takon një spektri shumë të gjerë dhe është më i prirur për gjykim dhe interpretim. Gjithashtu edhe trajtimi i tij është më përzgjedhës dhe mund të kryhet për një periudhë disa vjeçare, se sa në një periudhë financiare, zakonisht duke mos pasur të bëjë me pasqyrat financiare. Si rrjedhojë, raportet e auditimit të performancës varjojnë dhe përmbajnë më shumë diskutim dhe argumentim të arsyetuar.

Raporti i auditimit të performancës duhet të përcaktojë qartë objektivat dhe fushëveprimin e auditimit. Raportet mund të përfshijnë kritika (për shembull kur, në interesin publik ose për shkak të përgjegjësisë publike, është tërhequr vëmendja në çështjet serioze të shpërdorimeve, të paaftësisë ose shpenzime të tepruara) ose mund të mos ketë asnjë kritikë të rëndësishme, por japin informacione të pavarura, këshilla ose siguri se deri në çfarë mase, ekonomikiteti, eficientia dhe efektiviteti janë ose do të arrihen.

Audituesi normalisht nuk pritet të japë një opinion të përgjithshëm në arrijtjen e ekonomikitetit, eficientës dhe efektivitetit nga njësia publike e audituar në të njëjtën mënyrë si tek dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare. Ku natyra e auditimit e lejon që kjo të bëhet në lidhje me fusha të veçanta të aktiviteteve të njësive publike, audituesi duhet të paraqesë një raport i cili përshkruan rrethanat dhe arrin në një përfundim të caktuar se sa të paraqesë një deklaratë të standardizuar. Kur auditimi ka përfunduar vlerësimin dhe s'mundi të sigurojë nëse ekzistonin kontrole të mjaftueshme mbi ekonomikitetin, eficientën ose efektivitetin, audituesi mund të japi një opinion më të përgjithshëm.

Audituesit duhet të shikoj nëse gjykimet e tyre janë duke u zbatuar si rrjedhojë e veprimeve që rezultuan nga vendimet e mëparshme të menaxhimit. Prandaj duhet të ushtrohet kujdes në bërjen e të tilla gjykimeve, dhe raporti duhet të tregojë natyrën dhe shkallën e arsyeshme të informacionit të disponueshëm (ose që duhet të ishte në dispozicion) tek njësitë publike të audituara gjatë kohës kur janë marrë vendimet. Duke deklaruar në mënyrë të qartë qëllimin, objektivat dhe rezultatet e auditimit, raporti tregon për lexuesit se audituesi ishte i drejtë/paanshëm. Me drejtësi/paanshmëri nënkuptohet paraqitja e dobësive ose zbulimet e rëndësishme në mënyrë të tillë që të inkurajojë korrigjim, dhe për të përmirësuar sistemet dhe udhëzime brenda njësive publike të audituar. Prandaj bihet dakord në përgjithësi mbi gjetjet me njësinë publike të audituar, me qëllim që të sigurohet se ato janë të plota, të sakta dhe të prezantuara në mënyrë të drejtë në raportin e auditimit. Gjithashtu mund

të jetë e nevojshme që të përfshihen përgjigjet e njësisë publike të audituar për çështjet e ngritura, në formë të plotë ose të përmbledhur, sidomos aty ku SAI paraqet synimet ose rekomandimet e veta.

Raportet e performancës nuk duhet të përqendrohen vetëm në kritika e mëparshme, por ato duhet të jenë dobiprurëse. Konkluzionet dhe rekomandimet e audituesit janë një aspekt i rëndësishëm i auditimit dhe kur është e përshtatshme, ato shkruhen për t'u zbatuar në formën e udhëzimeve. Në përgjithësi këto rekomandime sugjerojnë se çfarë përmirësime janë të nevojshme se sa në ç'mënyrë mund arrihen ato, ndonjëherë në disa rrethana kërkojnë një rekomandim të veçantë, për shembull për të korrigjuar një defekt në ligj në mënyrë që të sjellë një përmirësim administrativ.

Në formulimin dhe ndjekjen e rekomandimeve, audituesi duhet jetë objektiv dhe i pavarur, gjithashtu të përqendrohet në se dobësitë e identifikuar janë korrigjuar dhe ai nuk duhet thjeshtë të shikoj nëse rekomandimet specifike janë pranuar nga njësia publike.

Në formulimin e opinionit ose raportit të auditimit, audituesi duhet të marrë në konsideratë materialitetin e çështjes në kontekst tek pasqyrat financiare (auditimin e rregullshmërisë (financiar)) ose natyrën e njësisë publike të audituar ose aktivitet (në auditimet e performancës).

Në auditimet e rregullshmërisë (financiare), nëse audituesi arrin në përfundim se, duke gjykuar kundrejt kritereve të caktuara se gjendja e dhënë në paraqitjen e pasqyrave financiare çështja nuk cenohet materialisht, opinionin nuk duhet të jetë i kualifikuar. Kur audituesi vendos që një çështje është materiale, opinionin duhet të jetë i kualifikuar, duke përcaktuar llojin e kualifikimit (paragrafët 174 – 177).

Në rastin e auditimeve të performancës ai gjykim do të jetë më subjektiv pasi raporti nuk ka lidhje në mënyrë direkte me pasqyrat financiare ose deklarata të tjera. Si pasojë audituesi mund të gjejë se materialiteti nga natyra ose nga konteksti është i një rëndësie më të madhe se materialiteti në vlerë.